



**Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim ne Evropë
MISIONI NË KOSOVË**

Departamenti i të Drejtave të Njeriut dhe Sundimit Ligjor

KOSOVË

**SHQYRTIMI TEMATIK I SISTEMIT TË GJYQËSISË PENALE
Tetor 2001**

ÇËSHTJET:

PËRFAQËSIMI LIGJOR

PARABURGIMI

TRAFIKIMI & KRIMET SEKSUALE

GJYKATAT KOMUNALE & GJYKATAT PËR KUNDËRVAJTJE

TABELA E PËRMBAJTJES

SHKURTESAT

SHKURTESAT	2
SHKURTESAT	4
PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE	6
<i>Korniza e këtij raporti.....</i>	7
<i>Çështjet e mbrojtjes.....</i>	7
<i>Paraburgimi.....</i>	8
<i>Trafikimi dhe krimet seksuale</i>	8
<i>Gjykatat Komunale dhe për Kundravajtje</i>	9
SEKSIONI 1: MONITORIMI.....	11
I. MANDATI I SEKSIONIT TË MONITORIMIT TË SISTEMIT LIGJOR	11
<i>Raporti me Shtyllat tjera.....</i>	12
<i>E Drejta në gjykim objektiv (të drejtë).....</i>	13
<i>Rastet prioritare.....</i>	14
SEKSIONI 2: LIGJI I APLIKUESHËM.....	14
I. ZHVILLIMET E THEKSUESHME NË LIGJIN E APLIKUESHËM.....	14
II. ÇËSHTJET QË RRJEDHIN NGA SHQYRTIMET E FUNDIT TË SMSL.....	15
III. ZHVILLIMET BRENDË SISTEMIT TË GJYQËSISË DHE STATUSI I IMPLEMENTIMIT TË REKOMANDIMEVE TË SMSL.....	17
<i>Instituti Juridik (Gjyqësor) i Kosovës</i>	17
<i>Qendra Burimore për Mbrojtje Penalo Juridike.....</i>	17
<i>Njësia e Inspektionit Gjyqësor dhe Këshilli Gjyqësor dhe i Prokurorisë.....</i>	18
<i>Planet për ristrukturimin e Institutit Forenzik.....</i>	18
<i>Implementimi i rekomandimeve të SMSL.....</i>	18
SEKSIONI 3: E DREJTA NË PËRFAQËSIM EFEKTIV LIGJOR	20
I. DETYRIMET E AUTORITETEVE.....	20
<i>Qasja në mbrojtësit gjatë mbajtjes në arrest policor.....</i>	20
<i>Projekt Regullorja mbi qasjen në mbrojtës për personat e arrestuar nga policia.....</i>	21
<i>Qasja në mbrojtës gjatë hetimeve paraprake.....</i>	23
<i>Praktika gjyqësore</i>	25
II. SJELLJA E AVOKATIT MBROJTËS.....	28
III. PARABURGIMET JASHTË GJYQËSORE DHE QASJA NË MBROJTËS	31
IV. REKOMANDIMET	32
SEKSIONI 4: PARABURGIMI	34
I. HYRJE.....	34
II. PARABURGIMI NË BAZË TË URDHËRIT EKZEKUTIV TË PSSP.....	34
<i>Pasqyrë faktike.....</i>	34
<i>Arsyetimi i urdhërit ekzekutiv për paraburgim</i>	35
<i>Rishqyrtimi jigjor i paraburgimit.....</i>	36
<i>Praktika e paraburgimit – qasja në mbrojtësit</i>	37
<i>Pushtetit emergjente.....</i>	37
III. PARABURGIMI NGA KFOR-I	39
<i>Pasqyrë faktike.....</i>	39
<i>Bazat për paraburgim.....</i>	39
<i>Mekanizmat e rishqyrtimit dhe praktikat tjera të paraburgimit.....</i>	40

<i>Qasja në mbrojtje</i>	40
<i>Paraburgimet e KFOR-it në raport me legjislacionin ndërkombëtar për të drejtat e njeriut</i>	41
IV. PARABURGIMET E TË SËMURËVE MENTAL.....	44
V. KUFINJTË KOHOR TË PARABURGIMIT.....	45
VI. REKOMANDIMET.....	47
<i>Paraburgimet jashtë gjyqësore nga ana e PSSP dhe KFOR-it</i>	47
<i>Paraburgimet e të sëmurëve mental</i>	48
<i>Kufinj të kohor të paraburgimit</i>	48
SEKSIONI 5: TRAFIKIMI DHE KRIMET SEKSUALE	50
I. HYRJE.....	50
II. ORGANET E RENDIT PUBLIK (POLICIA).....	50
<i>Çështjet strukturale</i>	51
<i>Çështjet substanciale</i>	53
III. ZYRA E PROKURORIT PUBLIK.....	56
IV. GJYKATAT.....	57
<i>Çështjet strukturale</i>	58
<i>Çështjet substanciale</i>	61
V. DHUNIMI DHE VEPRAT TJERA SEKSUALE.....	65
<i>Analizat forenzike(mjeko-ligjore) në rastet e dhunës seksuale</i>	66
<i>Sjellja që sygjeron qëndrimin anues në gjyqësi dhe mungesa e ndihmës për viktimat</i>	67
VI. REKOMANDIMET.....	68
SEKSIONI 6: GJYKATAT KOMUNALE DHE GJYKATAT PËR KUNDËRVAJTJE	70
I. HYRJE.....	70
II. GJYKATAT KOMUNALE.....	70
<i>Kompetenca e Gjykatave Komunale</i>	70
<i>Shtrirja e rasteve</i>	71
<i>Sasia e punës (normës) e gjykatësve në Gjykata Komunale</i>	71
<i>Nën mesatare</i>	72
<i>Administrimi i gjyqësisë dhe parregullësitë procedurale</i>	73
<i>Rastet e të miturve në Gjykatat Komunale</i>	75
<i>Dhuna në familje</i>	78
<i>Rastet e drogës dhe kompetenca materiale e Gjykatave Komunale</i>	79
III. GJYKATAT PËR KUNDËRVAJTJE.....	81
<i>Vërejtjet hyrëse</i>	81
<i>Një shqyrtim i shkurtër i procedurës kundërvajtëse</i>	81
<i>Efektet e rregulloreve të fundit të UNMIK-ut mbi Kompetencën e GJKV</i>	83
<i>Informatat statistikore mbi Gjykatat për Kundërvajtje</i>	83
<i>Rastet në Gjykatat e Kundërvajtjes</i>	84
<i>Shqetësimet që burojnë nga observimi i aktivitetëve të GJKV</i>	86
REKOMANDIMET.....	88

SHKURTESAT

ABA-CEELI	Iniciativa Ligjore e Asociacionit Amerikan për Evropën Lindore dhe Qendrore
DAD	Departamenti Administrativ i Drejtësisë
KEGJFDKF	Konventa mbi Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Kundër Femrave
COMKFOR	Komandanti i Forcave të NATO-s në Kosovë
QPS	Qendrat për Punë Sociale
KDF	Konventa mbi të Drejtat e Fëmijut
PLPP	Projekti i Ligjit të Procedurës Penale
DSHMS	Departamenti për Shëndetësi dhe Mirëqenje Sociale
KEDNJ	Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut
RFJ	Republika Federale e Jugosllavisë
LP RFJ	Ligji Penal i RFJ-së
LPP RFJ	Ligji i Procedurës Penale i RFJ-së
Ish-RJM	Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë
KNDCP	Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike
KNKK	Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq
GJNPJ	Gjykata Ndërkombëtare Penale për ish-Jugosllavinë
KPK	Këshilli i Përbashkët Këshilldhënës mbi Çështjet Juridike
NJIGJ	Njësia e Inspektionit Gjyqësor
KFOR	Forcat e Kosovës
KGJPK	Këshilli Gjyqësor dhe i Prokurorisë së Kosovës
UÇK	Ushtria Çlirimtare e Kosovës

LPK	Ligji Penal i Kosovës
SHPK	Shërbimi Policor i Kosovës
LKV	Ligji mbi Kundërvajtjet
SMSL	Seksioni për Monitorim të Sistemit Ligjor
GJKV	Gjykatat për Kundërvajtje
MTU	Marrëveshja Tekniko-Ushtarake
NATO	Organizata e Aleancës Veri-Atlantike
ZKLDNJ	Zyra e Komisionerit të Lartë për të Drejtat e Njeriut
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
RKS	Rezoluta e Këshillit të Sigurimit
PSSP	Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm
SHKFAE	Shtabi Kryesor i Fuqive të Aleancës në Evropë
NJHTP	Njësia Hetimore për Trafikim dhe Prostitucion
UNHCR	Komisioneri i Lartë për Refugjatë i Kombeve të Bashkuara
UNICEF	Fondacioni i Kombeve të Bashkuara për Fëmijë
UNMIK	Misioni Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë

PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE

Ky shqyrtim është raporti i tretë publik mbi sistemin e gjyqësisë penale nga Seksioni i Monitorimit të Sistemit Ligjor (SMSL). SMSL është pjesë e Divizionit për të Drejtat e Njeriut të Shtyllës së III-të të UNMIK-ut (Organizatës për Bashkëpunim dhe Siguri në Evropë –OSBE). Shqyrtimi i tanishëm mbulon periudhën prej Marsit deri në Gusht 2001. Të mveshura me pushtetin ekzekutiv dhe legjislativ nga Rezoluta 1244 e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, Kombet e Bashkuara Misioni I Administratës së Përkohshme në Kosovë (UNMIK) përmes Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP) – ka mandatin për të administruar sistemin gjyqësor në Kosovë. Ky mandat më parë është përbushur nga Departamenti Administrativ i Drejtësisë (DAD). Sidoqoftë, që nga shqyrtimi fundit, UNMIK-u ka themeluar një strukturë të re të Shtyllës së I-rë, të quajtur Policia dhe Shtylla e Gjyqësisë, e cila ka bashkuar departamentet e zbatimit të ligjit dhe punëve juridike për të lehtësuar bashkëpunimin e mbrendshëm dhe gjithashtu bashkëpunimin në mes të OSBE, KFOR-it dhe organizatave tjera ndërkombëtare të vendosura në Kosovë. Administrimi i gjyqësisë më parë ishte udhëhequr nga Shtylla II (Administrimi Civil). Sipas Rregullores së UNMIK-ut 2001/09, mbi Kornizën Kushtetuese për Vetëqverisjen e Përkohshme në Kosovë, (Korniza Kushtetuese e promulguar më 15 Maj 2001), një pjesë të kontrollit administrativ mbi sistemin e gjyqësisë, do të kaloj tek institucionet e reja të përkohshme të vetqeverisjes, të cilat do të vendosen pas zgjedhjeve të 17 nëntorit 2001. Megjithatë, përgjegjësia kryesore për sistemin gjyqësor do t'i mbetet Shtyllës I.

Në pajtim me mandatin e saj, OSBE, në kuadër të UNMIK-ut, ndan, përgjegjësinë *për të siguruar se çështjet e mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave të njeriut janë të adresuara përgjatë aktiviteteve të gjithëmbarshme të misionit*. Në përputhje me mandatin e UNMIK-ut që të zhvilloj mekanizma për të siguruar pajtueshmërinë e organeve të rendit publik dhe sistemit gjyqësor me standardet ndërkombëtare të gjyqësisë penale dhe të drejtave të njeriut, kapacitetet monitoruese të SMSL kanë vazhduar të fokusohen në identifikimin e shqetësimeve për të drejtat e njeriut në të gjitha nivelet e sistemit të gjyqësisë. Ky shqyrtim pretendon të kuptohet si instrument ndihmës në adresimin e gjithanshëm të sfidave/problemeve të llojllojshme që paraqiten para sistemit gjyqësor penal, dhe me qëllim të përparimit/avancimit të një kulture të respektimit të të drejtave të njeriut dhe sundimit të së drejtës.

Siq është shprehur në raportet e mëparme, SMSL kupton pengesat me të cilat është përballuar UNMIK-u, në themelimin e sistemit gjyqësor në shoqërinë së cilës i mungon si korniza koherente ligjore ashtu edhe bërthama e profesionistëve me përvojë përbrenda gjyqësisë lokale, për shkak të përjashtimit të tyre një numër të konsiderueshëm nga sistemi ligjor në periudhën para vendosjes së UNMIK-ut. Megjithatë, një sistem gjyqësor funksional tani është themeluar ndërsa gjendjet e jashtëzakonshme të cilit do lloj tani kanë përfunduar, andaj, tani duhet siguruar pajtueshmërinë me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Në kuptim të mbrojtjes dhe promovimit të drejtave të njeriut, aprovimi i Rregullores 2001/9 mbi Kornizën Kushtetuese të Kosovës (e nënshkruar më 15 maj 2001), është njohje e nivelit më të lartë të zbatueshmërisë së drejtpërdrejtë të mekanizmave për të drejtat e njeriut në kuadër të kornizës ligjore në Kosovë. Çdo shkelje

e këtyre standardeve themelore nga çfarëdo autoriteti duhet të vrojtohet dhe menjëherë të adresohet, pasi që mund të krijoj precedent të kundërt me zhvillimin e ardhshëm të sistemit gjyqësor dhe shoqërisë në përgjithësi.

Korniza e këtij raporti

Në dy raportet e para mbi sistemin e të drejtës penale, SMSL ka prezentuar një analizë të gjërë dhe të gjithanëshme të sistemit të drejtësisë nga këndvështrimi i legjislacionit mbi të drejtat e njeriut. Shqetësimet e shprehura në këto raporte i referohen aspekteve të ndryshme strukturale dhe substanciale të aktiviteteve të gjyqësisë dhe udhëheqësve të saj, dhe gjithashtu organeve të rendit publik. Duke u ndërlidhur me raportin e fundit, SMSL ka sygjerruar një strategji të adresimit gjithpërfshirës të problemeve me të cilat ballafaqohet sistemi i drejtësisë të quajtur “Strategjia për Drejtësi”, dokument i cili i është prezentuar opinionit publik më 21 qershor 2001. Kjo strategji rekomandonte një kornizë të bashkëpunimit multi-institucional, për të adresuar fushat e veçanta të problemeve brenda sistemit si tërësi.

Duke konsideruar se shqetësimet dhe rekomandimet gjegjëse të identifikuar në shqyrtimet e mëparme janë ende valide, SMSL ofron në këtë shqyrtim një analizë të lëmive specifike substanciale të sistemit të gjyqësisë penale që shtrojnë çështjet më problematike të të drejtave të njeriut. Fushat e caktuara të problemeve të identifikuar në raportet e mëparme, siq janë paraburgimi, çështjet e mbrojtjes, trafikimi dhe dhuna seksuale, kërkojnë një shqyrtim të pashpenzueshëm që ndriqon barrierat e vazhdueshme që pengojnë pajtueshmërinë me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.

Për më tepër, në këtë raport, në mënyrë më të gjërë, SMSL adreson për herë të parë aktivitetin e Gjykatave Komunale dhe atyre për Kundërvajtje në Kosovë. Shqyrtimi konsiston në sfondin dhe informatat statistikore, përfshirë këtu edhe një shqyrtim të strukturës dhe procedurës së këtyre gjykatave të ulta, por gjithashtu edhe sigurimin e një analize të strukturës, procedurës, kryerjes së punëve dhe sfidave përbrenda gjykatave më të ulta nga perspektiva e të drejtave të njeriut.

Çështjet e mbrojtjes

Në maj dhe qershor 2000, SMSL lëshoi dy raporte mbi qasjen në përfaqësim të efektshëm ligjor dhe rishqyrtimet e mëparme të SMSL gjithashtu kanë adresuar aspektet e ndryshme të qasjes në mbrojtjen adekuate.¹ Rregullorja e UNMIK-ut, mbi të drejtën e personave të arrestuar nga organet e rendit, ishte në diskutim në periudhën e mbuluar me këtë raport, dhe është promulguar si Rregullore 2001/21 në Tetor 2001. OSBE, në bashkëpunim me Odën e Avokatëve të Kosovës, ka themeluar një OJQ, Qendrën Burimore për Mbrojtjen Penalo-Juridike, për të ofruar ndihmë avokatëve mbrojtës në mbrojtjen e rasteve që kanë të bëjnë me krimet kundër ligjeve ndërkombëtare humanitare dhe krimeve tjera etnikisht të motivuara, si dhe rastet e shkeljeve serioze të standardeve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut. Ndonëse të dy zhvillimet përfaqësojnë hapa

¹ Raportet Nr. 7 & 8: Qasja në Mbrojtësin Efektiv Ligjor. Të gjitha raportet paraprake të publikuara janë të disponueshme nën <http://www.osce.org/kosovo/documents/reports/justice/>

progresiv, ende ekzistojnë një numër çështjesh përkitazi me mbrojtjen, të cilat në mënyrë kundërt ndikojnë në të drejtën për gjykim të drejtë. P.sh. është observuar se është më tepër rregull se sa përjashtim që mbrojtësi të emërohet para fillimit të seancës kryesore, duke i ofruar kështu pak, nëse ka, kohë për të përgatitur mbrojtjen. Mbrojtësit gjithashtu shpeshherë ndërrohen gjatë rrjedhës së procedurës, për shkak të mungesës së planifikimit ose nga gjykata ose nga mbrojtësit e angazhuar. Për më tepër, mbrojtësit përgjithësisht nuk mbrojnë klientët e tyre në mënyrë aktive dhe efektive në pajtim me atë që në fakt parashikohet me ligjin në fuqi.

Paraburgimi

Ndalimi i arrestimit dhe paraburgimit arbitrar është pjesë fundamentale e ligjit ndërkombëtar mbi të drejtat e njeriut. SMSL më parë ka theksuar se konflikti i supozuar në mes të sigurisë dhe gjyqësisë nuk mund të përdoret si arsytim për ndërhyrje nga ekzekutivi në sferën gjyqësore, posaçërisht në paraburgimin e personave jashtë ligjit dhe pa çfarëdo shqyrtimi gjyqësor. Në vend të kësaj, ajo çka nevojitet është një strategji gjithëpërfshirëse e koordinuar mirë për të adresuar problemet afatgjate të sistemit të gjyqësisë, përfshirë edhe nevojat e sigurisë. Sidoqoftë, paraburgimi jashtë gjyqësor ka vazhduar në Kosovë, me urdhërat ekzekutiv për paraburgim të PSSP, jashtë domenit gjyqësor², dhe KFOR-it cili duke u bazuar në autoritetin e COMKFOR-it, ende paraburgos në mënyrë jashtë gjyqësore më tepër se qindra persona. Paraburgimi i personave përtej kufinjëve të ligjshëm kohor gjithashtu vazhdon përkundër përpjekjeve të bëra nga DAD, për të siguruar gjykatës dhe nëpunës gjyqësor të mjaftueshëm kurdo që dëgjimet hetimore (seancat për caktimin e paraburgimit) kishin nevojë të mbaheshin. Orari i gjykatësve në detyrë, në disa raste kishte dështuar të pengoj paraburgimin e kundërligjshëm pas skadimit të afatit të mbajtjes së personit në arrest policor.

Fusha në të cilën janë ndërmarrë disa hapa pozitiv është ajo e paraburgimit të personave të sëmurë mentalisht, ndonëse më tepër se 200 persona ende mbahen në mënyrë të kundërligjshme si të paraburgosur në Institutin për nevoja të veçanta në Shtime. Bashkëpunimi i ngushtë brenda UNMIK-ut me akterët tjerë relevant në këtë lëmi, reflekton një qasje strategjike të planifikimit multi-institucional, i cili duhet të aplikohet edhe në lëmitë tjera të problemeve të përbashkëta.

Trafikimi dhe krimet seksuale

Kriminaliteti i trafikimit me njerëz paraqet një problem serioz, si nga aspekti ligjor ashtu edhe ai humanitar. Ndonëse rregullorja mbi trafikimin, Rregullorja e UNMIK-ut 2001/4, hyri në fuqi në janar 2001, efektet e saj vetëm kanë filluar të duken. Përkundër përpjekjeve për të shpjeguar këto kornizë ligjore, gjyqësia shprehë vështirësitë në kuptimin dhe aplikimin e drejtë të mekanizmave ligjor dhe mjeteve juridike të parapara me

² Rregullorja e UNMIK-ut 2001/18 themeloi Komisionin e Rishqyrtimit të Paraburgimit për Paraburgimet Jashtë-Gjyqësore të bazuara në Urdhërat Ekzekutiv dhe ky Komision është fuqizuar si kontrollë gjyqësore mbi paraburgimet ekzekutive. Në Raportin e toj Special Nr. 4, Ombudspersoni përfundoi se organi i fuqizuar sipas Rregullores 2001/18 nuk mund të konsiderohet gjykatë në kuptim të paragrafit 4 të Nenit 5 të KEDNJ.

rregullore. Pakoja e mekanizmave dhe mbrojtjes së paraparë me Rregulloren 2001/4, për viktimën, shumë pak është aplikuar, përderisa Koodinatori për asistimin e viktimës, i paramenduar si një strukturë koherente për implementimin e Rregullores, akoma nuk është emëruar nga PSSP. Në këtë raport SMSL do të analizoj disa nga problemet më të mëdha që ballafaqojnë sistemin gjyqësor në zgjidhjen e rasteve të trafikimit.

Që nga raporti i fundit, zhvillimet ishin dokumentuar në shumë nga lëmitë e brengosjeve për të cilat kishte raportuar SMSL. Ose për shkak të iniciativave *ad hoc* të izoluara ose nga rregullat gjithëpërfshirëse, çështjet siq janë trajnimit për gjykatësit vendor, dhënja e ndihmës juridike për viktimat e trafikimit, krijimi i mekanizmave diciplinor për të shqyrtuar aktivitetin e gjykatësve vendor dhe prokurorëve (Njësia e Inspekcionit Gjyqësor i DAD dhe Këshilli Gjyqësor dhe i Prokurorisë i Kosovës), janë adresuar përmes përpjekjeve të UNMIK-ut. Megjithate, në fushën e veprave të ndaluara seksuale, mbi të cilat paraprakisht ka raportuar SMSL, është arritur shumë pak, pothuajse fare. SMSL gjatë gjashtë muajve të kaluar ka identifikuar probleme të rishfaqura që rrjedhin nga të njëjtat burime. Analizat joadekuate të mjekësisë ligjore dhe mbledhja e varfër e provave gjatë fazave fillestare të hetimeve, sjelljet që sygjerojnë qëndrimin anues të gjyqësisë kundrejt viktimave të dhunimit dhe mungesa e përkrahjes apo mbrojtjes për viktimat gjatë procedurës penale paraqet një dështim të UNMIK-ut për të adoptuar zgjidhje konkrete për këto çështje.

Gjykatat Komunale dhe për Kundërvajtje

Në të kaluarën, SMSL kishte koncentruar kapacitetet e veta monitoruese gati ekskluzivisht mbi Gjykatat e Qarkut. Gjykimet në Gjykatat Komunale ishin përcjellur vetëm *ad-hoc* dhe posaçërisht rastet që kishin të bënin me të miturit. Si pasojë e kësaj, SMSL nuk ka raportuar gjërësisht dhe sistematikisht mbi aktivitetet e këtyre gjykatave, e madje edhe më pak informata ishin në disponim mbi funksionimin e Gjykatave Komunale për Kundërvajtje (Gjykatat për Kundërvajtje).

Për gjashtë muajt e kaluar, megjithate, SMSL ka drejtuar një pjesë të fokusimit të tij, si në Gjykatat Komunale ashtu edhe në ato për Kundërvajtje. Monitorimi i aktiviteteve të tyre ka ndrikuar shqetësimet mbi shkeljet e standardeve për të drejtat e njeriut, të ngjashme dhe me pasoja krahasuese sikurse ato të identifikuar në Gjykatat e Qarkut. Çështjet përkitazi me qasjen në mbrojtës, të drejtës për gjykim korrekt, ndihmën pa pagesë të përkthyesit, janë vetëm disa nga lëmitë e shqetësimeve të monitoruara dhe të adresuara në këtë raport nga SMSL.

SMSL gjithashtu ka dokumentuar se aktivitetet e këtyre gjykatave kanë mbetur nën hije sa i përket vëmendjes publike dhe se angazhimet administrative ndaj tyre kanë qenë shumë të vogla. Përderisa, në nivelin e gjykatave të qarkut, ekzistojnë zyrtarët ndërkombëtar ligjor, të emëruar nga DAD për të lehtësuar punën e gjykatësve kombëtar në nivel administrativ, me një njohuri të thellë të rasteve, një funksion i tillë korrespondues nuk ekziston në gjykatat komunale dhe ato për kundërvajtje. Për më tepër, administratorët gjyqësor të emëruar për secilin regjion në Kosovë, nuk mund të jenë efektivisht dhe në mënyrë specifike përgjegjës për efektivitetin e gjykatave të regjioneve të caktuara andaj

emërimi nga DAD i zyrtarëve administrativ ligjor që të kenë përherë një rishikim në çdo kohë të aktiviteteve dhe sfidave, logjistike e të tjera, brenda këtyre gjykatave, është më se i dëshiruar.

Ndonëse prioritetet për SMSL mbesin të njëjta, fokusimi i veçantë mbi Gjykatat Komunale dhe ato për Kundërvajtje në këtë raport nuk paraqet përpjekje të izoluar. Më tepër, SMSL do të vazhdoj të identifikoj problemet e ndryshme për të drejtat e njeriut të cilat pengojnë aktivitetin e këtyre gjykatave dhe të cilat ndikojnë në pajtueshmërinë e tërë sistemit penal gjyqësor me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.

SEKSIONI 1: MONITORIMI

I. MANDATI I SEKSIONIT TË MONITORIMIT TË SISTEMIT LIGJOR

Me Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të KB (RKS 1244), Këshilli i Sigurimit i KB ka autorizuar Sekretarin e Përgjithshëm të KB që në Kosovë të themelojë prezencën civile ndërkombëtare, e cila do të vendoste një administratë të përkohshme. Njëra prej përgjegjëse kryesore të prezencës ndërkombëtare ishte “mbrojtja dhe afirmimi i të drejtave të njeriut”. (Para. 11 (j)).

Sekretari i Përgjithshëm i KB në referimin e tij para Këshillit të Sigurimit të KB të datës 12 korrik 1999, rolin udhëheqës për ndërtimin e institucioneve në kuadër të UNMIK-ut i'a ka caktuar OSBE-së dhe ka vënë në pah se njëra prej detyrave të Shtyllës së Ndërtimit të Institucioneve (Shtylla III) do të përfshijë monitorimin e të drejtave të njeriut dhe ndërtimin e kapaciteteve.

Në Raportin e Sekretarit të Përgjithshëm të KB para Këshillit të Sigurimit të KB të datës 12 korrik 1999, janë dhënë instruksione UNMIK-ut për themelimin e mekanizmave bashkërendues në mënyrë që të lehtësohet monitorimi i respektimit të të drejtave të njeriut dhe funksionimi i drejtë i sistemit gjyqësor duke shtuar këtu se raportimi duhet të zhvillohet në mënyrë të bashkërenditur në mënyrë që të lehtësohet zotësia e veprimit. E në veçanti:

“UNMIK-u do të ketë një trup monitoruesish dhe këshilltarësh për të drejtat e njeriut të cilët do të kenë *qasje të papenguar* në të gjitha pjesët e Kosovës për të hetuar cenimet e të drejtave të njeriut dhe do të sigurojnë që shqetësimet që kanë të bëjnë me mbrojtjen dhe afirmimin e të drejtave të njeriut të jenë të shfaqura nëpërmjet të aktivitetit të gjithmbarshëm të misionit. Monitoruesit e të drejtave të njeriut lidhur me informatat e mbledhura i raportojnë Përfaqësuesit Special përmes zëvendësit të tij të ngarkuar për ndërtimin e institucioneve. Të dhënat e mbledhura nga monitoruesit e të drejtave të njeriut do të publikohen në baza të rregullta dhe do të shkëmbehen sipas nevojës edhe me mekanizmat për të drejtat e njeriut në kuadër të Kombeve të Bashkuara, e në konsultim me Zyren e Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut. UNMIK-u do të mundësoj raportimin bashkërendues dhe zotësinë për të vepruar”. (Para. 87).

Në “Dokumentin e Marrëveshjes”, më 19 korrik 1999, në mes të nën-Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara për Operacione Paqëruajtëse dhe Kryesuesit të Radhës të Zyres së OSBE-së, vendoset që Shtylla III, OSBE-ja do të zhvilloj mekanizma për të garantuar se gjyqet, tribunalet administrative dhe strukturat tjetra gjyqësore të veprojnë në harmoni me standardet ndërkombëtare të së drejtës penale dhe të drejtave të njeriut. Për më shumë, duke u thirrur në *Rregulloren 2000/15* të datës 21 mars 2000 mbi themelimin e Departamentit Administrativ të Drejtësisë, është marrë konfirmimi nga ana e Departamentit Administrativ të Drejtësisë që OSBE-ja të jetë organizata përgjegjëse për monitorimin e pavarur të sistemit gjyqësor dhe shërbimit korrektues.

Qarkorja Gjyqësore (2001/15) e shpallur më 6 qershor 2001, u konfirmoi qasjen monitorëve të OSBE për të drejtat e njeriut, procedurave gjyqësore dhe dokumenteve gjyqësore. Qarkorja pritet të forcoj kuptimin e gjyqësisë përkitazi me mandatin e SMSL, dhe të siguroj mbulimin e tërësishëm të të gjitha fazave të procedurës penale nga monitorët e SMSL.

Raporti me Shtyllat tjera

Departamenti i të Drejtave të Njeriut dhe Sundimit të së Drejtës pranë OSBE-së, si pjesë e Shtyllës për ndërtimin e institucioneve punon me një bashkëpunim të ngushtë me organizatat e KB siç janë OHCHR, UNHCR dhe UNICEF. Departamenti është njëri prej akterëve kyq në Ekipin e Përbashkët për Destinim të Posaçëm për Legjislacionin për të Miturit, e i cili udhëheqet nga UNICEF-i. Departamenti bashkëpunon gjithashtu edhe me organizatat tjera ndërkombëtare dhe të vendit siç janë Këshilli i Evropës, Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq (**orig. ICRC**) dhe Dhoma e Avokatëve Amerikan-Initiativa Ligjore për Evropën Qendrore dhe Lindore (**orig. ABA-CEELI**).

Departamenti siguron për bashkëpunim të ngushtë me Shtyllën e re të I-rë të posaformuar mbi Policinë dhe Gjyqësinë, pasi që objektivat e përcaktuar nga ky i fundit hyjnë në mesin e qëllimeve të qëndrueshme të ndërtimit të institucioneve dhe kapaciteteve të parapara nga OSBE. Në nivelin e e sistemit gjyqësor penal, Shtylla I është vendosur për të konsoliduar ligjin dhe strukturën e rendit që është funksionalisht e logjikshme, dhe në veçanti të themeloj një proces gjyqësor të paanshëm përmes pjesëmarrjes fillestare ndërkombëtare dhe reformës së sistemit gjyqësor.³ Përgjatë këtyre vijave, Departamenti promovon zhvillimin e shoqërisë së bazuar në sundimin e ligjit që garanton respektimin e plotë për të drejtat e njeriut dhe liritë fundamentale secilit individ, dhe këto qëllime mund të arrihen vetëm nga gjyqësia që funksionon mirë me strukturë dhe strategji të qartë.

Si pjesë e Shtyllës III dhe e UNMIK-ut si tërësi, mandati i monitorimit të sistemit ligjor të OSBE-së përfshin raportimin e saktë dhe të menjëhershëm në kuadër të UNMIK-ut mbi:

- i. statistikat aktuale mbi sistemin e gjyqësisë penale,
- ii. shkeljet sistematike të së drejtës ndërkombëtare, dhe
- iii. shkeljet e rënda të standardeve mbi gjykimin objektiv në rastet individuale të cilat duhet menjëherë të menjanohen (shërohen).

SMSL, si pjesë e Divizionit të të Drejtave të Njeriut, në mënyrë adekuate mban raporte konsistente dhe bashkëpunuese me Shtyllat tjera dhe me agjencitë tjera ndërkombëtare.⁴ Atij i drejtohen DD KB dhe Zyra e PSSP-së me kërkesa për informacione të ndryshme që kanë të bëjnë me gjendjen e sistemit të drejtësisë penale, siç janë gjendja e lëndëve në procedurë e sipër, të miturit e paraburgosur, dhe personave ndaj të cilëve është ngritur aktakuza. Shkeljet sistematike, trendi aktual, problemet individuale dhe çështjet të cilat identifikohen nga ana e SMSJ-së, u janë komunikuar departamenteve tjera dhe si dhe

³ Shiko artikullin "E themeluar Shtylla e Re mbi Policinë dhe Gjyqësinë" në Lajmet e UNMIK-ut nr. 93, 21 Maj 2001.

⁴ P.sh. OHCHR, UNHCR, UNICEF dhe ICRC.

agjencive në kuadër të UNMIK-ut. Shumica prej këtyre departamenteve dhe agjencive janë të ngarkuara me përgjegjësinë për gjetjen e mjeteve dhe zgjidhjeve konkrete për problemet kyçe (p.sh. nevojat për përkrahjen materiale të gjyqësisë, çështjet e sigurisë, keqpërdorimet në gjyqësi dhe stërvitjen *inter alia* të profesionistëve ligjor).

E Drejta në gjykim objektiv (të drejtë)

Standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut janë pjesë e legjislacionit pozitiv në bazë të *inter alia Rregullores 1999/24*, e cila obligon bartësit e funksioneve publike në Kosovë që t'i përmbahen standardeve të pranuar ndërkombëtarisht mbi të drejtat e njeriut e së voni përmes Kornizës Kushtetuese.⁵ Krahas kësaj, Republika Federative e Jugosllavisë është palë e një numri të instrumenteve për të drejtat e njeriut, përfshirë këtu edhe *Konventën Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike* (KNDCP), e cila për ndryshe obligon secilin organizëm qeveritar në këtë territor që t'i garantojë popullit të Kosovës këto të drejta.

SMSL analizon ligjin dhe praktikën vendore lidhur me pajtueshmërinë e tyre me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe objektivitetin në procedurën penale. Standardet ndërkombëtare janë të precizuara, *inter alia* në nenet 9,10,14 të KNDCP dhe nenet 5,6 të *Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut* (KEDNj) dhe standardeve tjera të KB që nuk përfshihen në Pakte. Ligji vendor – kryesisht *Ligji i Procedurës Penale i RFJ-së* (LPP) dhe *Ligji Penal i Kosovës* (LPK), në bazë të analizës së SMSJ-së. Analiza e “Gjykimit objektiv” në bazë të legjislacionit ndërkombëtar për të drejtat e njeriut fillon prej momentit kur individi arrestohet nga ana e autoriteteve, deri në shtjellimin përfundimtar të rastit.

SMSL monitoron rastet të cilat përshkojnë tërë sistemin penal të drejtësisë, prej momentit të arrestimit dhe/apo paraburgosjes(paraburgimit) deri te gjykimi dhe ankesa. SMSL, monitoron rastet që kanë të bëjnë me vepra të rënda penale, shumica prej të cilave janë të parapara nga SMSL, si raste prioritare dhe që bijnë në kompetencën e gjykatave të qarkut. Disa raste në gjykatat komunale apo ato kundërvajtëse mund të monitorohen nëse përfshijnë çështje prioritare siç janë rastet ku përfshihen minoritetet, të miturit dhe femrat.

Para pjesëmarrjes në procedurën formale të gjykimit, dhe aty kur kjo është praktike, monitoruesit e SMSL-së, hetojnë rastin në mënyrë që të sigurohen se ka pasur mundësi të parashtrihen dhe të trajtohen të gjitha çështjet lidhur me të drejtat para fillimit të gjykimit. Hetimi në fjalë krijon bazën për monitoruesit e SMSL-së, për analizën e procedurës gjyqësore. Monitoruesit e SMSL-së, mbledhin të dhëna duke shqyrtuar lëndën, nëse ka qasje; dhe, bëjnë intervistimin e të dyshuarve/të burgosurve, policisë/KFOR-it, avokatëve mbrojtës, prokurorëve publik, gjykatësve hetues dhe të tjerëve. Monitoruesit e SMSJ-së, marrin pjesë në gjykime dhe raportojnë mbi praktikën e përdorur në procedurën para-penale dhe atë penale dhe në pikëpamje të standardeve ndërkombëtare dhe vendore.

⁵ Rregullorja e UNMIK-ut 2001/09 mbi Kornizën Kushtetuese për Vet-Qeverisjen e Përkohshme, e adoptuar më 15 Maj 2001, Kaptina 3, SEKSIONI 3.3.

Rastet prioritare

Në vijim është udhëzimi për rastet prioritare gjatë gjashtë muajve të fundit. Çështjet që kyqin qasjen dhe efektivitetin e mbrojtësit si dhe mos-mirësjelljen e prokurorëve dhe gjykatësve janë të mbuluara në kontekstin e monitorimit të rastit.

Krimet e luftës

Krimet e motivuara etnikisht

Krimet e motivuara politikisht

Dhuna seksuale përfshirë këtu edhe viktimat e dhunës familjare dhe të trafikimit të femrave.

Trajtimi i të miturve

Paraburgimi

Gjykimet në Gjykatat Komunale dhe Gjykatat për Kundërvajtje

SMSL, monitoron burgjet vetëm përkitazi me çështjet e “qasjes në drejtësi”. SMSL, nuk monitoron burgjet për çështjet e kushteve nëpër burgje apo të keqtrajtimit nëpër burgje meqenëse këto çështje janë të mbuluara nga zyrtarët e OSBE-së për të drejtat e njeriut dhe KNKK-së.

SEKSIONI 2: LIGJI I APLIKUESHËM

I. ZHVILLIMET E THEKSUESHME NË LIGJIN E APLIKUESHËM.

Në gjashtë muajt që kaluan pas shqyrtimit të fundit, ishin bërë disa zhvillime të theksueshme në ligjin e aplikueshëm, disa prej të cilave janë përmendur më poshtë.

Rregullorja e UNMIK-ut 2001/07 mbi autorizimin e posedimit të armëve në Kosovë ka hyrë në fuqi më 21 shkurt 2001, për të kontrolluar në mënyrë strikte pronësinë, posedimin, dhe përdorimin e armëve, me qëllim të forcimit të sigurisë publike dhe rendit në Kosovë.

Rregullorja e UNMIK-ut 2001/08 mbi themelimin e Këshillit Gjyqësor dhe të Prokurorisë në Kosovë, e hyrë në fuqi më 6 prill 2001, themelon Këshillin Gjyqësor dhe të Prokurorisë, përgjegjës për këshillimin e PSSP mbi çështjet në relacion me emërimet, zgjatjet e kontratave, dhe largimin nga zyret e gjykatësve, prokurorëve dhe gjykatësve porot. Këshilli gjithashtu është kompetent për të vendosur mbi masat disiplinore kundër anëtarëve të gjyqësisë vendore, pas hetimeve të zhvilluara nga vet Këshilli apo nga Njësia e Inspektionit Gjyqësor brenda DAD. Këshilli është i obliguar të adoptoj Kodin e Etikës për gjyqtarët.

Rregullorja e UNMIK-ut 2001/09 mbi Kornizën Kushtetuese për Vetëqeverisjen e Përkohshme në Kosovë, e nënshkruar më 15 maj 2001, vendos strukturën e institucioneve të ardhshme në Kosovë dhe gjithashtu mekanizmin e ndër-veprimit në mes këtyre institucioneve. Korniza Kushtetuese në mënyrë eksplicite deklaroi se një numër i instrumenteve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut janë drejtpërdrejtë të aplikueshme në Kosovë.

Rregullorja e UNMIK-ut 2001/10 mbi ndalimin e kalimit të paautorizuar të kufirit shtetëror/administrativ (24 maj 2001) sanksionon personat e gjetur duke kaluar apo pasi kanë kaluar kufirin apo zonën kufitare të Kosovës, në pikën e paautorizuar kufitare.

Rregullorja e UNMIK-ut 2001/12 mbi ndalimin e terrorizmit dhe veprave në lidhje me zë, e hyrë në fuqi më 14 qershor 2001, sanksionon aktivitetin e personave dhe organizatave të cilat tentojnë të krijojnë kërcnim serioz për rendin publik, ta shtrëngojnë qeverinë apo organizatën ndërkombëtare apo të frikësojnë popullatën civile, për shembull në rastet e vrasjes, lëndimit të rëndë trupor, kidnapimit, helmimit të ushqimit apo ujit, shkakimit të rrezikut të përgjithshëm, prodhimit apo prokurimit të armëve, apo piratërisë së aeroplanit.

Rregullorja e UNMIK-ut 2001/18 mbi themelimin e Komisionit për rishqyrtim të paraburgimit, për paraburgimet jashtë gjyqësore të bazuara në urdhërat ekzekutiv ka hyrë në fuqi më 25 gusht 2001. Rregullorja siguron një mekanizëm për rishqyrtimin e paraburgimeve të urdhëruara nga PSSP.

II. ÇËSHTJET QË RRJEDHIN NGA SHQYRTIMET E FUNDIT TË SMSL

Përderisa, SMSL, në shqyrtimet e mëparshme adresoi çështjet e aplikueshmërisë së drejtpërdrejtë të standardeve të njohura ndërkombëtarisht për të drejtat e njeriut në Kosovë dhe kontestoi praninë e teknikave ligjore për implementimin e tyre, çdo konfuzion lidhur me aplikimin e këtyre standardeve përfundimisht duhet të marrë fund. Korniza Kushtetuese deklaroi (neni 3.1) se “Të gjithë personat në Kosovë duhet të gëzojnë, pa diskriminim mbi ndonjë bazë dhe në barazi të plotë, të drejtat e njeriut dhe liritë fundamentale”, dhe gjithashtu thekson se ligjet e të drejtave të njeriut ashtu siq parashihen në instrumentet ndërkombëtare kryesore, janë drejtpërdrejtë të aplikueshme në

Kosovë⁶. Posa të zgjedhen apo emërohen, institucionet e përkohshme janë të obliguara që të vëzhgojnë dhe sigurojnë të drejtat e njeriut dhe liritë fundamentale të njohura ndërkombëtarisht. Rrjedhimisht, tani është e qartë se çdo institucion, trup administrativ, organizatë apo “prezencë” në Kosovë, qoftë vendor apo ndërkombëtar, është i obliguar në përmbushjen e kërkesave e ligjit ndërkombëtar për të drejtat e njeriut.

SMSL gjithashtu ka shprehur shqetësim përkitazi me vonesat e paarsyeshme në dorëzimin e aktgjykimeve. Ligji vendor thekson se aktgjykimet e shkruara duhet të dorëzohen brenda tetë ditësh, apo përjashtimisht brenda pesëmbëdhjetë ditësh nga shpallja e aktgjykimit. Sipas informatave statistikore në disponim të SMSL, vonesat ndryshojnë prej regjionit në regjion. Në Prizren p.sh. vonesat zgjasin deri në dy muaj për dorëzimin e aktgjykimeve të shpallura këtë vit, në Gjilan vonesat ndryshojnë prej një ditë deri në gjashtë muaj, dhe në Mitrovicë vonesat ishin deri në tetë muaj. Këto vonesa paraqesin shqetësime nga dy aspekte. Së pari, ato mund të sjellin gjer te shkelja e të drejtës për shqyrtimin me kohë të vendimit nga gjykata më e lartë, e kjo sjell gjer tek mohimi i drejtësisë. E dyta, kjo krijon një klimë të pasigurisë ligjore e cila është vendimtare për krijimin e shoqërisë së bazuar në sundimin e së drejtës dhe respektin për të drejtat e njeriut.

Raporti i fundit i SMSL mbi sistemin e gjyqësisë penale theksoi një numër mungesash në përkrahjen mjekësisë ligjore/forenzike për sistemin gjyqësor të Kosovës. Një fushë tjetër e shqetësimit, ishte kapaciteti i kufizuar i policisë që të mbledh dhe analizoj provat forenzike. Fushë tjetër brengosëse ishte shërbimi i pakënaqshëm i ofruar nga Instituti i Mjekësisë Ligjore, posaçërisht mbledhja e provave forenzike në rastet e dhunës seksuale. Ishin bërë rekomandimet në nivelin e OSBE dhe brenda Policisë së UNMIK-ut, për të adresuar këto probleme përmes projekteve të mëdha, siq ishte krijimi i laboratorit plotësisht të pajisur të Policisë Forenzike dhe restrukturimi dhe ri-pajisja e Institutit të Mjekësisë Ligjore të Kosovës. Gjatë gjashtë muajve të fundit, sidoqoftë, asnjë nga këto projekte nuk është zhvilluar përtej fazës së planifikimit, dhe problemet e theksuara në raportin e fundit mbesin të shumtën, të njëjtat. Janë ndërmarrë iniciativa të pavarura nga Njësia Forenzike Policore, për të forcuar shërbimin ekzistues, përfshirë edhe krijimin e njësive që kanë të bëjnë me krahasimin balistik dhe analizat e shenjave të gishtërinjëve. Njësia Forenzike policore ka themeluar një ekip të vogël të “Vendit të krimin” dhe po trajton një numër të zyrtarëve të SHPK për teknikat e mbledhjes së provave në vendkrimet relevante. Sidoqoftë, mungesa e një laboratorit të qasshëm forenzik, vazhdon të pengoj punën e Njësive Forenzike.

Një tjetër çështje rrjedhëse në të cilën ishte fokusuar SMSL në raportet paraprake, ishte përkthimi i vonuar dhe shpërndarja e rregulloreve të UNMIK-ut.⁷ Gjatë monitorimit të aktiviteteve të gjykatave, SMSL ka dokumentuar një numër situatash ku gjykatësit apo prokurorët nuk kanë qenë në dijeni mbi ndryshimet në ligjin e aplikueshëm që kanë ndodhur përmes rregulloreve të UNMIK-ut. Çështje në relacion me këtë, është se anëtarët

⁶ Shiko Kornizën Kushtetuese, 3.3 “Dispozitat mbi liritë dhe të drejtat të vendosura në këto instrumente do të jenë direkt të aplikueshme në Kosovë.”

⁷ Sipas komenteve nga DAD, problemet në shpërndarjen e Rregulloreve të UNMIK-ut, I referohen faktit se ato nuk përkthehen me kohë në mënyrë që të shpërndahen me kohë.

e Odës në mënyrë të vazhdueshme kanë raportuar se ata nuk janë në gjendje të kenë qasje në rregulloret e reja. Nga 18 rregulloret e UNMIK-ut të miratuara gjer në gusht 2001, vetëm tetë janë përkthyer në shqip (andaj janë në disponim) dhe vetëm një ishte përkthyer në gjuhën serbe.⁸ Sipas informatave të OSBE-së, ka gjithashtu rregullore që janë miratuar vitin e kaluar, e që ende nuk janë përkthyer.

III. ZHVILLIMET BRENDA SISTEMIT TË GJYQËSISË DHE STATUSI I IMPLEMENTIMIT TË REKOMANDIMEVE TË SMSL

Instituti Juridik (Gjyqësor) i Kosovës

Në raportet e mëparme, SMSL rekomandoi trajnimet relevante për gjykatës dhe prokuror. Instituti Juridik i Kosovës (IJK) tani po ofron kurse njoftuese mbi Ligjin e Procedurës Penale të Republikës Federale të Jugosllavisë, si dhe seminarë dhe diskutime të tryezave të rumbullakëta për gjykatës dhe prokuror, mbi ligjin ndërkombëtar mbi të drejtat e njeriut. Një zhvillim i rëndësishëm ishte edhe incimi i seminareve të rregullta dhe diskutimet e tryezave të rumbullakëta për të siguruar udhëzimet mbi aplikimin dhe interpretimin e legjislacionit të ri të adoptuar. Sidoqoftë, SMSL rekomandon diskutime më të thella mbi secilën pjesë të rëndësishme të legjislacionit të ri, pasi që një prezentim i përgjithësuar i domenit të rregulloreve të caktuara, është i pamjaftueshëm për tu siguruar se anëtarët e gjyqësisë, me të vërtetë të kuptojnë të gjitha aspektet teorike dhe praktike të saj. Ky rekomandim posaçërisht ka të bëjë me ato rregullore të UNMIK-ut, të cilat i referohen, por nuk janë të shoqëruara me normat e përshtatshme teknike, përkritazi me aplikueshmërinë e tyre.

Iniciativa të ngjashme trajnuese duhet gjithashtu të përfshijnë gjykatësit dhe prokurorët ndërkombëtar të emëruar në Kosovë. Ndarazi përvojës së padyshimtë në shtetet e tyre të lindjes, këta anëtarë të gjyqësisë së Kosovës nuk janë – gjë që kuptohet – të njoftuar me ligjin e aplikueshëm në Kosovë, andaj mund të përfitojnë nga trajnimet njoftuese të cilat do tu ofrojnë atyre së paku një rishikim mbi sistemin ligjor ekzistues në Kosovë.

Qendra Burimore për Mbrojtje Penalo Juridike

Është bërë e ditur se janë bërë përpjekje të mëdha nga komuniteti ndërkombëtar, e posaçërisht nga OSBE, për të ofruar trajnim për gjykatës dhe prokuror, përpjekje të ngjashme të cilat nuk janë bërë edhe për anëtarët e Odës. Me qëllim të ofrimit të ekspertizës së menjëhershme ligjore mbi standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut për rastet individuale dhe forcimit të kapaciteteve të mbrojtësve ligjor vendor, OSBE, në bashkëpunim me Odën e Avokatëve të Kosovës, ka themeluar Qendrën Burimore për Mbrojtjen Penalo Juridike (QBMPJ). Qendra gjithashtu është përqëndruar në zhvillimin e kujdestarisë së mbrojtësve ligjor ndërkombëtar dhe klinikave ligjore për të siguruar

⁸ Informatat në dispozicion nga UNMIK-Intranet.

hulumtime dhe ndihma projektuese përmes e-mailit apo fax-it, dhe për të zhvilluar një bazë të dhënash për ekspertët ndërkombëtar dhe vendor për ndihmën trajnuese dhe regrutimin e personelit të kualifikuar.

Njësia e Inspektionit Gjyqësor dhe Këshilli Gjyqësor dhe i Prokurorisë

Në maj 2001, një njësi e re ishte themeluar brenda seksionit të Shërbimit të Prokurorisë dhe Administrimit të Gjykatave të DAD, Njësiti i Inspektionit Gjyqësor (NJIGJ), që kishte për detyrë analizimin dhe vlerësimin e funksionimit të gjykatave dhe zyrave të prokurorisë, si dhe hetimin e aktiviteteve të anëtarëve individual të sistemit gjyqësor, se a ishin apo jo individët e tillë subjekte të ankesave.⁹ SMSL në raportet paraprake ka rekomanduar krijimin e një organi hetimor, diciplinar dhe këshilldhënës, dhe konsideron se njësia e posaçmërisht ka një rol të rëndësishëm në rregullimin e qasjes së gjithëmbarshme të gjykatësve dhe prokurorëve drejt përgjegjësisë më të madhe ndaj zyrave të tyre. SMSL ka themeluar raporte të mira pune me NJIGJ, duke i ofruar një prapavijë mbi rastet e monitoruara, të cilat mund të përdoren nga NJIGJ në veprimet e tyre hetimore.

Ndikimi pozitiv i NJIGJ në përgjegjësinë gjyqësore edhe më tepër është forcuar me themelimin e Këshillit Gjyqësor dhe të Prokurorisë së Kosovës (KGJPK).¹⁰ Aktivitetet e saj pritet që edhe më shumë të promovojnë ndjenjën e vetëdiciplinës dhe përgjegjësisë në gjyqësi dhe, nëse kjo nuk ndodhë, të ofrojnë një lloj shqyrtimi të pavarur diciplinar të sjelljes dhe aktivitetit të gjykatësve dhe prokurorëve individual.

Planet për ristrukturimin e Institutit Forenzik

DAD kishte punuar në buxhetin dhe termet e referimit të Institutit të ri Forenzik të Kosovës. Instituti i ri do të jetë jashtë kontrollit të Departamentit të Shëndetësisë, dhe ka gjasa se do të vendoset në Shtyllën e I-rë. Ky ristrukturim i pritur gjatë, ka për qëllim që “të bëjë të mundshme integrimin e plotë të Institutit Forenzik të Kosovës në administrimin e drejtësisë, identifikimin e faktorëve negativ në çështjet e shëndetësisë, dhe në edukimin dhe trajnimin e profesionistëve të tanishëm dhe të ardhshëm mjekoligjor dhe personelit para-profesional.” SMSL përshëndet dhe mbështet plotësisht iniciativën, pasi që e njëjta mund të adresoj disa nga shqetësimeve të SMSL, lidhur me rastet e dhunës seksuale.

Implementimi i rekomandimeve të SMSL

Rekomandimet e SMSL në raportet e mëparme, ishin adresuar brenda grupit punues, përfshirë përfaqësuesit e OSBE dhe DAD, i themeluar pas shqyrtimit të parë gjashtëmujor. Grupi punues ka pasur mandatin që të analizoj rekomandimet dhe të projektoj propozimet e rregullave të drejtuara autoriteteve relevante. Me themelimin e

⁹ Në tetor 2001, 49 ankesa kundër gjykatësve dhe prokurorëve i janë referuar NJIGJP, 25 prej tyre janë hetuar.

¹⁰ KGJP gjykoi 2 raste të parashtruara për procedurë disiplinore, dhe në njërin prej tyre, gjykatësi ishte shkarkuar nga detyra e në rastin e dytë, gjykatësi i ishte tërhequr vëmendja.

Shtyllës së I-rë, janë vendosur struktura të reja për të implementuar rekomandimet si nga Shtylla e I-rë ashtu edhe nga burimet tjera, përfshirë OSBE-në – dhe për tu dhënë këshilla vendim-marrësve mbi strategjinë dhe rregullat e përcaktuara, për të përmbushur objektivat e shtyllës së re. Struktura udhëheqëse e Shtyllës së I-rë përfshin bordin udhëheqës, që këshillon mbi qëshjet kritike dhe i raporton drejtëpërdrejtë PSSP-së, dhe gjashtë kolegjet të përcaktuara nga bordi udhëheqës, që zhvillojnë punë përgjatë tërë spektrit të gjërë të rregullave.

Përkundër dimenzionit të saj të ndërtimit të kapaciteteve brenda lëmisë së gjyqësisë dhe zbatimit të ligjit, dhe dimenzionit të monitorimit të të drejtave të njeriut, OSBE ende nuk është përfshirë në bordin udhëheqës. Nga gjashtë kolegjet, OSBE merr pjesë në tri, që mbulojnë lëmitë e zbatimit të ligjit, punëve juridike dhe zhvillimit legjislativ. Këto kolegje ulin së bashku autoritetet ekzekutive, autoritetet e ndërtimit të kapaciteteve dhe agjencitë implementuese dhe si rezultat, rekomandimet për përmirësimin e sistemit të gjyqësisë penale mund të përcillen nga kolegjet përgjatë tërë implementimit të tyre dhe të vlerësohen për efektivitetin e tyre. Shpresojmë, ky proces do të provohet si efektiv dhe transparent, ashtu që problemet e identifikuara në sektoret e ndryshme të sistemit gjyqësor mund të adresohen me shpejtësi dhe, nëse konsiderohen relevante, mund të inkorporohen efektivisht në normat e aplikueshme. Për shkak të mandatit të saj, dhe dijënisë së thuktë të sistemit, është kruciale që OSBE të jetë e kyqur në procesin e ofrimit të një strukture gjithëpërfshirëse dhe punuese për sistemin gjyqësor.

SEKSIONI 3: E DREJTA NË PËRFAQËSIM EFEKTIV LIGJOR

I. DETYRIMET E AUTORITETEVE

Të drejtat themelore të përfaqësimit ligjor për personat e paraburgosur dhe personat e akuzuar për vepra penale, janë përshkruar në nenin 5 dhe 6 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Fundamentale (KEDNJ), si dhe në nenin 9 dhe 14 të Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike (KNDCP). Dokumentet e tjera ndërkombëtare relevante janë Rregullat Standarde Minimale Për Trajtimin e të Burgosurve, si dhe Parimet Themelore të Rolit të Mbrojtësit. Siq është përmendur edhe në raportet e kaluara, e drejta për përfaqësim ligjor aplikohet në të gjitha fazat e procedurës penale dhe me rëndësi të veçantë kur personi është i paraburgosur është që të sigurohet që parimet e korrektësisë dhe barazisë së armëve (mjeteve ligjore) të respektohen.¹¹ Ajo është gjithashtu një mbrojtës kundër keqpërdorimit të drejtave siç janë ndalimi i torturave apo trajtimit johuman apo degradues. Kur ndihma ligjore është siguruar, autoritetet relevante janë të obliguara të sigurojnë që kjo ndihmë të jetë efektive.¹²

Qasja në mbrojtësit gjatë mbajtjes në arrest policor

Sipas ligjit vendor i akuzuari mund të ketë mbrojtës gjatë gjithë rrjedhës së procedurës penale, por i akuzuari i cili është në paraburgim ka të drejtë që të komunikoj me mbrojtësin vetëm *pasi* që ai apo ajo të jetë formalisht i marrun në pyetje nga gjyqtari.¹³ Kjo mund të jetë pasojë e faktit se i akuzuari është definuar si person kundër të cilit formalisht janë bërë hetimet dhe se ligji i aplikueshëm nuk parasheh që organet e rendit të marrin në pyetje një person si të *dysshuar*, para se ai person të sillet para gjyqtarit.¹⁴ Nën këto rrethana, nevoja për qasje në mbrojtës do të ishte e një rëndësie më të vogël, se që kishte me qenë në sistemin ku policia ka autoritet të pavarur hetimor.¹⁵ Ndonëse kjo zvogëlon rrezikun e pasojave negative që rrjedhin nga veprimet e painformuara të të pandehurit, i cili mund të ndikoj në hetime, prap se prapë është në konflikt me dispozitat ndërkombëtare të përmendura më lart.

Pas luftës së vitit 1999, dhe nën përgjegjësinë e forcave policore ndërkombëtare të UNMIK-ut, është zhvilluar një sistemi ku policia kryen hetimet e krimeve dhe merr në pyetje të dyshimtit, pak a shumë në mënyrë të pavarur, përpara se të sillnin lëndët në gjykatë. Nën këto rrethana, është parësore që i dyshuari të ketë qasje në mbrojtës që nga fillimi i hetimeve policore, e në veçanti në rastet kur i dyshuari gjendet në paraburgim.

¹¹ *John Murray v. UK*, 8 Shkurt 1996, al. 66.

¹² *Artico v Italy*, 13 Maj 1980, Alinea.33.

¹³ Neni 67 (1) dhe (1) i LPP RFJ

¹⁴ Për definimin e të akuzuarit shiko në Nenin 147. Duke u bazuar në Nenin 151 LPP RFJ, policia është e obliguar që të merr masa të nevojshme për gjetjen e të dyshuarve për vepra penale të cilat ndiqen ex-officio (alinea 1), dhe në këtë drejtim mundet të kërkoj informata nga qytetarët (alinea 2, 3 & 5) po akuzat penale të hartuara nga hetimi i tillë nuk duhet të përmbajnë përmbajtjen e deklaratave nga qytetarët individual.

¹⁵ Lidhur me hetimet penale në përgjithësi, shiko nenin 151,152, 153 (2), 155 dhe 161 të LPP RFJ dhe personave që janë në paraburgim, shiko nenin 192, 195 dhe 196 LPP RFJ.

Është poashtu me rëndësi, që posa një person të identifikohet si i dyshuar, ai/ajo të informohet mbi të drejtën e tij/saj në mbrojtës. Sipas ligjit vendor, policia nuk është e obligueshme të informoj të dyshuarin mbi të drejtat e tij/saj, ndoshta për shkak të konceptit se personi nuk konsiderohet *i dyshuar*, para fillimit formal të hetimeve sipas vendimit të gjykatës.

Ishte kontestuar se madje edhe nën ligjin vendor, personi i cili është në paraburgim policor ka të drejtë në mbrojtës, kur ai është i paraburgosur në bazë të rrethanave të jashtëzakonshme të parashikuara në nenin 196 të LPP RFJ.¹⁶ Sipas nenit 196 LPP RFJ, paraburgimi duhet të urdhërohet me urdhëresë me shkrim, kundër të cilit mund të paraqitet ankesa në afat prej 24 orësh, dhe *organet e rendit* do të sigurojnë që personi i paraburgosur, të pranoj *ndihmën e nevojshme profesionale* në përpilimin e ankesës.¹⁷ Formulimi i dispozitës nuk është i qartë, mirëpo sipas komentit, ekzistojnë argumente bindëse që përkrahin leximin e kësaj dispozite sikur ajo i lejon të pandehurit që me ndihmën e mbrojtësit të përpiloj ankesën.¹⁸ Andaj, pasi që është bërë më tepër një rregull se sa përjashtim që policia e UNMIK-ut, të mbaj personin në paraburgim policor për 72 orë para se ta sjellin te gjyqtari, policia ka për obligim që të arrestuarit t'i mundësoj qasje në mbrojtës edhe deri sa është në paraburgim policor.¹⁹

Projekt Rregullorja mbi qasjen në mbrojtës për personat e arrestuar nga policia

Pas diskutimeve të zgjatura, një rregullore mbi të drejtat e personave të arrestuar nga organet e rendit, u proklamua më 12 tetor 2001.²⁰ Rregullorja u lejon personave të cilët ishin arrestuar, të kenë të drejtë të informohen mbi shkaqet e arrestit, mbi të drejtën e heshtjes dhe të drejtën në ndihmën e mbrojtësit ligjor, në shpenzime të tij apo saj, ose pa pagesë, në rast se personit i mungojnë mjete financiare për të paguar për të. Ndonëse kjo rregullore pjesërisht zgjidh problemin e qasjes në mbrojtës, për personat e paraburgosur nga organet e rendit, sërish mbetet një numër problemesh të pazgjidhura. Njëri problem është se rregullorja duket të mos ketë efekt në paraburgimet jashtë-gjyqësore nga PSSP dhe COMKFOR-i.

Problem tjetër të cilin e krijon kjo rregullore është ai që, nën rrethana të caktuara, ajo i lejon organet e rendit të marrin në pyetje të paraburgosurit në mungesë të mbrojtësit, pa hjekur dorë shprehimsht nga e drejta në mbrojtës. P.sh. nëse mbrojtësi dështon të paraqitet, ndonëse është informuar për mbajtjen e dëgjimit, ndërsa organet e rendit konsiderojnë se shtyerja e mëtutjeshme do të ndikoj negativisht në zhvillimin e hetimeve, ata mund të vazhdojnë me marrjen në pyetje, në mungesë të mbrojtësit ligjor.²¹ Kjo

¹⁶ Komenti mbi Ligjin e Procedurës Penale, Branko Petric, Beograd 1986.

¹⁷ Neni 196 (3) i LPP RFJ.

¹⁸ Komenti mbi Ligjin e Procedurës Penale, Branko Petric, Beograd 1986.

¹⁹ Për detaje tjera lidhur me kushtet e paraburgimit, ju lutem shikoni në SEKSIONI mbi Paraburgimin.

²⁰ Ky Raport mbulon periudhën prej Marsit e deri në Gusht 2001.

²¹ SEKSIONI 3, 4 i Projekt-Rregullores mbi të Drejtat e Personave të Arrestuar nga Autoritetet Zbatuese të Ligjit e cila parashikon (Në tekstin e mëtejshëm: Rregullorja e Qasjes në Mbrojtës): Personi i arrestuar ka të drejtën që të ketë mbrojtës gjatë gjithë intervistave të bëra nga autoritetet zbatuese të ligjit. Nëse mbrojtësi nuk paraqitet në afatin kohor prej dy orësh nga koha e lajmërimit të tij lidhur me arrestimin, atëherë autoritetet zbatuese të ligjit do të marrin një mbrojtës alternativ. Atëherë nëse as mbrojtësi tjetër nuk paraqitet në afat prej një ore pas kontaktimit me autoritetet zbatuese të ligjit, personi i

dispozitë duket se në mënyrë efektive dënon të paraburgosurin për dështimin e mbrojtësit të tij/saj, që të veprojnë në pajtim me atë çka konsiderohet afat i kufizuar i lejuar për arritjen e mbrojtësit në vendin e paraburgimit.

Problem kyq në regulloren, e komentuar nga OSBE-ja është që prokurorit apo gjykatësit hetues i është dhënë autorizimi të vonojnë qasjen në avokat mbrojtës deri në 48 orë, në rastet kur personi i arrestuar është i dyshuar për terrorizëm apo për krim të organizuar, nëse prokurori apo gjykatësi hetues përcaktojnë se një vonim i tillë është kërkuar nga “nevojat e jashtëzakonshme të hetimeve”.²²

Këto dy dispozita sygjerojnë që qasja në avokat mund të kufizohet për të përmbushur nevojat e hetimeve, dhe më me rëndësi, se personat e dyshuar për veprat penale më të rënda, kanë të drejtat më të kufizuara përkitazi me qasjen në mbrojtësit, se personat nën hetime për vepra më pak serioze. Kufizimet e tilla të mëdha të qasjes në mbrojtës janë, gati plotësisht, në shkelje të ligjit mbi të drejtat ndërkombëtare të njeriut, e posaçërisht me KEDNJ, Neni 6(3), në lidhje me 6(1). Gjykata Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut, ka adresuar si të domosdoshme qasjen në mbrojtës qysh në fazat e para të paraburgimit dhe hetimeve, në një seri rastesh, që arritën kulminacionin kohët e fundit në rastin *Averill v BM* dhe *Magee v BM*. Në rastin e fundit GJEDNJ, ka paraqitur këndvështrimin e saj se “*mohimi i qasjes në mbrojtës për një kohë kaq të gjatë (24 orë) dhe në situatë kur të drejtat e mbrojtjes ishin të paragjykuara në mënyrë të papërmirësueshme, pa marrë parasysh arsyetimin për një mohim të tillë, është në kundërshtim me të drejtat e të akuzuarit sipas Nenit 6.*”²³

Dispozita të ngjashme në shtete tjera, në përpjekje të kufizimit të qasjes në mbrojtës në rastet e terrorizmit, janë dënuar nga organizatat ndërkombëtare, përfshirë edhe Komiteti Evropian për Parandalimin e Torturës (KEPT) në raportin më të ri të publikuar.²⁴ KEPT ka analizuar dispozitat në legjislacionin e Britanisë së Madhe në Irlandën Veriore të cilat ishin gati të identike me ato të rregullores, të cilat ndalojnë e qasjen në mbrojtës për 48 orët e para të paraburgimit në rastet e terrorizmit. KEPT ka adresuar çështjen e qasjes në mbrojtës, mundet që përjashtimisht të shtyhet qasja e të paraburgosurit në mbrojtësin e caktuar (të zgjedhur nga ai vetë), por kjo nuk e arsyeton kufizimin tek të gjithë mbrojtësit. Sidoqoftë, është theksuar se kjo nuk rezulton në mohimin e tërësishëm të kësaj të drejte për secilin avokat gjatë periudhës në fjalë. Komiteti rekomandoi se, në raste të tilla, duhet të organizohet qasja në mbrojtës të dytë, të pavarur, të cilit mund t’i besohet se nuk do të rrezikoj interesat legjitime të hetimeve.²⁵ OSBE ka rekomanduar që regullorja të rihartohet në mënyrë që të jetë në përputhshmëri me standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, në veçanti nëse është vonuar qasja në ndonjë mbrojtës të veçant, atëherë duhet të caktohet mbrojtësi tjetër alternativ nga ana e autoriteteve të rendit publik.

arrestuar mund të intervistohet vetëm nëse autoritetet zbatuese të ligjit determinojnë se vonimi i mëtutjeshëm mund të ndikoj në hetime.

²² SEKSIONI 3.6 Regullorja e Qasjes në Mbrojtës.

²³ *Magee v UK*, 6 Qershor 2000, Alinea 44, shiko gjithashtu *John Murray v UK*, Alinea 66.

²⁴ Komiteti Evropian për Parandalimin e Torturës, Vizita e bërë në Irlandën Veriore më 1999, 21/07/2000, KEPT (2000) 23.

²⁵ Komiteti Evropian për Parandalimin e Torturës, vizita e bërë në Irlandën Veriore më 1993. 17/11/1994, KEPT Inf (94) 17, Alinea 58.

Fatkeqësisht, rekomandimet e OSBE nuk janë marrë parasysh dhe verzioni final i rregullores, përmban kufizimin 48 orësh të qasjes në mbrojtjes.²⁶

Implikacionet e Projekt-rregullores mbi qasjen në mbrojtës për të miturit

Të miturve, si grup i ndieshëm, veçanërisht u nevojitet një mbrojtje për qasjen e tyre në mbrojtës. Sipas projek-rregullores, mund të hjeket dorë, nga e drejta për ndihmë të mbrojtësit, nëse ky veprim është bërë në mënyrë joformale dhe vullnetare. Kjo aplikohet si për madhorët ashtu edhe për të miturit, me prejashtim se të miturit mund të heqin dorë nga e drejta e tyre vetëm me pajtimin e prindit apo kujdestarit - me përjashtim kur të njëjtit janë të involvuar në dhunën familjare kundër të miturit – apo përfaqësuesit nga QPS.²⁷ I mituri, madje edhe me pajtimin e prindit të tij, nuk do të jetë në gjendje që të heq dorë nga e drejta e tij për mbrojtës, sepse gjasat janë të vogla që të ketë situata ku i mituri do të mund të merr vendime plotësisht të informuara për të hjekur dorë nga e drejta e tij. Për më tepër, Seksioni 3.6, për të cilin është diskutuar më lart, lejon ndalimin e qasjes në mbrojtës për 48 orë edhe për të miturit, kështu që asnjë nga dispozitat e theksuara nuk kërkojnë prezencën dhe ndihmën e prindit apo personave tjerë të përshtatshëm, apo mbrojtësit gjatë marrjes në pyetje nga ana e policisë. Për shkaqe të qarta, standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, parandalojnë që i mituri të merret në pyetje i vetmuar, nga ana e autoriteteve policore.²⁸

Qasja në mbrojtës gjatë hetimeve paraprake

Ligji i Aplikueshëm

Sipas ligjit të aplikueshëm, para ekzaminimit të parë nga gjyqëtari hetues, *i dyshuari* do të informohet lidhur me të drejtën e tij që të angazhoj mbrojtës, dhe se mbrojtësi mund që të jetë i pranishëm gjatë marrjes në pyetje.²⁹ Nëse i paraburgosuri është memec, i shurdhër, mentalisht i paaftë apo i paaftë që të mbrohet në mënyre efektive, apo kur procedura është duke u zhvilluar për vepër penale për të cilën mund të shqiptohet dënimi me vdekje, atëhere ai ose ajo duhet që të kenë mbrojtësin që nga ekzaminimi i parë.³⁰ I mituri *duhet* që të ketë mbrojtësin që nga fillimi i procedurës pregaditore, në rastet kur është i dyshuar për vepër penale për të cilën është paraparë dënimi deri në pesë vite burgim apo kur gjyqtari për të mitur konsideron se i mituri duhet të ketë mbrojtës. Në rastet tjera, i mituri mund të ketë mbrojtës që nga fillimi i procedurës pregaditore, që është ekuivalente me hetimet paraprake për rastet e madhorëve.³¹

²⁶ Në fakt, verzioni final i rregullores, kufizon qasjen në mbrojtës edhe më shumë, duke siguruar në 3.5 që personi mund të intervistohet pa mbrojtës, nëse ekzistojnë dyshimi bazuar se mund të shpëtohet jeta e njerzve. Ky kriter i dobët, është i shtrirë përgjatë kufizimit të qasjes në mbrojtës.

²⁷ SEKSIONI 3. 5 i Rregullores në Qasjen në Mbrojtës.

²⁸ Shiko Nenin 40 (ii) &(iii) të Konventës për të Drejtat e Fëmijëve (KDF), apo KB Standardet e Rregullave Minimale për Administrimit e Drejtësisë për të Mitur (Regullat e Bejing), Regulla 7.1&15.2.

²⁹ Neni 67 (2) LPP RFJ. Përkthimi në gjuhën angleze gabimisht përdor termin i akuzuari e jo i dyshuari edhe pse neni 147 definon të akuzuarin si person ndaj të cilit zhvillohen hetimet.

³⁰ Neni 70 LPP RFJ Siq është shpjeguar nga UNMIK Qarkorja Gjyqësore/2000/17, Alinea 2. Dënimi më i rëndë ka qenë i çfuqizuar me Rregulloren e UNMIK-ut 1999/24.

³¹ Neni 455 LPP RFJ

Përkitazi me dispozitat *obliguese* që të miturit të kenë mbrojtës, kur janë të dyshuar për ndonjë vepër penale të rëndë, projekt-rregullorja mbi qasjen në mbrojtës, paraqet një hap mbrapa në krahasim me ligjin vendor, e cila lejon që i mituri të mirret në pyetje edhe pa prezencën e mbrojtësit apo kujdestarit ligjor, kur është hjekur dorë nga e drejta në mbrojtës apo kur kjo është konsideruar si e domosdoshme nga autoritetet e rendit (organet e ndjekjes).³² Nëse kushtet nuk janë plotësuar për një mbrojtje të obligueshme, dhe i dyshuari është i paaftë materialisht të paguaj mbrojtësin, atëhere mbrojtësi *do t'i* sigurohet në bazë të kërkesës së tij, që nga marrja e parë në pyetje, për çfarëdo dënimi të mundshëm prej më së paku gjashtë muajsh. Dhe më në fund, nëse personi i dyshuar për vepër penale më të lehtë, mbrojtësi *mund t'i* caktohet me kërkesë që nga marrja e parë në pyetje, nëse interesat e drejtësisë e kërkojnë një gjë të tillë.³³ Këto dispozita janë në përputhshmëri me kërkesat e ligjit ndërkombëtar.

Sidoqoftë, ekzistojnë disa dispozita të cilat rëndë kufizojnë të drejtën për ndihmë efektive nga mbrojtësi. Më shumë se një i akuzuar mund që të kenë të njëjtin mbrojtës, nëse kjo nuk ndikon në mënyrë negative në mbrojtje.³⁴ Mbrojtësi *mund* të merr pjesë në dëgjimin e të akuzuarit, por mund që përjashtimisht të përjashtohet nëse këtë e kërkojnë arsyet e veqanta të sigurisë kombëtare.³⁵ Nëse nga e drejta për mbrojtës nuk është hequr dorë dhe e njëjta nuk është e obligueshme sipas ligjit, i paraburgosuri mund të dëgjohet gjatë *hetimeve* edhe pa praninë e mbrojtësit nëse ai dështon të paraqitet ndonëse i njoftuar lidhur me mbajtjen e dëgjimit, gjë që ndikon negativisht në të paraburgosurin për bazat të cilat janë jashtë kontrollit të tij/saj; apo kur i dyshuari nuk ka mundur të siguroj mbrojtësin në afat prej 24 orësh pasi që është informuar lidhur me këtë të drejtë.³⁶ Mbrojtësi mund të komunikoj me të paraburgosurin vetëm *pas* marrjes së tij në pyetje. Komunikimi në mes të mbrojtësit dhe të paraburgosurit *mund të mbikqyret* sipas urdhëresës nga gjykata, deri sa të ngritet aktakuza kundër tij.³⁷

Gjykimi mund të mbahet në mungesë të mbrojtësit, nëse rrethanat indikojnë se nuk do të ketë rëndësi të madhe për mbrojtjen dhe ku mbrojtësi nuk ka arritur të paraqitet edhe pse është ftuar me rregull e i pandehuri nuk ka pasur mundësi që të angazhoj menjëherë një mbrojtës tjetër. Në rastet e mbrojtjes *ex officio*, ku nuk është e mundur që i pandehuri menjëherë të angazhoj mbrojtës tjetër apo mbrojtës të caktuar nga ana e gjykatës, nëse kjo nuk rëndësi të madhe për mbrojtje, *gjykimi* do të shtyhet.³⁸ Argumentet e njëjta të cilat i kundërpërgjigjen kufizimit të qasjes në mbrojtje për personat në paraburgim policor vlejné edhe këtu. Dhe siq është theksuar më lart, çfarëdo kufizimesh në qasjen në mbrojtës duhet që të jenë në proporcion strikt, e jo si në këtë rast, t'i lihet në diskrecion gjykatës.

³² Neni 3.5& 3.6 Regullorja e Qasjes në Mbrojtës

³³ Neni 71 LPP RFJ i ndryshuar me Qarkoren e UNMIK/2000/17

³⁴ Neni 68 (1) LPP RFJ.

³⁵ Neni 67 (1), 73 (2) dhe 218 (9) LPP RFJ.

³⁶ Neni 218(9) LPP RFJ.

³⁷ Neni 74 LPP RFJ.

³⁸ Neni 301 LPP RFJ

Praktika gjyqësore

Ende ka shqetësime mbi dispozitat aktuale të ndihmës ligjore. Para paraqitjes në marrjen në pyetje para policisë, personat e arrestuar shpesh nuk kanë qenë në gjendje që të sigurojnë mbrojtësin, pasi që sipas ligjit të aplikueshëm, ata as nuk kanë patur të drejtë për mbrojtës, e as që të jenë të informuar mbi të drejtën në mbrojtës, apo nuk u janë ofruar mjete për të kontaktuar personat tjerë. Përgjithësisht, vetëm para fillimit të marrjes në pyetje para policisë, i dyshuari është informuar mbi të drejtën në mbrojtës. Nga nëpunësi gjyqësor më pastaj kërkohet që të vërtetoj se a ka ndonjë mbrojtës në dispozicion në gjykatë, i cili mund të asistoj në marrjen në pyetje para policisë. SMSL ka observuar se, shpeshherë, mbrojtësi i emëruar në dëgjimin policor nuk ndërmerri veprime të mëtejme në emër të të paraburgosurit, pra emërimi tij/saj ka vlerë të vogël për të paraburgosurin.

Pasi që emri i mbrojtësit të emëruar nuk shënohet në vendimin për paraburgim, apo në ndonjë dokument tjetër që i dorëzohet të dyshuarit, është gjithashtu e zakonshme, posaçërisht në Mitrovicë, që të paraburgosurit të mos mbajnë në mend emrin e personit të caktuar si mbrojtës i tyre.³⁹ SMSL ka propozuar që të dyshuarit të sigurohen me njoftim me shkrim për mbrojtësin e tyre, përfshirë emrin dhe detajet kontaktuese. Kjo nuk është implementuar, sepse ishte kontestuar se nuk është në pajtim me ligjin vendor. Për më tepër, telefonat nuk janë në dispozicion për përdorim nga ana e të paraburgosurve në objektet e paraburgimit, duke vështirësuar kështu të paraburgosurit që të kontaktojnë, ose me mbrojtësin e tyre ose me ndonjë anëtar të familjes apo person tjetër me qëllim të gjetjes së mbrojtësit.⁴⁰

Në një rast në Gjykatën Komunale të Pejës, kundër një të mituri të akuzuar për vjedhje pylli, mbrojtësi është emëruar para fillimit të seancës kryesore, e cila filloi menjëherë, pa i dhënë rast fare mbrojtësit që të njoftohet me të miturin apo me shkresat e lëndës. Mbrojtësi e informoi SMSL se ai nuk kishte dijeni se a ishte i pandehuri i mitur në paraburgim apo jo. Gjatë gjykimit mbrojtësi ishte pasiv dhe shkoi para se të shpallej aktgjykimi. As i mituri e as babai i tij nuk e kishin takuar mbrojtësin më parë dhe as që ia dinin emrin. I mituri ishte shpallur fajtor dhe masat edukuese që konsistonin në mbikqyrjen e shtuar nga ana e prindëve, ishin shqiptuar kundër të miturit.

Në rastet e monitoruara nga SMSL, mbrojtësi ishte ndërruar gjatë procedurës, në disa raste edhe disa herë. Ndërrimi i mbrojtësit mund të jetë i dobishëm për të pandehurin, në rastet kur mbrojtësit jokompetent dhe pasiv zëvendësohen nga mbrojtësit e kualifikuar që ofrojnë ndihmë efektive. Sidoqoftë, në shumë raste, duket se mbrojtësi është emëruar vetëm sa për të përmbushur kërkesën formale sipas ligjit vendor, duke marrë pak në konsiderim obligimin e autoriteteve për të ofruar ndihmë efektive të mbrojtësit.

Në një gjykim në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë kundër një burri shqipëtar të Kosovës, të akuzuar për një incident “shkelje dhe ikje” ku ka vdekur një dhe janë lënduar rëndë tre fëmijë serb të Kosovës, i pandehuri është shpallur fajtor dhe është dënuar me tetë vite

³⁹ Shiko nenet 158 (3), 159 (1) dhe 192 (2) LPP RFJ, përkitazi me atë se çfarë të dhënash duhet të përmbajë vendimi për fillimin e hetimeve apo urdhëri për paraburgim.

⁴⁰ SMSL është informuar se në objektet mbajtëse të managjuara nga organet zbatuese të ligjit, ka telefona në dispozicion për përdorim nga të arrestuarit.

burg. Sipas raportit psikiatrik - i cili asnjëherë nuk ka hyrë në shkresat e lëndës-niveli i intelektit të të pandehurit ishte nën mesatare. Dëshmia e tij në gjykim ishte konfuze dhe ai dukej se nuk i kuptonte pyetjet që i bëheshin. Mbrojtësi ishte ndërruar pesë herë gjatë procedurës, dy herë gjatë hetimeve dhe tri herë në gjykim. Mbrojtësi i parë u tërhoq gjatë hetimeve dhe i dyti asnjëherë nuk veproi në emër të të pandehurit. I treti, i cili ishte emëruar ex officio, mori pjesë në seancën e parë por dështoi të marr pjesë në seancën e dytë, për shkaqe personale. Në vend të shtyerjes së marrjes në pyetje, para fillimit të ditës së dytë të gjykimit, kolegji me shumicë ndërkombëtarësh emëroi mbrojtësin e katërt për të përfaqësuar të pandehurin. Ky mbrojtës e informoi kolegjin se për shkak të punëve tjera nuk është në gjendje të marrë pjesë ditën vijuese. Kjo, prap, nuk bëri që gjykimi të nesërmen të shtyhet. Në ditën e tretë të gjykimit, ishte emëruar mbrojtësi i ri dhe ky mbrojtës e asistoi të pandehurin gjer në përfundim të seancës kryesore, bashkë me mbrojtësin i cili kishte marrë pjesë në seancën e parë. Në gjykim mbrojtësi dukej i papregatitur për të marrë në pyetje dëshmitarët dhe, thjesht, i përsëriste pyetjet që tashmë ishin pyetur nga kolegji.

Sipas ligjit vendor është paraparë se, më shumë se një i pandehur mund të përfaqësohen nga i njëjti mbrojtës. Ndonëse e lejuar sipas ligjit vendor, dhe jo automatikisht shkelje e të drejtës në mbrojtje efektive; kjo mund të çënoj të drejtën në gjykim korrekt sipas standardeve ndërkombëtare, kur konflikti i interesave bën ndikim në efektivitetin e mbrojtjes në drejtim negativ, dhe gjykata nuk ndërmerr masa për të penguar një ndikim negativ të tillë. Nëse konflikti rritet gjatë gjykimit, i pandehuri mund të jetë i paavancuar edhe nëse konflikti i interesave është zgjidhur, dhe është emëruar mbrojtësi i ri. Sipas Projekt-ligjit mbi procedurën penale, mbrojtësi mund të përfaqësoj më shumë se një të pandehur vetëm në rastin kur i pandehuri, pasi të ketë nënshkruar një njoftim me shkrim se është në dijeni mbi konfliktin e mundshëm të interesit, shprehimisht kërkon të njëjtin mbrojtës që të përfaqësoj edhe atë/ate.⁴¹

Në një rast përkitazi me disa akuza të vjedhjes së rëndë, grabitjes dhe plaqkitjes kundër pesë të pandehurve në Gjykatën e Qarkut në Pejë, dy prej të pandehurve ishin përfaqësuar nga i njëjti mbrojtës. Gjatë seancës kryesore, dy të pandehurit dhanë deklarata kontradiktore, duke treguar se aty kishte konflikt interesash në përfaqësimin e mbrojtësit për të dy të pandehurit. Në këtë rast, kryetari i kolegjit adresoi problemin duke e pyetur mbrojtësin se cilin nga dy të pandehurit dëshironte ta përfaqësonte. Pastaj, ishte emëruar mbrojtësi i ri për të pandehurin e dytë. Kjo sidoqoftë e la të pandehurin e dytë në pozitë të disfavorshme, pasi që gjykimi rifilloi pas pushimit 45-minutësh, duke i lejuar mbrojtësit të ri vetëm pak kohë për të përgatitur mbrojtjen.

Sipas ligjit të aplikueshëm, vizitorët duhet të kenë autorizim nga gjykata relevante për të pasur qasje tek të paraburgosurit. Ndonëse kjo nuk aplikohet shprehimisht te mbrojtësi, këto dispozita ishin aplikuar me qëllim që të bëjnë të domosdoshme për mbrojtësit, kërkimin e këtyre autorizimeve me qëllim të përfitimit të qasjes klientëve të tyre. Logjika prapa kësaj, ishte pushteti diskrecional i gjykatësit hetues që të urdhëroj që vizitat në mes të mbrojtësit dhe të paraburgosurit të jenë të mbikqyrura, deri sa të ngritet aktakuza.⁴²

⁴¹ Neni 72 (1) Projekti i Ligjit mbi Procedurën Penale (PLPP).

⁴² Neni 203 LPP RFJ, shiko gjithashtu Nenin 74.

Sipas informatave në disponim të SMSL, mbrojtësve iu nevojitet autorizimi gjyqësor për të vizituar klientët e tyre në Mitrovicë, Pejë, Prizren, dhe Gjiilan. Në Prishtinë, autorizimi gjyqësor nevojitet për të burgosurit ordinar, përderisa për të burgosurit e rrezikut të lartë, gjykatësi hetues aprovon listën e vizitorëve, dhe nëse mbrojtësi është përmendur në listë, ai apo ajo nuk ka nevojë për autorizimin e sërishëm për të vizituar klientët e tyre.⁴³

Kjo është brengosëse posaçërisht në Mitrovicë, ku gjykata është e vendosur në veri, që i detyron mbrojtësit shqiptarë të Kosovës, të presin për përcjelljen policore nga jugu për në gjykatë, për të marrë autorizimin për të vizituar klientët e tyre, e pastaj sërish të presin përcjelljen tjetër policore për në qendër të paraburgimit, gjithashtu të vendosur në pjesën veriore të qytetit. Mbrojtësit kanë raportuar se kanë llogaritur së paku gjysmën e ditës për të vizituar qendrat e paraburgimit dhe se kjo efektivisht i pengon ata nga vizitat e shpeshta për klientët e tyre, aq sa kishin dëshiruar. Të njëjtat brengosje janë relevante atëherë kur mbrojtësit përfaqësojnë personat të cilët nuk janë të paraburgosur në të njëjtin qark sikurse dhe gjykata në të cilën lënda e tyre pret.

Në Prizren dhe Mitrovicë, autorizimet e vizitave gjithashtu specifikojnë gjatësinë e minutave të cilët mbrojtësit mund t'i kalojnë me klientët e tyre. Në Prizren, autorizimet jepen për pesë deri në tridhjetë minuta dhe në Mitrovicë prej 10 dhe 20 minutash, ndonëse qendrat e paraburgimit nuk i mbikqyrin në mënyrë strikte kufinj të kohor. Koha e lejuar e vizitave, në kombinim me disa vizita të mbrojtësve, shtrun pyetjen se a i është dhënë të dyshuarit kohë e nevojshme për tu përgatitur për mbrojtjen e tij apo saj, siq kërkohet me Nenin 6 (3) (b) të KEDNJ dhe Nenit 14 (3) (b) të KNDCP.

Ndonëse mbrojtësit, përveq në një rast (shiko më poshtë), nuk kanë raportuar probleme përkritazi me fitimin e autorizimit, kjo praktikë prapëseprap është brengosëse. Fakti se, në shumicën e regjioneve, nga mbrojtësit kërkohet të vizitojnë gjykatën para çfarëdo vizite qendër së paraburgimit, mund paraqesë pengesë në kohë të shkurtër. Për më tepër, hyrja në fuqi e Kornizës Kushtetuese bën të qartë se komunikimi në mes të mbrojtësit dhe të paraburgosurit nuk mund të mbikqyret, andaj arsyetimi ligjor për të kërkuar nga mbrojtësit që të kërkojnë autorizimet e vizitave, pushojnë se ekzistuar.

Sipas ligjit vendor,⁴⁴ gjykatësi hetues *mund* të urdhëroj që komunikimi në mes të mbrojtësit dhe të paraburgosurit të mbikqyret derisa të ngritet aktakuza, gjë që sjell gjer tek shkelja e standardeve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.⁴⁵ SMSL ka shprehur shqetësim mbi këtë në raportet paraprake, dhe ka sygjëruar që ligji të ndryshohet. Ndonëse kjo nuk ka ndodhur akoma, duket se gjykatat nuk e aplikojnë më këtë dispozitë.

Në Mitrovicë, praktika e mbikqyrjes së vizitave në mes të mbrojtësit dhe të paraburgosurve nga ana e gjykatës është braktisur në qershor të 2001, pasi që OSBE në mënyrë përsëritëse ka theksuar se kjo praktikë shkakton shkeljen e standardeve ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut.⁴⁶ Sidoqoftë, në gusht 2001, Kryetari i Gjykatës së

⁴³ Janë kategori të ndryshme të burgosurve, të përcaktuar nga Komiteti Mbikqyrës i të Burgosurve, nga e cila kategoria A e të burgosurve janë personat që konsiderohen të jenë të rrezikshmërisë së lartë, për shkak të rrezikut të ikjes.

⁴⁴ Neni 74 i LPP RFJ.

⁴⁵ Neni 6 KEDNJ & Neni 14 KNDCP, Shiko gjithashtu Parimet për Mbrojtjen e të Gjithë Personave nën Çfarëdo Forme të Paraburgimit apo Burgimit, parimi 18 (4).

⁴⁶ Shiko p.sh. *S. v Zvicra*, 28 Nëntor 1991, alinea 48.

Qarkut në Mitrovicë i deklaroi SMSL se ishte udhëzuar nga bashkëudhëheqësja vendore e DAD, në atë kohë, se gjykatësi duhet të vendos se a do të jenë vizitat e mbikqyrura apo jo, dhe se sipas mendimit të saj do të ishte shkelje e ligjit vendor po t'i urdhërohej gjykatësit që të mos aplikoj këto dispozita. Gjatë një takimi në fillim të shtatorit 2001, bashkëudhëheqësja vendore e DAD i vërtetoi këtë mendim SMSL. Mbrojtësit ligjor nga Mitrovica, megjithatë, kan konfirmuar se që nga qershori 2001, atyre u është lejuar komunikimi konfidencial me klientët e tyre.

Pozita e Kryetarit të Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë dhe e ish-bashkëudhëheqëses kombëtare të DAD, duket të jetë në çenim të Rregullores së UNMIK-ut 1999/24, e cila thekson se në ushtrimin e funksioneve të tyre, të gjithë personat që kryejn detyra publike apo mbajnë zyra publike në Kosovë, do të marrin parasysh standardet ndërkombëtarisht të pranuar për të drejtat e njeriut, siq reflektohet në instrumentet e numëruara ndërkombëtare, në mesin e të cilave edhe KEDNJ dhe KNDCP.⁴⁷ Sipas Kornizës Kushtetuese, instrumentet themelore për të drejtat e njeriut, janë drejtëpërdrejtë të aplikueshme në Kosovë.⁴⁸ Andaj, aplikueshmëria direkte e ligjeve për të drejtat e njeriut në Kosovë do të thotë se ligjet vendore që lejojnë vizitat e mbikqyrura nga gjykatat në mes të mbrojtësit ligjor dhe të paraburgosurit nuk janë më në fuqi, pasi që shkelin ligjin mbi të drejtat e njeriut.

II. SJELLJA E AVOKATIT MBROJTËS

Përveq obligimeve ligjore dhe praktikës që t'i lejohet personave të akuzuar me vepra penale të kenë qasje në përfaqësimin efektiv ligjor, nga autoritetet gjithashtu kërkohet të sigurojnë që mbrojtësit të ushtrorjnë funksionet e tyre profesionale pa frikësime apo ndërhyrje tjera. Autoritetet, përfshirë edhe gjykatat, kanë një obligim shtesë që të njohin dhe respektojnë rolin kritik të mbrojtjes në sigurimin që të pandehurit të kenë gjykim të drejtë. Parimi i barazisë së armëve (mjeteve juridike) i theksuar në koncept të gjykimit të drejtë, imponon që mbrojtjes duhet t'i lejohet pozita e njëjtë dhe resurset e njëjta përgjatë tërë procedurës penale.

Mbrojtësit, në anën tjetër, janë të obliguar të respektojnë interesat, dhe të mbrojnë të drejtat e klientëve të tyre. Ata duhet aktivisht të ndihmojnë klientët e tyre duke u dhënë këshilla mbi të drejtat ligjore dhe duke ndërmarrë hapa të domosdoshëm për të mbrojtur interesat e tyre gjatë rrjedhës së procedurës. Ata më tej janë nën obligimin e promovimit të qëllimit (kauzës) së drejtësisë dhe mbështetjes për të drejtave të njeriut dhe lirive fundamentale të pranuar nga ligji vendor dhe ai ndërkombëtar.⁴⁹

Ligji vendor mbi procedurën penale, LPP RFJ, i siguron mbrojtësit që në kuadër të kornizës ligjore të marrin pjesë aktivisht përgjatë procedurës. Andaj, mbrojtësit mund të ankohen kundër vendimit mbi zhvillimin e hetimeve paraprake dhe vendimit për paraburgim apo zgjatje të paraburgimit për klientët e tyre.⁵⁰ Gjatë hetimeve mbrojtësi

⁴⁷ Rregullorja e UNMIK-ut 1999/24, Seksioni 1, alinea 3.

⁴⁸ Rregullorja e UNMIK-ut 2001/9 mbi Kornizën Kushtetuese për Vetë-Administrimin e Përkohshëm, e adoptuar më 15 Maj 2001, Kaptina 3, Seksioni 3.3.

⁴⁹ Shiko Parimet Themelore mbi Rolin e Mbrojtësve, Nenet 13-15.

⁵⁰ Nenet 159 (5), 192 (4) dhe 1297 (2) LPP RFJ.

mund të parashtroj kërkesa për veprime hetimore, dhe gjatë marrjes në pyetje apo veprimeve tjera hetimore, mbrojtësi mund të propozoj që gjykatësi hetues t'i bëj pyetje sqaruese personit që merret në pyetje dhe ata kanë të drejtë që vërejtjet e tyre të shënohen në procesverbal.⁵¹ Mbrojtësi mund të parashtroj kundërshtime para kryetarit të gjykatës relevante, përkritazi me prolongimin e procedurës, dhe parregullësitë tjera gjatë rrjedhës së hetimeve. Kur të ngritet aktakuza, mbrojtësi mund të kontestoj aktakuzën.⁵² Gjatë seancës kryesore mbrojtësi mund t'i bëjë pyetje të pandehurit dhe dëshmitarëve dhe mund të kërkoj që të hetohen fakte të reja dhe të njëjtat të ekzaminohen.⁵³

Në raportet e mëparme ishte theksuar se ekziston një model i mos-efektivitetit, ku mbrojtësit shpesh dështojnë për të:

- i. kërkuar analizat mjeko-ligjore
- ii. hetuar në mënyrë adekuate, para gjykimit, ndjekjen dhe rastin e mbrojtjes;
- iii. marrë në mënyrë adekuate në pyetje dëshmitarët;
- iv. prezentuar ndonjë provë mbështetëse në gjykim, dhe,
- v. kontestuar provat e papranueshme.

Sipas informatave të fituara nga kryetarët e pesë gjykatave të qarkut, përkritazi me periudhën në mes të 1 janarit dhe 31 qershorit 2001, në emër të mbrojtjes ishin regjistruar kundërshtimet në vijim:*

Gjykata	Neni 159 (5)	Neni 167	Neni 181	Neni 267	Rastet e përgjithsh. në proces
Gjilan/Gnjilane	82 ankesa	Shumë parashtresa	2 kundërsht.		111/173
Mitrovicë/Mitrovica	7 ankesa	Asnjë parashtresë	Asnjë kundërshtim	1 ndryshim	174/125
Pejë/Pec	10 ankesa	1 parashtresë	1 kundërshtim	1 ndryshim	127/216
Prishtinë/Prishtina	27 ankesa	Disa raste, pa shënime	Asnjë kundërshtim		399/365
Prizren	120 ankesa	Pa shënime	Asnjë kundërshtim	12 ndryshime	417/166

*

- Informatat janë mbledhur pjesërisht nga informatat statistikore semestrale të përmbledhura nga secila gjykatë për DAD, pjesërisht drejtëpërdrejtë nga Gjykatat e ndryshme të Qarkut.

⁵¹ Neni 167 dhe 168 (8) LPP RFJ.

⁵² Neni 267 (2) LPP RFJ.

⁵³ Neni 322 (4) LPP RFJ.

- Nenet i referohen LPP RFJ; 159 (5), ankesat kundër vendimit për fillimin e hetimeve, 167, kërkesa për veprime hetimore, 181, kundërshtimi mbi zvarritjen apo parregullësitë procedurale, 267 ndryshimi i aktakuzës.
- Rastet e përgjithshme në proces i referohen; rasteve në hetime/rasteve për të cilat është ngritur aktakuza, përfshirë rastet e të miturve.

Informatat e mësipërme nuk janë përfundimtare, (p.sh. ankesat kundër vendimeve për paraburgim nuk janë të përfshira), por tregojnë se praktika si duket ndryshon theksueshëm nga qarku në qark, dhe se, përveq ankesave kundër vendimeve për fillimin e hetimeve paraprake-(penale), vetëm një numër i vogël i kërkesave/kundërshtimeve janë parashtruar apo regjistruar. Monitorimi i SMSL gjithashtu ka vërejtur se mbrojtësit ligjor shpesh dështojnë të ndër marrin hapa për të kundërshtuar parburgimet, për klientët e tyre që në disa raste janë të zgjatura.

Më 12 shkurt 2001, një burrë shqipëtar i Kosovës ishte arrestuar në Mitrovicë nën dyshimin e tentim-shitjes së marihuanës KFOR-it Francez. I dyshuari e pranoi fajësinë. Në dëgjimin policor, pas dy ditësh, ishte emëruar mbrojtësi e i dyshuari ishte paraburgosur për një muaj. Shkaku i dhënë për paraburgimin e tij ishte se ekzistonte rreziku i ikjes, pasi që ai nuk posedonte letërnjoftim të vlefshëm. Më 14 mars 2001 paraburgimi i ishte zgjatur edhe për një muaj. Më 30 mars 2001, mbrojtësi e vizitoi klientin e tij për herë të parë. Vizita zgjati “disa minuta” dhe i paraburgosuri u informua se duhej të priste për një provë forenzike nga Bullgaria (me qëllim të përcaktimit se a ishte substanca vërtetë marihuanë si dhe peshën e saktë të substancës së gjetur). I paraburgosuri kërkoi nga mbrojtësi i tij që të ankohet kundër vendimit për paraburgim. Kjo nuk është bërë pasi që vendimi për paraburgim mund të kundërshtohet brenda 24 orësh pas pranimit (nga i dyshuari), e mbrojtësi nuk e vizitoi të paraburgosurin deri 16 ditë pas paraburgimit të tij. I dyshuari ishte liruar për tu mbrojtur në liri më 9 prill 2001, d.m.th. gati dy muaj pas arrestimit të tij - pas premtimit se do të paraqitet për gjykim.

Ndonëse janë vërejtur disa zhvillime pozitive në profesionalizimin e mbrojtësve, posaçërisht në rastet e profilit të lartë, ku disa mbrojtës kanë mbajtur një qëndrim më aktiv dhe agresiv në mbrojtjen e klientëve të tyre, akoma mbetet problemi kryesor përkitazi me efektivitetin e mbrojtësve.

Shumë të paraburgosur raportojnë se ata shumë rrallë vizitohen nga mbrojtësi dhe, siq përmendet më lart, shpeshherë ndodh që mbrojtësi i caktuar nga gjykata të paraqitet vetëm gjatë procedurës gjyqësore, në marrjen në pyetje në hetuesi apo në seancën kryesore. Siq është diskutuar në raportet e mëparme, kjo mund pjesërisht të bëhet për shkak të të ardhurave të ulta (maksimumi 500 DM në muaj) të parashikuara për mbrojtësit e caktuar nga gjykata, e gjithashtu edhe për shkak të pengesave që mbrojtësit ligjor vazhdojnë t’i kenë për t’ju qasur klientëve të tyre.⁵⁴ Kjo çështje paraqet problem të veçantë në rastet kur mbrojtësit duhet të udhëtojnë një distancë të caktuar, nga Serbia apo përbrenda Kosovës. Duke patur parasysh se nuk ka pagesë plotësuere për t’i mbuluar shpenzimet, kjo mund të rezultoj në humbje për mbrojtësin. Ekziston nevoja e ndryshimit të rregullave përkitazi me pagesën për mbrojtësit e caktuar nga gjykata për mbulimin e shpenzimeve, por niveli i ulët i pagesës nuk mund të çfajësoj mbrojtësin nga mos-marrja

⁵⁴ Qarkorja Gjyqësore 2000/1 mbi Udhëzimet Mbi Pagesën e Mbrojtësve të Caktuar nga Gjykata.

e veprimeve në emër të klientëve të tyre. Problem plotësues është raportimi i vazhdueshëm se mbrojtësit e caktuar nga gjykata, kërkojnë pagesë plotësuese me qëllim që të sigurojnë lirin e të pandehurit.

Në një rast dhunimi në Prishtinë, i pandehuri, shqiptar i Kosovës ishte përfaqësuar nga mbrojtësi i caktuar nga gjykata. I pandehuri ishte shpallur fajtor për dhunim dhe ishte dënuar me dy vite e gjysmë burgim. Aktgjykimi ishte atakuar me ankesë nga i pandehuri, i cili gjithashtu emëroi një mbrojtës të ri që ta përfaqësonte me ankesë. Sipas një parashtrese me shkrim pranë Gjykatës Supreme, i pari mbrojtës i caktuar nga gjykata kërkoi së pari 1000 DM, e pastaj 3000 DM nga i pandehuri për të siguruar lirin e tij. Pasi që i pandehuri është dënuar, mbrojtësi kërkoi 6000 DM me qëllim që ankesa të jetë e suksesshme.

Në Pejë, në një rast përkitazi me plaçkitje dhe akuza tjera të ndryshme kundër një burri shqiptar të Kosovës, kishte raportime se mbrojtësi i emëruar nga familja e të pandehurit, ka kërkuar nga i pandehuri 4000 DM për lirin e të pandehurit. Në rast të shpalljes së tij fajtor parat do të kthehen. I pandehuri është shpallur fajtor dhe dënuar me burgim me kohëzgjatje katër vite e gjashtë muaj.

III. PARABURGIMET JASHTË GJYQËSORE DHE QASJA NË MBROJTËS

Nëse i kthehemi shkurtimisht diskutimit të mëparshëm mbi projekt rregulloren mbi qasjen në mbrojtës për personat e arrestuar nga policia, është me rëndësi të veçantë qështja se projekt rregullorja aplikohet vetëm për personat që mbahen në burgun policor. KFOR-i vazhdon të burgos personat e dyshuar për vepra penale të rëndomta dhe personat të cilët konsiderohen se paraqesin rrezik për sigurinë në Kosovë apo për operacionet e KFOR-it. Standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut aplikohen për të gjithë personat e privuar nga liria.⁵⁵ Edhe pse UNMIK-u që sipas Rezolutës së Këshillit të Sigurimit 1244 (RKS 1244) ka themeluar misionin në Kosovë, mund të mos ketë ndikim mbi KFOR-in, Rregullorja 2000/47, përcakton se personeli i KFOR-it do të respektoj ligjin e aplikueshëm dhe rregulloret në Kosovë, përderisa ato nuk janë në kundërshtim me mandatin e tyre sipas RKS 1244.⁵⁶ Andaj përfshirja e paraburgimeve të KFOR-it, nën juridikcionin e projekt rregullores, mund të shërbej si një përkujtues i obligimeve ekzistuese sipas ligjit vendor dhe ligjit ndërkombëtar, për KFOR-in që të observoj të drejtat e personave të mbajtur në paraburgim. OSBE ka propozuar që projekt rregullorja duhet ndryshuar ashtu që të përfshij personat e mbajtur nga KFOR-i siq është përdorur në rregulloret e UNMIK-ut, p.sh atë nr.1999/2, ku “autoritetet relevante të rendit publik” përfshinin dhe KFOR-in.

⁵⁵ Shiko Projekt Rregulloren, Seksioni 1 (a) dhe (b). Në forcat ushtarake Amerikane të cilat paraqiten obligime në Deklaratën Amerikane si dhe instrumente tjera relevante të drejtave të njeriut apo ligjeve humanitare. Shiko *Coard dhe të tjerët .v të SHBA*, rasti 10.951, Raporti No-109/99, 29 Shtator 1999, Gjykata ndër- Amerikane mbi të drejtat e njeriut. Mbi përgjegjësinë ligjore të KFOR-it shiko në Administrimin Ndërkombëtar Teritorial të ish Jugosllavisë, Zhvillimet origjinale dhe ndryshimet e arritura; Carsten Stahn (Këtu e më tutje Stahn)

⁵⁶ Rregullorja e UNMIK-ut 2000/47, seksioni 2.2.

Për detale tjera mbi paraburgimet jashtë gjyqësore, përfshirë edhe informatat mbi “informimin për të drejtën në mbrojtës dhe qasjes në mbrojtje të personave në paraburgim jashtë gjyqësor, ju lutem, shikoni në SEKSIONI n mbi paraburgimet.

IV. REKOMANDIMET

Fatkeqësisht, shumica e rekomandimeve të bëra në të kaluarën nga SMSL, nuk janë implementuar. Prandaj rekomandimet e tanishme janë pjesërisht përsëritje e rekomandimeve të kaluara, të bëra nga SMSL, që nga raportet e vitit 2000 (p.sh. raporti Nr. 8: Qasja në mbrojtje efektive).

- Të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij/saj, duhet **t’i garantohet komunikimi konfidencial**, qoftë në të shkruar apo gojarisht, në të gjitha fazat e procedurës penale. Secila qendër e paraburgimit apo e mbajtjes, duhet **të siguroj një vend të përshtatshëm**, ku i paraburgosuri dhe mbrojtësi i tij mund të komunikojnë në mënyrë konfidente, d.m.th. komunikimi mund të zhvillohet në vend ku ata mund të shikohen por jo edhe të dëgjohen nga të tjerët. Autoritetet duhet të sigurojnë që i akuzuari dhe mbrojtësi i tij/saj **të jenë në gjendje të komunikojnë lirisht**, pa kufizime kohore apo kufizime tjera, gjatë gjithë fazave të procedurës penale. Neni 74 (2) LPP RFJ nuk duhet të aplikohet.
- Praktika e kërkesës që mbrojtësi të kërkoj autorizimin nga gjykata, për të vizituar klientët e tyre në paraburgim, duhet të braktiset nga të dy anët, si nga gjykata ashtu dhe nga autoritetet e paraburgimit.⁵⁷
- Autoritetet relevante duhet të sigurojnë informata të mjaftueshëm për mbrojtësin lidhur me çfarëdo dëgjimi relevant apo veprime hetimore, duke përfshirë marrjen e dëshmisë së dëshmitarit. Dështimi i mbrojtësit nuk duhet të ndikoj në të paraburgosurin dhe në rastet kur mbrojtësi dështon të marrë pjesë në dëgjim, pa marrë parasysh se a ka arsye të fortë apo jo, pjesa relevante e hetimeve duhet që të ri-hapet nëse interesat e drejtësisë e kërkojnë një gjë të tillë. Në rastet kur, p.sh. mbrojtësi, pa arsye të fortë, dështon disa herë të merr pjesë, atëherë i pandehuri mund që ta ndërroj mbrojtësin apo gjykata mund t’i caktoj mbrojtës të ri.
- Autoritetet relevante duhet të sigurojnë që **mbrojtësi të ketë qasje të lirë në të gjitha dokumentet relevante të gjykatës** dhe provave, duke përfshirë edhe dosjet policore, **në të gjitha fazat** e procedurës penale. Lehtësirat adekuate duhet të jenë në dispozicion që mbrojtësi të ketë mundësi të bëj fotokopjimin e çfarëdo shkrese apo prove.
- Të gjithë personelit relevant, përfshirë këtu gjykatësit, prokurorët, dhe mbrojtësit duhet **t’ju sigurohet një trajnim intenziv dhe praktik** mbi rolet e tyre dhe përgjegjësitë për tu siguruar, se të drejtat e të akuzuarit në mbrojtje efektive mbështeten plotësisht gjatë hetimeve poashtu edhe gjatë fazës së gjykimit..
- Pagesa e mbrojtësit të caktuar nga ana e gjykatës duhet që të mbuloj shpenzimet për udhëtim si dhe shpenzimet e tjera të domosdoshme siq janë kopjet, vërtetimet e

⁵⁷ SMSL është informuar se Menagjimi I Burgjeve është duke zhvilluar sistemin për të zëvendësuar domosdoshmërinë pëe autorizimin gjyqësor me autorizimin e thjeshtë të avokatit.

ekspertëve apo shpenzimet e tjera të domosdoshme për pregaditjen e mbrojtjes efektive.

SEKSIONI 4: PARABURGIMI

I. HYRJE

Shqetësimet në lidhje me rastet e shumta të paraburgimeve arbitrare në Kosovë, janë shtruar në raportet e mëparshme të SMSL-së. Përkundër hapave që janë ndërmarrë deri më tani për t'i adresuar disa nga këto probleme, paraburgimi pa një bazë të qartë ligjore ose pa një rishqyrtim gjyqësor mbetet i pranishëm në Kosovë. Tre persona aktualisht janë të paraburgosur në bazë të autoritetit ekzekutiv të PSSP, pa një shqyrtim gjyqësor⁵⁸, dhe mbi njëqind persona janë në paraburgim jashtëgjyqësor nën autoritetin e COMKFOR-it. Për më tepër, në Kosovë ende mungon mekanizmi *habeas corpus*, edhe pse e drejta ndërkombëtare e të drejtave të njeriut është inkorporuar drejtëpërsëdrejti në ligjet në Kosovë – së fundi përmes Kornizës Kushtetuese.⁵⁹ Megjithatë, SMSL pret shpalljen e hyrjes në fuqi të Kodit të Procedurës Penale, që pritet të përmbajë dispozita në lidhje me procedurat *habeas corpus*.

Një fushë në të cilën janë ndërmarrë disa hapa pozitiv për t'i dhënë fund paraburgimit joligjor ka të bëjë me të sëmurit mental. Posaçërisht është i mirëseardhur bashkëpunimi i ngushtë ndërmjet administratës civile të OKB, OSBE-së dhe faktorëve tjerë relevant në këtë fushë. Përmirësime janë vërejtur poashtu edhe në adresimin e çështjes së ligjshmërisë së paraburgimit policor. Fatkeqësisht, një qasje e koordinuar deri më tani nuk është bërë në çështjet tjera në lidhje me paraburgimin.

II. PARABURGIMI NË BAZË TË URDHËRIT EKZEKUTIV TË PSSP

Pasqyrë faktike

Në raportin e fundit mbi sistemin e gjyqësisë penale në Kosovë, SMSL konkludoi se praktika e lëshimit të urdhërësës ekzekutive për t'i paraburgosur personat (zakonisht e përcjellur me urdhërin gjyqësor për t'i lirim të tyre) është shkelje e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ) dhe e Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike (KNDCP).⁶⁰ Dhe kjo për dy shkaqe kryesore: E para, urdhërat ekzekutiv si të tilla nuk kanë bazë të qartë ligjore as në ligjin vendor e as në ate ndërkombëtar. Nuk ka ligje të cilat e përcaktojnë dhe e kufizojnë pushtetin e PSSP për të urdhëruar paraburgime të tilla, kështu që bazueshmëria e paraburgimit nuk është e qartë dhe nuk mund të kundërshtohet. E dyta, për këtë paraburgim nuk ka rishqyrtim të mundshëm gjyqësor. Si plotësim, ndërhyrja publike e ekzekutivit në vendimet gjyqësore (p.sh. kur paraburgosen personat për të cilët gjykata ka urdhëruar lirim të tyre), krijon një varg vështirësish në promovimin e respektimit të sundimit të ligjit. Një varg

⁵⁸ Më 21 Shtator 2001, Komisioni për Shqyrtimin e Paraburgimit miratoi paraburgimin për tre të dyshuarit. Shih më poshtë.

⁵⁹ Është shpallur si Regullorë e UNMIK-ut 2001/9 më 15 Maj 2001 nga ana e PSSP

⁶⁰ Neni 5 i KEDNJ dhe neni 9 i KNDCP në esencë thekson se një person mund të privohet nga liria e tij ose e saj vetëm me qëllim dhe në përputhje me procedurën e përcaktuar me ligj.

organizatash tjera, përfshirë këtu edhe Institucionin e Ombudspersonit në Kosovë, kanë arritur në përfundime të njëjta.⁶¹

Sidoqoftë, përdorimi i urdhëresave ekzekutive për caktimin e paraburgimit ka vazhduar.

Arsyetimi i urdhërit ekzekutiv për paraburgim

SMSL nuk është në dijeni për ndonjë dokument zyrtar që përcakton qartë arsyet për përdorim të pushtetit ekzekutiv për paraburgim dhe për kufizimet e tij. Bazuar në deklaratat publike të UNMIK-ut dhe në letrën e dërguar nga PSSP, Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së, në janar të vitit 2001, SMSL kupton se PSSP ushtron autoritetin e vet ekzekutiv në rastet kur beson se në të kundërtën një dëm i veçantë ose një padrejtësi mund të pasoj.⁶²

Sa i përket urdhëresës ekzekutive të fundit për personat e dyshimtë se janë të kyqur në rastin e vënies së bombës në autobusin Nish Express, është vështirë të thuhet se si është plotësuar kushti i tretë i testit. Në këtë rast, trupi gjykues i përbërë prej tre gjyqtarëve ndërkombëtar ka arritur në përfundim se provat ekzistuese nuk janë të forta sa duhet për të arsyetuar paraburgimin, prandaj edhe si rezultat i kësaj ka urdhëruar lirim të dyshuarve.

Rregullorja 2001/18, e cila është e përshkruar më poshtë, nuk krijon bazë ligjore për shfrytëzimin e urdhëresës ekzekutive për paraburgim. Megjithatë, e vetmja arsye në bazë të cilës Komisioni për rishqyrtim mund të miratojë paraburgimin jashtëgjyqësor, është përshkruar në nenin 6.1, që thotë:

- 6.1 Komisioni mund të përcaktoj se paraburgimi jashtëgjyqësor i bazuar në urdhëresë ekzekutive është i justifikueshëm, kur Komisioni konsideron se ekziston bazë e arsyeshme për të dyshuar që personi ka kryer veprën penale, dhe
 - a. Kur identiteti nuk mund të përcaktohet ose kur ekzistojnë rrethana të tjera që sugjerojnë mundësinë e madhe të ikjes; ose
 - b. Kur ekziston bazë e arsyeshme për të dyshuar që ai do të asgjësojë gjurmët e veprës penale ose rrethana të posaqme sugjerojnë që ai do të pengojë hetimet duke ndikuar në dëshmitar, bashkëekzekutorë ose persona të cilët kanë fshehur veprën penale ose gjurmët e saj; ose
 - c. Kur rrethana të posaqme justifikojnë frikën se vepra penale mund të përsëritet ose vepra penale në tentativë mund të kryhet ose kërcnimi për vepër penale mund të realizohet.

Prandaj, del se, çfarëdo që të jenë arsyet fillestare për përdorimin e urdhëresës ekzekutive, paraburgimi mund të vazhdohet vetëm nëse personi plotëson bazën e zakonshme për paraburgim në lëndët penale. Megjithatë, paraburgimi ekzekutiv zakonisht përdoret kur gjykata e rregullt (zakonisht me gjyqtarë ndërkombëtar) tanimë ka

⁶¹ Shih Raportin Special nr.3 të Ombudspersonit të datës 29 Qershor 2001.

⁶² "Siguria dhe Sundimi i së Drejtës në Kosovë" 12 Janar 2001, faqe 4

përcaktuar se kushtet për paraburgim nuk janë plotësuar dhe ka urdhëruar lirim të të dyshuarit.

Rishqyrtimi i gjigjor i paraburgimit

E drejta për të patur mundësinë e kundërshtimit të çfarëdo paraburgimi para trupit gjykues me pushtet për të urdhëruar lirim (*habeas corpus*), është e drejtë thelbësore dhe parim i pa deroguar i së drejtës ndërkombëtare, e zbatueshme madje edhe në kohë të emergjencës. Praktika gjyqësore e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, sugjeron se e drejta për të sfiduar paraburgimin është e drejtë ndaj së cilës nuk lejohet kurrfarë përjashtimi.⁶³ Raportuesi Special për Gjendjet e Emergjencës i Nën-Komisionit të OKB-së për Preventimin e Diskriminimit dhe Mbrojtjen e Minoriteteve ka thënë se mjete juridik *habeas corpus* është “nuk mund të derogohet asnjëherë dhe nën çfarëdo rrethana”.⁶⁴ Gjykata Ndër-Amerikane për të Drejtat e Njeriut, poashtu ka konfirmuar se e drejta për të sfiduar paraburgimin para autoritetit gjyqësor, është e domosdoshme për mbrojtjen e të drejtave tjera fundamentale, prandaj në vehte, është e drejtë që duhet respektuar në çdo kohë dhe në të gjitha rrethanat.⁶⁵ Mungesa e rishqyrtimit gjyqësor të paraburgimit ekzekutiv është njëra prej shqetësimeve kyqe.

Ky problem është vënë në dijeni të PSSP, i cili tentoi ta rregulloj këtë me shpalljen e Rregullores së UNMIK-ut 2001/18, në gusht 2001, duke formuar Komisionin për rishqyrtimin e paraburgimit (KRP), të ngarkuar me detyrën e rishqyrtimit të urdhëresave ekzekutive. Rregullorja, sidoqoftë, nuk siguron një rishqyrtim gjyqësor që kërkohet me të drejtën ndërkombëtare.⁶⁶ Rregullorja siguron mekanizmin për rishqyrtimin e këtyre paraburgimeve, dhe për herë të parë përcakton bazat e qarta për vazhdimin e këtij lloji të paraburgimit. Megjithatë, ajo nuk siguron “rishqyrtimin e pavarur gjyqësor” të paraburgimeve, për të cilin qëllim edhe është shpallur, duke iu referuar komunikatës për shtyp të UNMIK-ut të datës 4 shtator 2001.⁶⁷ KRP është një trup i formuar jashtë organeve gjyqësore, dhe përbëhet nga tre anëtar të emëruar drejtëpërsëdrejti nga PSSP për një periudhë kohore të kufizuar (me sa duket për tre muaj, edhe pse kjo nuk është e qarta në rregullore), dhe të cilët vijnë në Kosovë që në mënyrë specifike të merren me një numër të kufizuar lëndësh. Anëtarët e KRP, si të tillë janë të mvarur nga PSSP, i cili është palë në të gjitha kontestet të cilat ata i shqyrtojnë.⁶⁸ Gjykata Evropiane për të Drejtat e

⁶³ Aksoy kundër Turqisë, 18.12.1996, Brannigan dhe McBride kundër Mbretërisë së Bashkuar, 26.05.1993, Lawless kundër Irlandës, 01.07.1961

⁶⁴ Shih raportin e Raportuesit Special për Gjendjet e Emergjencës i Nën-Komisionit të OKB-së për Preventimin e Diskriminimit dhe Mbrojtjen e Minoriteteve, UN doc. E/CN.4.Sub.2/1996/19, para.13

⁶⁵ Gjykata Inter-Amerikane për të Drejtat e Njeriut, Opinione Këshilldhënëse OC-8/87 e 30 Janarit, 1987

⁶⁶ Rregullorja e UNMIK-ut 2001/18 ishte projektuar pa kyqjen e OMIK-ut apo ndonjë organizate tjetër.

⁶⁷ Komunikata për Shtyp e UNMIK-ut e 4 Shtatorit 2001, UNMIK/PR/637.

⁶⁸ Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut në mënyrë frekvente ka mbajtur qëndrimin se një mvarshmëri e tillë e dukshme në ekzekutivin e diskualifikon organin si të pavarur. Shiko për shembull Ringeisen kundër Austrisë, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Aktgjykimi i 16 Korrikut 1971, Langborger kundër Suedisë, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Aktgjykimi i 22 Qershorit 1989, veçanërisht neni 32, Belilos kundër Zvicrës, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Aktgjykimi i 29 Prillit 1988, dhe Findlay kundër Mbretërisë së Bashkuar, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Aktgjykimi i 25 Shkurtit 1997, neni 73, Shih poashtu rastin Skocez, njëra nga shumë rastet vendore që zbaton të drejtën

Njeriut shpesh ka thënë se një mvarshmëri e tillë e dukshme nga ekzekutivi e përjashton mundësinë e këtij trupi për të qenë i pavarur. Ombudspersoni nxori një raport special në lidhje me Rregulloren 2001/18 më 12 shtator 2001⁶⁹, duke theksuar se rregullorja nuk i sjell urdhëresat ekzekutive në pajtueshmëri me standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut.

Praktika e paraburgimit – qasja në mbrojtësit

Personat e paraburgosur në bazë të urdhërit ekzekutiv nuk marrin vendim përkitazi me paraburgimin e tyre. Në vend të saj marrin një njohtim me shkrim nga Departamenti Administrativ i Drejtësisë ku citohen pjesë të urdhëresës. Kjo letër e njohtimit nuk e informon të paraburgosurin me arsyet e paraburgimit, ose për çfarë krimi dyshohet ai ose ajo, e as nuk shpjegohet mundësia e sfidimit të ligjshmërisë së këtij paraburgimi.⁷⁰

Avokatët mbrojtës në shumicën e rajoneve kanë nevojë për autorizime gjyqësore për t'i vizituar klientët e tyre. Për këtë shkak është krijuar problem për personat e paraburgosur në qendrat e paraburgimit të UNMIK-ut në bazë të urdhëresës ekzekutive përfshirë këtu edhe rastin e të dyshuarve për vënien e bombës në Nish Express që ka ndodhur në shkurt 2001, ku njëmbëdhjetë persona janë vranë dhe shumë të tjerë janë plagosur rëndë.

Më 19 mars 2001, pesë persona janë arrestuar si të dyshuar për kryerjen e sulmit. Njëri është liruar pas një kohë të shkurtër, ndërsa katër të tjerët kanë marr vendim gjyqësor për paraburgim për një muaj. Në ankesën e bërë, kolegji i përbërë nga tre gjyqtarë ndërkombëtar anuloi vendimin për paraburgim ndaj tre të dyshuarve, dhe ata janë urdhëruar që të lirohen, ndërsa paraburgimi për të dyshuarin e katërt është zgjatur. Tre të dyshuarit megjithatë nuk janë liruar, pasi që PSSP lëshoi urdhëresën ekzekutive për të vazhduar paraburgimin për të gjithë të dyshuarit. Të dyshuarit pastaj janë transferuar prej qendrës së paraburgimit në Prishtinë në kampin Bondsteel; prej ku njëri nga të dyshuarit ende nën paraburgim gjyqësor më vonë ka ikur. Në korrik dy nga të dyshuarit e mbetur janë transferuar në Prishtinë respektivisht në Mitrovicë, dhe pas këtij transferi iu është mohuar e drejta e mbrojtjes. Avokati mbrojtës në fillim nuk mund të merrte autorizimin e nevojshëm gjyqësor për vizita. Me propozim të avokatit mbrojtës, gjyqtari hetues ndërkombëtar – i cili pas vendimit gjyqësor për të liruar nuk ka patur juridikcion me çështjen e paraburgimit – nënshkruan autorizimin për vizitë të avokatit mbrojtës dhe shqyrtoi vizitat e bashkëshortes së të paraburgosurit.

Pushtetit emergjente

Një arsyetim shtesë për përdorimin e pushtetit nga ana e PSSP, është bërë në deklaratën me shkrim të UNMIK-ut këtë vit, kur zëdhënësi i UNMIK-ut deklaroi se përdorimi i pushtetit ekzekutiv për paraburgim është i justifikueshëm pasi që të drejtat e njeriut mund të kufizohen në kohë emergjence.

precedentale të GJEDNJ në lidje më pavarësinë: Starrs dhe të tjerët kundër Procurator Fiscal, Gjykata e Lartë e Skocisë, 11 Nëntor 1999.

⁶⁹ Raporti Special nr. 4 i Institucionit të Ombudspersonit në Kosovë

⁷⁰ Neni 5 (2) & (4) KEDNJ dhe Neni 9 (2) & (4) PNDPCP theksojnë se çdonjëri që është arrestuar duhet të informohet për arsyet e arrestimit dhe për secilën akuzë që i vëhet në barrë dhe duhet të ketë të drejtën e procedurës së sfidimit të ligjshmërisë së paraburgimit.

Ligji ndërkombëtar i të drejtave të njeriut me të vërtetë përmban dipozita të veqanta me të cilën lejon kufizimin (derogimin prej) shumë standardeve të të drejtave të njeriut në kohë të emergjencës publike, por kufizimet e tilla dhe derogimet janë të rregulluara shprehimisht me ligj. Sipas KNDCP dhe KEDNJ, duhet të plotësohen kushtet e mëposhtme: së pari, që emergjenca të jetë e shpallur në mënyrë publike, dhe se në çfarë mase duhet bërë derogimin prej standardeve të të drejtave fundamentale, si dhe arsyetimin për këtë; së dyti, masat e marra duhen që në mënyrë strikte të jenë të domosdoshme për nevojat e gjendjes. Kufizimet e standardeve të të drejtave të njeriut nuk mund të shkojnë më larg se që është absolutisht e domosdoshme.⁷¹

Praktika e urdhëresave ekzekutive nuk i plotëson këto kritere strikte. Gjersa RKS 1244, mund të jetë deklaratë e gjendjes së emergjencës, ajo nuk deklarohet të jetë e tillë, e as që i jep ndonjë pushtet shprehimor Sekretarit të Përgjithshëm (dhe përmes tij, UNMIK-ut) për të deroguar prej standardeve të caktuara të të drejtave të njeriut. Instrumentet ligjore që i obligojnë zyrtarët e UNMIK-ut, përfshirë edhe PSSP, që pajtohen me standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut (si Rregullorja 1999/24), nuk bëjnë asnjë referencë në lidhje me ndonjë kufizim/derogim në këto të drejta. Prandaj deklarata bazike publike të masave që ndërmerren për të kufizuar të drejtat e njeriut dhe arsyetimi i dhënë me kohë emergjence, nuk janë me vend.

Në raportin tremujor të Këshillit të Sigurimit mbi situatën në Kosovë, të 13 majit 2001, Sekretari i Përgjithshëm deklaroi se “është arritur një progres i konsiderueshëm në implementimin e mandatit të UNMIK-ut. Faza e emergjencës në shkallë të madhe ka mbaruar⁷², gjë që sugjeron se çfarëdo pushteti emergjent që është i nevojshëm tani, duhet të jetë i kufizuar. Me funksionimin e sistemit gjyqësor, nevoja e pushtetit emergjent për paraburgim është reduktuar edhe më shumë. Në fakt, Rregullorja 2001/18, e ka bërë të qartë se qëllimi i urdhëresës ekzekutive për paraburgim, është të paraburgos personat e dyshuar për kryerjen e krimeve dhe për të cilët ekziston frika se do të ikin ose do të ndërhyjnë në gjyqësi; me fjalë të tjera, paraburgim i rregullt. Nuk ka asnjë arsye të qartë pse këto çështje duhet të trajtohen jashtë sistemit gjyqësor. Nëse shqetësimi kryesor ka të bëjë me një provë të ndjeshme, atëherë sistemi ekzistues gjyqësor duhet të adaptohet të merret me këto çështje.

Në anën tjetër, rishqyrtimi gjyqësor i paraburgimit është e drejtë e cila kurrë nuk mund anulohet, madje edhe në gjendje të emergjencës. Edhe në kohë të trazirave serioze të armatosura, sikurse në Irlandën e Veriut apo në jug-lindje të Turqisë, Gjykata Europiane për të Drejtat e Njeriut ka lejuar që pushteti emergjent të kufizoj të drejtën për rishqyrtim të paraburgimit vetëm për disa ditë e jo ta anuloj atë plotësisht.⁷³

⁷¹ Për komente të mëtejme mbi gjendjet e emergjencës, shiko Komentet e Përgjithshme Nr. 29 nga Komiteti i të Drejtave të Njeriut të KB mbi *Gjendjet e Emergjencës* (Neni 4), KDCP/C/21/Rev. 1/Sht. 11, 31 Gusht 2001.

⁷² Raporti i Sekretarit të Përgjithshëm mbi Misionin e Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë, 13 Mars 2001, S/2001/218, para.62.

⁷³ Në rastin *Brannigan*, op. Cit. GJEDNJ theksoi se periudha e paraburgimit prej shtatë ditësh’ para se i paraburgosuri të nxirret para gjyqtarit hyn në kuadër të pushtetit legjitim të qeverisë gjatë kohës së emergjencës, duke marrë parasysh se në Irlandën e Veriut të gjithë të paraburgosurit kanë patur në

Duke dhënë disa shembuj për këtë çështje, hapi më i lehtë do të ishte të ndërpriten paraburgimet ekzekutive menjëherë dhe të lejohen gjykatat të merren me këto çështje.

III. PARABURGIMI NGA KFOR-i

Pasqyrë faktike

Shqetësim i ngjashëm është edhe vazhdimi i përdorimit të paraburgimeve jashtëgjyqësore nga ana e KFOR-it, e posaçërisht që nga mesi i vitit 2000, praktika e paraburgosjes së personave në bazën e KFOR-it Amerikan, në Kampin Bondsteel. Personat e mbajtur në Kampin Bondsteel, në të shumtën e rasteve janë të paraburgosur duke mos u bazuar në asnjë ligj ose vendim gjyqësor, e as që paraburgimi i tyre i nënshtrohet rishqyrtimit nga ndonjë trup gjyqësor.⁷⁴ Numri i të paraburgosurve në Kampin Bondsteel është sjellur rreth njëqind, e në disa raste ka arritur gati dyqind.

Sikurse edhe me urdhëresat ekzekutive të PSSP, dy shqetësimet kyqe janë mungesa e bazës së qartë ligjore të paraburgimit konform ligjeve ndërkombëtare, dhe mungesa e rishqyrtimit gjyqësor të paraburgimit. Gjatë kësaj periudhe, shumë sqarime kanë ardhur nga KFOR-i në lidhje me këtë praktikë të tyre, por paraburgimet jashtëgjyqësore kanë vazhduar.

Bazat për paraburgim

COMKFOR-i në letrën të cilën i'a dërgoi më 6 shtator 2001 Shefit të Misionit të OSBE-së përcaktoi bazat e KFOR-it për shfrytëzimin e pushtetit të burgosjes. Ai vuri në pah se politika e paraburgimit zbatohet nga KFOR-i, si tërësi e jo vetëm nga KFOR-i Amerikan dhe se është e autorizuar nga ai, me përkrahjen e SHSFAE (Shtabit Suprem të Forcave Aleate për Europë). Ai tha se KFOR-i i paraburgos këta persona pa dëshirë dhe do të kishte dëshirë që sa më parë të përfundoj këtë detyrë. Megjithatë, ata shohin domosdoshmërinë e paraburgosjes së personave në këtë mënyrë, për shkak të vështirësive në themelimin e sistemit gjyqësor dhe policor, e poashtu edhe për shkak të çrregullimeve në Luginën e Preshevës (Serbia Jugore) dhe në iRJM.

COMKFOR-i deklaroi në letrën e tij, se kriteri i shfrytëzuar nga ai për të autorizuar paraburgimet e zgjatura nga KFOR-i është se “personi në fjalë paraqet kërcnim për një ambient të qetë dhe të sigurt”. Ai përsëriti se KFOR-i beson që ka një fuqi të tillë ligjore në bazë të autorizimeve që i jepen me RKS 1244 të ruan një ambient të qetë dhe të sigurt në Kosovë e poashtu edhe Marrëveshja tekniko-ushtarake e vitit 1999 ka qenë “relevante në këtë kontekst”.

përgjithësi të drejtën *habeas* prej momentit të paraburgimit. Në rastin *Aksoy*, op. Cit. GJEDNJ konsideroi se periudha 14 ditëshe' e paraburgimit para se të nxirret para gjyqtarit hetues është shumë e gjatë, posaçërisht pasi që nuk ka ekzistuar mjete *habeas* madje edhe në një rajon të kapluar nga konflikti i armatosur.

⁷⁴ Pasi që të gjithë të paraburgosurit mbahen në Kampin Bondsteel të KFOR-it Amerikan, edhe kontingjentet tjera të KFOR-it I bartin të paraburgosurit në këtë kamp dhe i dorëzojnë ata KFOR-it Amerikan.

Bazuar në këtë letër, dhe në informatat tjera të mbledhura nga monitorët e SMSL prej KFOR-it, SMSL mendon që të paraburgosurit në Bondsteel hyjnë në katër kategori. Së pari, janë ata persona për të cilët KFOR-i beson se kanë kryer vepra penale në Kosovë ose jashtë Kosovës, por për të cilët KFOR-i mendon që sistemi gjyqësor i Kosovës nuk është në gjendje që t'i gjykoj drejtë dhe objektivist (p.sh. provat kundër tyre mund të jenë të ndieshme). Së dyti, janë ata persona që janë paraburgosur vetëm për arsye të qarta të parandalimit, pasi që mund të paraqesin kërcnim për paqen dhe sigurinë. Së treti, janë ata persona të cilët janë të dyshimtë se kanë kryer vepra penale dhe të cilët eventualisht i janë dorëzuar – ose menjëherë ose pas arrestimit ose më vonë, sistemit të gjyqësisë penale; dhe së katërti janë personat që mbahen në paraburgim gjyqësor dhe që për arsye sigurie ose për ndonjë arsye tjetër mbahen në Kampin Bondsteel.

Mekanizmat e rishqyrtimit dhe praktikat tjera të paraburgimit

Shumica e madhe e të paraburgosurve në Bondsteel mbahen jashtë sistemit gjyqësor.⁷⁵ Prandaj ata nuk kanë mundësi për çfarëdo rishqyrtimi gjyqësor të paraburgimit të tyre. Në letrën e tij, COMKFOR-i përshkruan procesin në bazë të të cilit paraburgimi është i autorizuar. Secili rast shqyrtohet nga personeli i KFOR-it, komandantët e brigadave shumëkombëshe dhe kolegji shqyrtues në Shtabin Qendror të KFOR-it, para se të bëhet autorizimi nga KFOR-i. Megjithatë, ky natyrisht nuk është një trup i pavarur gjyqësor që është në gjendje të shqyrtoj ligjshmërinë e paraburgosjes së personit dhe të urdhëroj lirin e tij/saj.

Në bazë të informatave të fituara nga monitorët e SMSL, shumica e të paraburgosurëve në Kampin Bondsteel nuk kanë marr asnjë informatë me shkrim për atë se kush i ka paraburgosur, me çfarë baze ligjore, për çfarë periudhe, dhe si ata mund të sfidojnë ligjshmërinë e paraburgimit. Në prill dhe maj 2001, të paraburgosurit morrën një përkthim të shkruar me dorë të një pjese të “urdhëresës për paraburgim”, por kjo praktikë më vonë është ndërprerë. Në letrën e COMKFOR-it të dërguar OSBE-së, thuhet se të paraburgosurit marrin një “certifikatë”ku shënohen arsyet e paraburgimit.⁷⁶ Megjithatë, asnjë i paraburgosur i intervistuar nga SMSL deri më 14 gusht 2001, nuk ka treguar se ka marrë një letër të tillë. Pas hetimeve të mëtejme në Kampin Bondsteel, OSBE morri një informatë se më 14 shtator, të paraburgosurit janë duke marrë një informatë në lidhje me paraburgimin e tyre.

Qasja në mbrojtje

Për personat e arrestuar nga KFOR-i dhe më vonë të dorëzuar sistemit gjyqësor, problemi i mundësisë për mbrojtje zakonisht zgjidhet me nxerrjen e personit para gjykatës për herë të parë. Kjo megjithatë bëhet pas një vonese thelbësore, që është shkelje e së drejtës që

⁷⁵ Në letrën e dërguar Shefit të Misionit të OSBE-së nga ana e PSSP datuar më 31 Gusht 2001, PSSP deklaroi se dy persona mbahen në Bondsteel me kërkesë të UNMIK-ut. Kjo tregon se këta janë personat e vetëm të mbajtur me vendim gjyqësor në Bondsteel.

⁷⁶ Ibid.

menjëherë të silltet para autoritetit gjyqësor dhe të informohet për akuzat që i vihen në barrë.⁷⁷

Në bazë të informatave që ka SMSL ekziston një memorandum intern i KFOR-it që thotë se personave të burgosur u *lejohet qasja në shpenzime të veta, në këshilltar apo përfaqësues ligjor*. Por nuk ekziston një rregull korensponduese me këtë që thotë se i paraburgosuri duhet të informohet për këtë të drejtë, dhe në bazë të informatave të mbledhura nga të paraburgosurit në Bondsteel, të paraburgosurit nuk janë informuar për të drejtën për mbrojtje. SMSL është në dijeni që shumica e këtyre personave nuk bëjnë kërkesë për mbrojtje, por kjo nuk e liron autoritetin paraburgosës prej obligimeve të tyre në bazë të së drejtës vendore dhe ndërkombëtare.

Në një rast të njohur për SMSL, një i paraburgosur ka kërkuar nga kryetari i Gjykatës së Qarkut në Gjilan t'i siguroj një avokat mbrojtës, por ka qenë i informuar që ai do të ketë avokat mbrojtës pasi që lënda e tij të dorëzohet në gjykatë.⁷⁸

Një nga arsyet që është konsideruar esenciale që personat e paraburgosur të kenë mundësi për mbrojtje, është që të sigurohet një mbrojtje nga abuzimet.

Ka patur pohime për abuzime në Kampin Bondsteel. Në gusht të vitit 2001, p.sh. SMSL është kontaktuar nga avokati mbrojtës i personit të paraburgosur në Kampin Bondsteel, i cili pohonte se klienti i tij ka qenë i abuzuar gjatë marrjes në pyetje. SMSJ ka intervistuar të paraburgosurin dhe është vërtetuar se këto pohime kanë qenë të besueshme. I paraburgosuri i cili kishte siguruar avokatin mbrojtës para arrestimit nga ana e KFOR-it, ka thënë se ai është marr në pyetje disa herë pa u informuar për të drejtën për tu mbrojtur në heshtje, të drejtën për avokat mbrojtës dhe pa i'u shpjeguar arsyet e paraburgimit.

Në rastet kur personat e mbajtur në Bondsteel kanë qenë në gjendje të sigurojnë avokat mbrojtës, në rastet kur ndodhen në paraburgim gjyqësor, ose në rastet kur lënda i është dorëzuar sistemit gjyqësor ose në ndonjë mënyrë tjetër, avokatëve mbrojtës në përgjithësi, i'u është lejuar qasja klientëve të tyre.

Paraburgimet e KFOR-it në raport me legjislacionin ndërkombëtar për të drejtat e njeriut

Sqarimet nga ana e COMKFOR-it, në lidhje me bazat e praktikës së paraburgimeve janë të mirëseardhura, pasi që mundëson analizimin se si këto praktika janë në pajtueshmëri me standardet ndërkombëtare. Sikurse për PSSP, pikë nisëse është se KFOR-i dhe komponentet e saja shtetërore janë të lidhura me ligjin ndërkombëtar të të drejtave të njeriut. Së pari, të drejtat e njeriut janë të inkorporuara në mandatin e të gjithë akterëve të vendosur në Kosovë nën kujdesin e OKB-së, si është shënuar në RKS 1244.⁷⁹ KFOR-i sikurse edhe forcat e autorizuara të KB, janë të obliguara të përfillin qëllimet e Kombeve të Bashkuara, njëra prej qëllimeve kryesore, së bashku me sigurinë, është promovimi i të

⁷⁷ Neni 5 (2) & (3) i KEDNJ dhe Neni 9 (2) & (3) i PNDCP

⁷⁸ Ligji i zbatueshëm, Neni 205 LPP, kërkon që kryetarët e gjykatave (ose gjyqtarët e caktuar) t'i vizitojnë të paraburgosurit nën kompetencën e tyre të paktën një herë në javë.

⁷⁹ RKS 1244, para 5.

drejtave të njeriut.⁸⁰ Si shtesë, përveq përgjegjësive tjera në RKS 1244, KFOR-i duhet të përkrah, në mënyrë të duhur edhe punën e pranisë ndërkombëtare civile. RKS 1244 kërkon që “të dy pranitë të punojnë në drejtëm të qëllimit të njëjtë dhe në mënyrë të përbashkët”.⁸¹ Pasi që UNMIK-u është përgjegjës për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut, obligimi i KFOR-it të përkrah UNMIK-un kërkon si një minimum, të përmbahet nga minimi i këtij qëllimi. Kjo mund të arrihet vetëm përmes pajtueshmërisë me standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut.⁸² Së dyti, obligimet e Republikës Federale të Jugosllavisë mbi të drejtat e njeriut mbeten në fuqi në tërë territorin dhe i obligojnë autoritetet që janë në fuqi tani. E treta, obligimet mbi të drejtat e njeriut të qeverive të vendeve që kanë kontingjente të KFOR-it aplikohen në sjelljet e trupave të tyre jashtë vendit. Pasi që SHBA-të kanë nënshkruar dhe ratifikuar KNDCP-në dhe Deklaratën Amerikane mbi të drejtat e njeriut, standardet të parashikuara në këto instrumente janë të obligueshme për KFOR-in e SHBA-ve.⁸³ Komisioni Inter – Amerikan mbi të Drejtat e Njeriut ka gjetur se shtetet Amerikane janë të lidhura me obligimet mbi të drejtat e njeriut edhe në trajtimin ekstra-teritorial të jo shtetasve të tyre.⁸⁴

Ashtu si u përshkrua më lart, ligjet ndërkombëtare kërkojnë minimumin që paraburgimi të jetë i bazuar në ligj të qartë, dhe që çdo i paraburgosur të ketë të drejtën që paraburgimin ta sfidojë para gjykatës.⁸⁵ Kjo madje aplikohet edhe tek ushtritë gjatë konfliktit të armatosur. Duhet të theksohet se qeveria e Shteteve të Bashkuara ka pranuar në kontekst tjetër se është e obliguar për të dorëzuar menjëherë tek sistemi gjyqësor personat e paraburgosur nga armata e saj, madje edhe gjatë konfliktit të armatosur.⁸⁶ Në mënyrë që t’i binden ligjeve ndërkombëtare, paraburgimet nga ana e KFOR-it duhet të kenë bazë të qartë juridike, dhe të bazohen në kritere të kufizuara që mund ta arsyetojnë paraburgimin nën ligjin ndërkombëtar.⁸⁷ Pushteti i KFOR-it për të paraburgosur, nuk është paraparë në asnjë ligj apo rregullore në Kosovë. Për më tepër, paraburgosja e personave që mund të jenë “rrezik për paqe dhe siguri” nuk është paraburgosje e personave për të cilët dyshohet se kanë kryer krime. Ne vend të kësaj kjo

⁸⁰ Karta e Kombeve të Bashkuara, Neni 1 (3), shih poashtu neni 55 (c).

⁸¹ Rezoluta e KSKB 1244, para 6.

⁸² Ky propozim është përkrahur më 4 Korrik 1999 më deklaratën e Ushtrisë të Detyrës të PSSP Sergio Viera de Mello. Duke thënë se KFOR-i është përgjegjës për garantimin e rendit dhe qetësisë publike deri në atë kohë sikurse edhe UNMIK-u që ka qenë e aftë të bëjë atë, ai theksoi se KFOR-i është i lidhur për standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut gjatë kryerjes së detyrave të tij. “Deklarata mbi të Drejtat e KFOR-it të Arrestoj dhe Paraburgos”, Zyra e Ushtrisë të Detyrës të PSSP, UNMIK, 4 Korrik 1999

⁸³ Konventa mund të ketë aplikim ekstrateritorial, siu vendos nga Komiteti mbi të Drejtat e Njeriut, Komente mbi SHBA, par. 19, U.N. Doc. CCPR/C/79/Add 50 (1995).

⁸⁴ Shiqo *Coard et al kundër SHBA*, rasti 10.675, Raporti nr. 51/96

⁸⁵ Neni 5 dhe 6 KEDR, Neni 9 dhe 14 ICCPR, Neni XXV i Deklaratës Amerikane mbi të Drejtat dhe detyrat e njeriut (e nënshkruar nga SHBA)

⁸⁶ Kjo u bë e qartë në rastin *Coard et al. kundër SHBA-ve*, vendosur më 29 shtator 1999 nga ana e Komisionit Inter – Amerikan mbi të drejtat e njeriut. Në këtë rast, që kishte të bëjë me paraburgosjen e civilëve nga ana e Armatës Amerikane gjatë invazionit të Grenadës, SHBA argumentoi se i përmbushi obligimet e saja të dorëzimit të paraburgosurit organeve të gjyqësisë, duke i dorëzuar gjyqit pas dy javëve të paraburgimit. Komisioni nuk u pajtua me këtë, duke theksuar se dy javë është kohë e gjatë për armatën që të paraburgosë personat, edhe pse Armata e SHBA-ve ka qenë e inkuadruar në konflikt gjatë një pjese të periudhës. Rasti 10. 951, Raporti Nr. 109/99.

⁸⁷ Shiqo PNDKP Neni 9, KEDNj Neni 5.

është “paraburgosje preventive”, e bazuar në kriteriume të gjëra dhe shumë të paqarta mbi personat për të cilët autoritetet vendosin se mund të paraqesin rrezik. Ky lloj i paraburgimit nuk është i lejuar nga ana e KEDNJ neni 5, si Gjykata Europiane e Drejtave të Njeriut spjegoi në rastin *Jecius kundër Lithuanisë*.⁸⁸ Andaj, bazat e KFOR-it për paraburgim nuk janë në pajtim me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.

Shtrohet pyetja, natyrisht, se a ka KFOR-i fuqi të derogoj ligjet mbi të drejtat e njeriut, në raste të emergjencës. KFOR-i si arsytim për përdorimin e paraburgimit ka dhënë vështirësitë në themelimin e organeve gjyqësore dhe policisë, si dhe çrregullimet jashtë Kosovës. PSSP poashtu ka deklaruar se KFOR-i është i autorizuar të paraburgosë personat kur “nuk ka mundësi t’i bëjë të disponueshme informatat e ndieshme, përfshirë këtu edhe informatat e shërbimeve të zbulimit”.⁸⁹

Edhe pse këto janë shqetësime valide, asnjëra nga këto nuk mund të arsyetoj në mënyrë ligjore këtë hap të jashtëzakonshëm të paraburgosjes jashtë gjyqësore të një numri të madh personash, në kohë të pakufizuar, dhe pa rishikim të pavarur. Të gjitha shqetësimet mund të eliminohen duke e zhvilluar sistemin gjyqësor. Për dy vite të mandatit të tij, UNMIK-u e ka vendosur sistemin gjyqësor me pjesëmarrje të vendorëve dhe ndërkombëtarëve, dhe poashtu një polici kryesisht ndërkombëtare. Edhe pse SMSL ka shprehur shqetësime lidhur me problemet e vazhdueshme në sistemin gjyqësor, ai sistem funksionon çdo ditë. Pjesëmarrja e shtuar e gjyqëtarëve dhe prokurorëve ndërkombëtarë në veçanti i mundëson sistemit gjyqësor të merret edhe me rastet më të ndieshme në mënyrë objektive dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare të drejtave të njeriut.

Për më tepër, rregulloret e fundit mbi kalimin e kufirit, terrorizmin, mbi armëmbajtjen dhe mbi masat kundër krimit të organizuar, sigurojnë instrumente ligjore për hetimin dhe ndjekjen penale të personave për të cilët dyshohet se janë të inkuadruar në aktivitete ilegale në kufi dhe në zonat kufitare të Kosovës.⁹⁰ Me këto mjete, problemi i sigurisë trajtohet nëpërmjet ligjit, si bëhet në pjesën tjetër të Europës. Nëse nevojiten edhe masa më specifike, pjesëmarrja në organizata të caktuara të lidhura me kryengritjet mund të shpallet ilegale.

Problemi i përdorimit të materialit të ndieshëm, përfshirë shërbimet ushtarake të zbulimit, është problem me të cilin ballafaqohen sistemet gjyqësore në tërë botën, posaçërisht ato të cilat merren me terrorizmin dhe problemet kyçe të sigurisë. Mirëpo nevoja për mbrojtjen e informatave të ndieshme nuk mund asnjëherë të jetë arsye për paraburgosjen e personave jashtë sistemit gjyqësor ose për të mos ja dhënë mundësinë për të sfiduar paraburgimin e tyre.⁹¹ OSBE-ja ka ofruar të bashkëpunoj me KFOR-in dhe Administratën Civile të OKB-së, në mënyrë që sistemi gjyqësor të ketë procedurë të nevojshme në mënyrë që të jetë i gatshëm të merret me këso informata, duke i mundësuar personave të kenë gjykim të drejtë dhe të kenë mundësi të sfidojnë paraburgimin e tyre.

⁸⁸ Aplikacion Nr. 00034578/97, Aktgjykimi 31 korrik 2000, paragrafi 51.

⁸⁹ Letra e PSSP Shefit të OMIK, 31 Gusht 2001.

⁹⁰ Rregulloret e UNMIK-ut 2001/10, 12, 7 & 22

⁹¹ Shiqo Chalal kundër Mbretërisë së Bashkuar, aktgjykimi 15 nëntor 1996, veçanërisht paragrafi 131.

IV. PARABURGIMET E TË SËMURËVE MENTAL

Në raportin e kaluar, është cekur se numri më i madh i të paraburgosurve kundërligjorë (më se 250) gjendet në Shtime/Stimlje në Institutin Special për Persona të Retarduar, nën kontrollin e Departamentit Administrativ për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale (DASHMS). Një nga pacientet e institutit është paraburgosur aty, pa asnjë vendim gjyqësor, për më tepër se 50 vjet. SMSL ka cekur poashtu se janë ndërmarrë hapa për tejkalimin e kësaj gjendjeje, duke i dërguar rastet në Gjykatën komunale në Ferizaj dhe poashtu janë ndërmarrë hapa nga DAD të adresojë këtë çështje pasi që ajo gjykatë refuzoi t'i trajtojë rastet.

Ky zhvillim pozitiv vazhdoi në pranverën dhe verën e këtij viti, dhe situata lidhur me paraburgosjet kundërligjore në Shtime ishte afër zgjidhjes. DASHMS tregoi forcë të re duke tentuar që të zgjidhë situatën, dhe në qershor 2001, nxorri një Udhëzim Administrativ, duke vërtetuar që asnjë person nuk mund të paraburgoset në Shtime pa urdhër të gjykatës. Udhëzimi poashtu njohu se Departamenti i ka borgj detyrimin ndaj personave në Institut që të përgatiten për lëshim, po që se ata dëshirojnë këtë. Instituti më pastaj filloi rishikimin e të gjitha rasteve të personave që gjendeshin në të, duke vendosur se a ka bazë për paraburgimin e tyre. Nëse nuk ka, Instituti duhet të informojë pacientin se ata janë të lirë të largohen – që është bërë në disa raste. Nëse Instituti konsideron që ka baza për mbajtjen e tyre, atëherë rasti duhet t'i referohet gjykatës për të vendosur a do ta caktojë paraburgimin pas një gjykimi të drejtë.

Megjithatë, procesi i zgjidhjes së pozitës juridike të të paraburgosurve, arriti gjer në ndërprerje të përkohshme gjatë verës. Kah fundi i periudhës së mbuluar me raport rishikimi i të gjitha rasteve nuk është përfunduar, dhe asnjë rast nuk i është referuar gjykatës. DASHMS, prandaj, mbetet përgjegjës për numrin më të madh të paraburgimeve kundërligjore në Kosovë. Problemi kyç ka qenë ligji ekzistues mbi trajtimin e personave me të meta mentale i cili është jo adekuat dhe i paqartë, dhe i cili në disa pjesë është jo-funksional (për shembull nuk jep bazat ligjore kur i sëmuri mental duhet të paraburgoset). Grupi punues mbi ligjin për shëndetin mental, përfshirë këtu OSBE-në dhe DAD, në mënyrë efektive e përpiloi draftin e rregullores e cila i adreson këto probleme më heret gjatë vitit, e cila do të themelojë kolegji specialistësh të shëndetit mental në kuadër të Gjykatave ekzistuese të qarkut. Megjithatë, kjo rregullore mbeti e ngujuar në DAD gjatë verës.⁹²

Në kohë të njejtë, në pjesën e parë të këtij viti, DAD i kushtoi shumë kohë dhe mund të sigurojë që gjykatat të jenë në gjendje të merren në mënyrë efektive me rastet e të sëmurëve mental në pajtim me ligjin ekzistues. DAD, së bashku me OSBE-në organizoi në pranverë një sesion informativ për gjyqtarët, punëtorët social dhe psikiatritë. Duke e ndjekur këtë diskutim të frytshëm, DAD përpiloi një qarkore në të cilën ishte shpjeguar se si ligji ekzistues mund të bëhej i përdorshëm, dhe do të siguronte avokatët për pacientët të cilët do të paraqiteshin para gjykatës. Mirëpo, kjo qarkore poashtu nuk u nxjerr, dhe

⁹² SMSL ishte informuar nga DAD se projekt rregullorja ishte dërguar në Zyren e PSSP, Zyrën për Punë Juridike, në Tetor 2001.

mungesa e përfaqësimit ligjor duket të jetë arsyeja pse Instituti akoma refuzon që t'i referojë rastet gjykatës.

Derisa në Shtime është qendra kryesore për paraburgimin e personave të semurë mentalisht, poashtu ka shqetësime lidhur me paraburgimet kundërligjore të sëmurëve mental në sektorin e shëndetësisë, posaçërisht në spitalin e Prishtinës. SMSL ka shumë pak njohuri për atë se sa persona janë të paraburgosur aty, edhe pse besohet se janë mbi njëqind, në çdo kohë. Paraburgimi, megjithatë, është shumë më i shkurtër se ai në Shtime.

Problemet e vazhdueshme me trajtimin e të sëmurëve mental në kuadër të sistemit ligjor penal, posaçërisht përdorimi i “masave të sigurisë” për mbajtjen e personave të cilëve u nevojitet trajtim mjekësor dhe të cilët nuk kanë kryer vepër penale në burg, është akoma brengosëse. Kjo çështje është trajtuar në mënyrë direkte në draftet e ligjit penal dhe atij të procedurës penale, të cilët transferojnë të gjithë përgjegjësinë për trajtimin e të sëmurëve mental në kolegjet (civile) të specialistëve të shëndetit mental, të cilët janë themeluar në draftin e Rregullorës mbi Shëndetin Mental. Prandaj është e rëndësishme që ligjet e reja penale dhe drafti i rregullores mbi shëndetin mental të nxirren sa më shpejtë që është e mundur.

V. KUFINJTË KOHOR TË PARABURGIMIT

Një nga masat mbrojtëse më të nevojshme kundër arrestimit dhe paraburgimit arbitrar është e drejta e sjelljes së menjëhershme para gjykatësit ose ndonjë zyrtari tjetër të autorizuar nga ligji të ushtrijë pushtet gjyqësor. Kjo imponon një obligim pozitiv për autoritetet policore dhe gjyqësore, të sigurojnë që personi është sjellur para zyrtarit gjyqësor brenda kohës së parashikuar me ligj.

SMSL ka bërë analizë të detajzuar të ligjeve të aplikueshme vendore dhe të ligjeve ndërkombëtare mbi kufizimet e kohës së mbajtjes në arrest në raportin e parë dhe të dytë 6-mujor, dhe për atë arsye nuk do t'i përsërisim ato argumente, por do t'i theksojmë disa brengosje dhe zhvillime të kohëve të fundit.

Si rregull, ligji i aplikueshëm në Kosovë parashikon kohën prej 24-orëve për mbajtjen e personit në arrest para se të silltet para gjyqtarit hetues.⁹³ Përgjithësisht, në disa raste specifike, i dyshuari mund të mbahet deri në 72 orë.⁹⁴ Pavarësisht nga kjo, kufizimi prej 24-orëve vazhdon të mospërfillet në Kosovë. Në vend të kësaj përgjithësimi prej 72-orëve është bërë rregull.

Në raportet e kaluara SMSL ka rekomanduar që qendrat e paraburgimit duhet të lirojnë personat të cilët mbahen pa urdhër të gjykatës. Në këtë aspekt, SMSL vërejtë zhvillime pozitive brenda Seksionit të Administrimit të Burgjeve të UNMIK-ut, i cili ka adoptuar politikë të qartë të refuzimit të mbajtjes së personave në paraburgim pa vendim të

⁹³ Neni 195 LPP RFJ

⁹⁴ Neni 196 LPP RFJ. Në dhjetor 2000, Gjykata Kushtetuese e Jugosllavisë e shpalli nenin 196 të LPP RFJ si jo kushtetues sepse lejon paraburgimin të caktuar nga zyrtarët policorë në vend të atyre gjyqësorë

gjykatës. Për më tepër, tani funksionon sistemi ku qendrat e paraburgimit e njohtojnë gjykatën kompetente 72 orë përpara se të kalojë afati i vendimit për paraburgim. Me këtë njohtim, gjykata poashtu informohet se, nëse vendimi mbi vazhdimin e paraburgimit nuk nxirret para se të kalojë afati, atëherë i paraburgosuri do të lirohet.

Sa i përket praktikës së policisë, SMSL ka vërejtur se, edhe pse përjashtimi prej 72-orëve edhe më përdoret si procedurë standarde, ky afat kohor i arrestit së paku respektohet nga ana e policisë. Mirëpo, duket se ka konfuzion brenda policisë lidhur me ndarjen e përgjegjësive në mes të gjyqtarit hetues dhe prokurorit në lëndë penale. Sipas ligjit vendor të procedurës penale, çdoherë kur inicohen hetimet preliminare dhe përpilohet kallëzimi penal, policët hetues duhet t'i dorëzojnë këto prokurorit publik.⁹⁵ Kur i dyshuari është *identifikuar* dhe arrestuar, policia duhet ta sjellë personin para gjyqtarit hetues brenda 24 orëve. Më në fund, kur personat janë arrestuar në pajtim me nenin 196 dhe përjashtimisht mund të mbahen për 72 orë, prokurori duhet të njohtohet *menjëherë*. Kjo ndarje e kompetencave, në disa raste, duket se ka shkaktuar konfuzion te zyrtarët e policisë të cilët kanë dështuar të informojnë zyrtarin gjyqësor përkatës lidhur me rastin, duke i vështirësuar këtij ndërmarrjen e hapave të mëtejme procedural.

Në mënyrë që policia të ketë mundësi t'i sjellë personat para gjyqtarit, para skadimit të afatit kohor, në çdo regjion është përpiluar lista e gjyqtarëve hetues kujdestarë të cilët do të merren me rastet jashtë orarit të punës.⁹⁶ Edhe pse ky është një përparim i dukshëm, SMSL ka vërejtur se sistemi nuk funksionon çdo herë dhe se ka raste që gjyqtarët e zgjasin paraburgimin më tepër se maksimumi i 72 orëve, pa e marrë në pyetje të dyshuarin.

Të mërkurën më 11 korrik policia e UNMIK-ut arrestoi një Kosovar të cili u gjet sasi e madhe e armatimit. Të premten më 13 korrik gjyqtari në detyrë i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, informoi se nuk do të ketë seanca gjatë fundjavës sepse nuk ka punëtorë administrativë që të kryejnë punët përkatëse administrative. Ditën pasuese gjyqtari i njëjtë urdhëroi me shkresë Administratën e Burgjeve ta mbajë të dyshuarin në paraburgim dhe ta sjellë në gjykatë të hënën më 16 korrik. Në këtë rast situata u zgjedh nga ana e gjyqtarit ndërkombëtar i cili e morri në pyetje të dyshuarin para kalimit të afatit prej 72 orëve.

Në një rast tjetër policia i arrestoi dy persona të dyshuar për trafikim të femrave. Të dyshuarit u arrestuan në mbrëmjen e 6 gushtit 2001 në ora 19.15. Më 9 gusht 2001, pak para skadimit të afatit prej 72 orësh, të dyshuarit u sollën para gjyqtarit në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë. Gjyqtari megjithatë nuk i morri në pyetje të dyshuarit por urdhëroi që ata të transferohen nga arresti policor në qendrën e paraburgimit. Arsyeja për këtë si tha gjyqtari ishte që prokurori nuk ishte njohtuar me kohë dhe për këtë arsye nuk ka patur mundësi të bëjë kërkesë për zbatimin e hetimeve. *I pyetur se çfarë bazë juridike ka për shtyerje të marrjes në pyetje, gjyqtari tha se nuk ka bazë ligjore por është praktikë e zakonshme që këto të shtyhen për 24 orë.* Të dyshuarit u morrën në pyetje ditën e nesërme.

⁹⁵ Neni 151 dhe 153 LPP RFJ

⁹⁶ Çdo stacion policor për çdo javë e merr listen e përpiluar nga kryetarët e gjykatave, e cila tregon se cili gjyqtar është kujdestar jashtë orarit të punës

Si u pranua nga gjyqtari në rastin e dytë, vendimet e mësipërme për shtyerjën e marrjës në pyetje nuk kanë bazë ligjore. Ligji vendor parasheh që, gjyqtari hetues, pasi ta informojë të dyshuarin për të drejtën e tij/saj për të patur mbrojtës, mund ta shtyejë marrjen në pyetje për 24 orë në mënyrë që i dyshuari të caktojë mbrojtësin.⁹⁷ Mirëpo sipas komentarit të këtij ligji, nëse periudha kohore në nenin 192 (3) është shkelur për shkak të vonesës në sjelljen e të dyshuarit para gjyqtarit brenda 24 orëve ashtu si parashikohet me nenin 195, vendimi duhet të merret menjëherë.⁹⁸ Edhe pse nuk është e qartë se si këto komente lidhen me arrestin policor prej 72 orëve të nenit 196, duket e arsyeshme të konkludohet se kur rregulla e 72 orëve aplikohet, nuk lejohen zgjatje të tjera të afatit. Në asnjërin prej rasteve të cekura, zgjatja e afatit nuk ishte në interes të pandehurit. Gjithashtu, sa i përket rastit të dytë, ligji vendor parasheh situatën kur marrja në pyetje është bërë para se prokurori të ketë bërë kërkesë për zbatimin e hetimeve. Në rast të këtillë, prokurori duhet të bëjë kërkesë brenda 48 orëve, ose i dyshuari do të lirohet.⁹⁹

Për këtë arsye, duke pranuar zhvillimet në respektimin e kufizimeve kohore të arrestit policor, SMSL është akoma i brengosur me shkeljet e kohëpaskohëshme të drejtave themelore të dyshuarit lidhur me rishikimin gjyqësor të paraburgimit në kohë të duhur. Edhe pse situatat si ato të përmendura më parë munden së pari t'i ngarkohen gjyqtarit hetues ose prokurorit, nga organet policore përsëri pritet që të kryejnë veprimet inicuese hetimore brenda afatit kohor të arsyeshëm, në mënyrë që zyrtarët gjyqësor të kenë kohë të mjaftueshme për kryerjen e detyrave të tyre, siq kërkohet.

VI. REKOMANDIMET

Paraburgimet jashtë gjyqësore nga ana e PSSP dhe KFOR-it

- SMSL sygjeron që praktika e paraburgimeve jashtë gjyqësore mund efektivisht të zëvendësohet duke inicuar një mekanizëm (sistem) për të lejuar që provat e ndieshme të dëgjojnë në sitemin gjyqësor penal, duke u respektuar e drejta e të pandehurit për të sfiduar paraburgimin. Gjykatësit dhe prokurorët ndërkombëtar brenda strukturës së tanishme të UNMIK-ut mund dhe duhet të kyqen në rishqyrtimin e provave të tilla të ndieshme duke e mbajtur, posaçërisht nga aspekti i paraburgimit, të njëjtin brenda sistemit gjyqësor. Duke vazhduar të njëjtën vijë të arsyeshmërisë, SMSL rekomandon që KFOR-i duhet të vendosë praktikën e tij të paraburgimit në linjë me garancat dhe mjetet juridike, të ofruara si me të drejtën vendore ashtu edhe me atë ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut. Në veqanti, informimi i menjëhershëm mbi bazat për paraburgim dhe të drejtën për të angazhuar mbrojtës, duhet të sigurohet menjëherë pas arrestit dhe pasueshëm, të paraburgosurit duhet t'i besohen sistemit gjyqësor për hetime dhe rishqyrtim brenda kufinjëve kohor të parashikuar me ligjin e aplikueshëm. Kur të paraburgosurit e veçantë ishin arrestuar në bazë të mekanizmave specifike të mbledhjes së informatave, KFOR-i mund të adresoj këto raste bashkë me informatat e

⁹⁷ Neni 193 LPP RFJ

⁹⁸ Komentari i LPP, Branko Petriq, Beograd 1986

⁹⁹ Neni 193 (4) LPP RFJ

ndieshme prokurorit ndërkombëtar apo gjykatësit hetues i cili më tej mund të siguroj mbrojtjen e provave dhe të njëjtën kohë mund t'i lejoj të paraburgosurit të gjitha mjetet juridike për rishqyrtimin e paraburgimit të tij/saj.

Rrjedhimisht, duhet të përpilohet një rregullore që do të sigurojë prezentimin dhe përdorimin e provave të ndieshme në gjykatë duke respektuar parimin e barazisë së fakteve dhe të drejtat e të pandehurit. OSBE-ja përsërit ofertën e saj të ndihmë në implementimin e shpejtë të rregullorës së tillë. Për shembull, rregullorja e UNMIK-ut 2001/18 mbi komisionin për rishikimin e paraburgimeve, e nxjerrë para pak kohësh, përfshin në vehte procedurat ku provat e ndieshme mund të shqyrtohen, që mund të jetë një pikënisje.¹⁰⁰

- Në mënyrë që të jetë i gatshëm t'i dorëzojë rastet sistemit gjyqësor, KFOR-i ka kërkuar që një prokuror ndërkombëtar të ndërmerrë ndjekjen penale. Për momentin, vetëm një prokuror ndërkombëtar gjendet në regjionin e Gjilanit, dhe vëllimi i punëve nuk i lejon asaj të pranojë të gjitha rastet e dorëzuara nga KFOR-i. Për këtë arsye është e nevojshme që PSSP të emërojë edhe një prokuror ndërkombëtar në regjionin e Gjilanit.
- Komisioni për rishikimin e paraburgimeve duhet të shfuqizohet.
- KFOR-i duhet të njohtojë se do të respektojë çdo urdhër të gjykatës për lirin e personave që mbahen nga ai.

Paraburgimet e të sëmurëve mental

- Drafti i rregullores mbi heqjen e lirisë dhe shërimin e detyrueshëm duhet të shpallet sa më shpejt
- DAD duhet të nxjerrë një qarkore mbi implementimin e Ligjit mbi Procedurën Jashtë Kontestimore lidhur me paraburgimet e të sëmurëve mental duke konfirmuar që ndihma juridike do të sigurohet në çdo rast.
- Instituti Special në Shtime duhet që menjëherë të përfundojë rishikimin e rasteve. Të gjitha rastet në të cilat besohet se personat duhet të mbahen duhet t'i referohen menjëherë gjykatës. Të gjithë personat tjerë duhet të njohtohen se janë të lirë të largohen.
- Përdorimi i paraburgimit në sektorin e shëndetësisë, posaçërisht në Spitalin e Prishtinës duhet të rishikohet

Kufinj të kohor të paraburgimit

- Policisë së UNMIK-ut duhet t'i sigurohet trajnim adekuat mbi rolin e tyre në hetimin e veprave penale, posaçërisht lidhur me detyrën e tyre të informojnë menjëherë prokurorin për arrestimin e personit dhe mbi detyrën e tyre që menjëherë – p.sh. brenda 24 orëve – të sjellin personin e arrestuar para organeve të gjyqësive.
- Zyrtarët e gjykatës duhet të ndërprejnë dhënjen e urdhërave policisë së UNMIK-ut dhe autoriteteve të burgut të mbajnë në paraburgim personat të cilët nuk janë marrë në pyetje edhe pas kalimit të arrestit policor.

¹⁰⁰ Rregullorja e UNMIK-ut 2001/18, seksioni 5.

- DAD duhet të rishikojë sistemin e gjyqtarëve kujdestarë në mënyrë që të ju sigurojë mbështetje të nevojshme logjistike (p.sh. daktilografë, përkthyes, etj.) për të mbajtur seancat edhe pas orarit të punës.

SEKSIONI 5: TRAFIKIMI DHE KRIMET SEKSUALE

I. HYRJE

Me të dy dimenzionet si humanitar ashtu edhe ligjor, qështja e trafikimit të personave është një shqetësim i madh për SMSL, dhe për aktorët brenda administratës dhe gjyqësisë në Kosovë. Ishte një rritje alarmuese e numrit të rasteve të tilla gjatë gjashtë muajve të fundit dhe vetëm disa resurse të përcaktuara për t'i ndihmuar viktimat apo dëshmitarët të kyqur në këto raste. Përcaktimi i një qasjeje për ta zhdukur këtë fenomen, është dëshmuar të jetë një sfidë e rëndësishme për organet e rendit dhe për gjyqësinë. Hyrja në fuqi e Rregullores 2001/4, në janar të vitit 2001, ilustroi qëllimet e administratës ekzekutive që të mirret me këtë çështje seriozisht, dhe në të njëjtën kohë ka ofruar një instrument ligjor i cili është pritur të jetë më efektiv se sa korniza e vjetër e paraparë sipas Ligjit Penal të RFJ-së.¹⁰¹

Megjithatë, përkundër interesit të shprehur nga autoritetet në rastet e trafikimit, reforma ligjore dhe e organeve të rendit ka treguar efekt minimal mbi frekuencën dhe peshën e kriminalitetit të trafikimit. Ndonëse me njësi të specializuar të policisë dhe rregullore të re kundër trafikimit, rregullat e provave nuk lejojnë përdorimin e provave përmbyllëse të fituara në gjykatë, mbrojta e dëshmitarëve dhe siguria e tyre nuk përfshin edhe viktimat e trafikimit që mirren si dëshmitarë, shërbimet sociale nuk kanë ndonjë reagim efektiv për viktimat, dhe UNMIK-u nuk ka përcaktuar Koordinatorin për ndihmën e viktimave, siq është obliguar me Rregulloren 2001/4. Këto dështime kanë kontribuar në mosarrestime të rëndësishme të trafikuesëve, në hetime të shkurta me prova të pamjaftueshme, në zhdukjen e dëshmitarëve, dhe mosbesimin në policinë dhe gjyqësinë.

Gjatë këtij viti, SMSL dokumentoi dhe monitoroi 21 raste,¹⁰² që kishin lidhje me trafikim, të ndjekura, ose nën dispozitat e nenit 251 të LP të RFJ ose të Rregullores 2001/4. Nga të gjitha këto raste, janë mbajtur 8 gjykime dhe në këto aktgjykime, dënimi është shpallur prej 5 muaj deri në 6 vite burgim. Rastet tjera ose janë ende nën hetime, ose është caktuar data për gjykim, ose gjykimet janë pezulluar në pritje. Analiza e më poshtme pasqyron një mbivështim të zhvillimeve strukturale dhe substanciale në këtë fushë, në nivelin e organeve të rendit, prokurorive dhe gjykatave.

II. ORGANET E RENDIT PUBLIK (POLICIA)

Krijimi i Njësisë Hetuese për Trafikim dhe Prostitucion (NHTP), përbrenda Policisë së UNMIK-ut dëshmon përpjekjet e UNMIK-ut të mirren në mënyrë efektive me kriminalitetin lidhur me trafikimin e personave. Si njësi e specializuar, NHTP u krijua që t'i qaset trafikimit përmes një këndvështrimi me përvojë, e cila kupton aspektin e

¹⁰¹ Shih LPP RFJ Neni 251, për shembull.

¹⁰² Paraqet numrin total të rasteve që kanë lidhje me trafikim që janë punuar në gjykata në tërë Kosovën. Shtjellimi i rasteve për regjion është si vijon: 3 raste në Prishtinë, 3 raste në Gjilan, 4 raste në Pejë, 2 raste në Mitrovicë, 9 raste në Prizren.

organizuar të trafikimit si dhe këndvështrimin e viktimave. SMSL kupton se përgjegjësia për luftimin e një fenomeni aq kompleks, nuk shtrihet vetëm në NHTP. Përpyqjet e koordinuara duhen të përqëndrohen në arritjen e një përgjegje gjithëpërfshirëse dhe efektive. Kjo përfshinë parimisht koordinimin përbrenda Policisë së UNMIK-ut, dhe mes Policisë së UNMIK-ut dhe KFOR-it, pasi që ky i fundit në disa raste merr rolin organit të rendit. Me vendosjen efektive të kapaciteteve logjistike, dhe kuptimin se NHTP është organ i rendit që gjindet në ballë të frontit kundër trafikimit, duke kërkuar përkrahje të qartë nga organet tjera të rendit, kriminaliteti i trafikimit me njerëz mund të pësojë një kundërpërgjegje vendimtare. Një koordinim i tillë i procedurave dhe rregullave është aspekt esencial për të siguruar se aktivitetet e organeve të rendit sigurojnë mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut.

Çështjet strukturale

Mungesa e masave mbrojtëse të cilat garantojnë sigurinë e viktimave dhe dëshmitarëve

Një sfidë shumë e madhe në hetimin dhe ndjekjen e rasteve të trafikimit rrjedh nga vet natyra e krimit, pasi që provat shpeshherë janë më tepër teorike dhe vështirë mblidhen pa bashkëpunimin e viktimës. Dëshmia e viktimës është vitale dhe të gjitha aktgjykimet e sukseshme janë bazuar në dëshmitë dhe provat e viktimave. Shumica e viktimave që kanë dashur të japin dëshminë janë ato viktimat që kanë marrë pjesë vullnetarisht në programin për kthimin nëpër vendet e veta, e i cili nuk është i lidhur me policinë. Të rralla janë dëshmitë e dëshmitarëve që nuk janë viktimat, të cilët kanë dijeni për rrethanat e rastit. Megjithatë, përderisa dëshmitë e viktimave, potencialisht janë qenësore për ndjekjen e rasteve të trafikimit, këto shumë vështirë sigurohen. Bashkëpunimi me prokurorinë është i rrezikshëm për viktimën apo dëshmitarin, dhe për këtë nuk mund të mirren me dhunë. Kur viktimat apo dëshmitarët vendos që të mos dalë përpara dhe të japë dëshminë, por është shtyrë përkundër dëshirës së vet, atëherë ekziston rreziku se këta dëshmitarë mund të kthehen kundër dhe të kërcënojnë kredibilitetin e tërë ndjekjes.

Elementet e krimit zakonisht implikojnë ekzistencën e rrjeteve mirë të organizuara të kryesve (regrutuesit, shitësit, blerësit, transportuesit, menagjerët e klubeve të natës, etj.), për këtë, nëse një apo disa nga kryesit janë zënë, kërcënimi akoma ekziston që bashkëvepruesit tjerë të cilët janë ende në liri, të paraqesin rrezik serioz për mirëqenjen e viktimave të cilat bashkëpunojnë. Rrjedhimisht nëse pritet që të bashkëpunojnë, viktimat dhe dëshmitarët duhet të mbrohen jo vetëm në baza ad hoc, por përmes një skeme të gjërë që radhitet prej një sigurie të përkohshme dhe afatshkurtër deri te rivendosja e sigurtë, dhe alternativat psikologjike dhe sociale për të ardhmën.

SMSL rekomandoi implementimin e një programi të tillë për mbrojtjen e dëshmitarëve në raportet e mëparshme, por rezultate konkrete ende nuk janë parë. Më tepër, viktimat e trafikimit janë marrë nga lokalet e natës dhe është kërkuar nga ato që të marrin pjesë dhe të bashkëpunojnë në hetime, edhe pse momentalisht nuk ka ndonjë mekanizëm efektiv për viktimat, siq është strehimi i sigurtë i viktimave gjatë hetimeve. Në disa raste të veqanta, vendosja e përkohshme dhe e sigurtë është ofruar gati secilën herë me ndihmën financiare të OSBE-së apo nga ndonjë organizatë tjetër për ndihmën e viktimave. Këto masa nuk janë bazuar në një strukturë dhe organizim të rregulluar. Përderisa NHTP ka

shpreh frustrimin për mungesën e resurseve financiare dhe materiale për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe viktimave, dhe përderisa Shtylla I-rë nuk i është përgjigjur sfidës, viktima/dëshmitarët posa të ishte siguruar dëshmia e tyre, janë gjetur, në disa raste nën mëshirën e resurseve të veta,. Si femra të huaja, resursi i vetëm që ato kishin ishte shpeshherë është i njëjti prej të cilit edhe kan ikur.

Një shembull ilustrativ është rasti i tri femrave të huaja, të arrestuara pas një kontrolli që u bë në lokalin “Kuins” në Prishtinë. Pas një dëgjimi të shkurtër para gjykatësit për kundravajtje, tri femrat u dënuan për “kalim ilegal të kufirit”: me nga 10 ditë burg, të cilat i mbajtën në qendrën e paraburgimit në Lipjan. Edhe pse ato në fillim refuzuan të japin dëshminë e tyre, më vonë pranuan të japin deklaratën e tyre të plotë se si u trafikuan në Kosovë, duke kërkuar që tu garantohet siguria personale. Një zgjidhje ad hoc u gjet dhe viktimat u vendosën përkosisht në një hotel, nën mbrojtjen e policisë. Megjithatë, pasi që i dhanë deklaratat para NHTP dhe gjykatësit hetues, tri viktimat përfunduan në rrugë dhe më vonë u morën dhe u dërguan në një tjetër lokal nate në Prishtinë, ku u detyruan përsëri në prostitucion. Gjatë një kontrolli në lokalin e dytë, NHTP gjeti tri viktimat në mes të vallzueseve prostituta dhe i solli ato para gjykatësit hetues që të japin dëshminë. Asnjë formë e mbrojtjes së organizuar nuk i u ofrua as herën e dytë.

Në një seri të rasteve të lidhura me trafikim të monitoruara nga SMSL në Prizren, hetimet para gjykimit madje edhe një gjykim u detyrua të ndalet pasi që mungesa e dëshmiave e shtyri prokurorinë që të ndalë ndjekjen. Viktimat të cilat fillimisht dhanë deklaratat e tyre para policisë, e të cilat inkriminonin pronarët e lokaleve dhe bashkëpunorët e tyre, në fund ndërronin deklaratat e tyre duke thënë se nuk janë shtyer të bëjnë asgjë kundër dëshirës së tyre. Asnjë nga këto viktima/dëshmitare nuk i është ofruar mbrojtja apo relokimi pas deklaratave të para që i kanë dhënë. Një i dyshuar i involvuar në disa hetime të rasteve lidhur me trafikim deri tash ka patur sukses të ikë nga ndjekja, pasi që viktimat të cilat e raportuan se ai po i obligon me dhunë të ushtrojnë prostitucion në lokalin e tij ndërruan deklaratat e tyre gjatë hetimeve. Në një rast policia thirri për së dyti herë viktimën e quajtur I.R., një javë pas deklaratës së parë inkriminuese dhe ajo kërkoi që deklarata e saj të mos mirret parasysh dhe të ndërpriten hetimet. Hetuesit e policisë vërejtën disa shenja në trupin e viktimës. Prapseprap edhe pas këtyre shenjave të qartë të kërcënimit, policia mori masa të pamjaftueshme që të mbrojnë viktimat dhe të sigurojnë dëshmitë kyqe kundër trafikuesëve.

Çështjet logjistike të cilat pengojnë hetimet

Standardet e njohura ndërkombëtare për të drejtat e njeriut tregojnë që e drejta për përkthyes dhe përkthimin adekuat të dokumenteve relevante, vlen jo vetëm gjatë gjykimeve, por gjatë gjitha fazave të procedurës, përfshirë këtu edhe marrjen në pyetje nga policia.¹⁰³

Një problem logjistik i cili ka penguar punën e organeve të rendit, e të cilat punojnë kundër trafikimit ka qenë përkthimi i dokumenteve apo i procedurës, në gjuhën e viktimës apo në një gjuhë të cilën ajo e kupton. Viktimat e vendeve të huaja janë subjekt i marrjes në pyetje, të cilat mund të jenë traumatike, në gjuhën të cilën ato nuk e kuptojnë, përkundër faktit se shumë raste dështojnë për shkak të pamundësisë së viktimës që të

¹⁰³ Parimi 14 i KB Grupi Parimesh për Mbrojtjen e të Gjithë Personave nën Çfarëdo Lloji të Paraburgimi apo Burgimi.

lidhin provat dëshmuese. Një teknikë ad hoc e përdorur nga hetuesit e policisë, është që të përdorin shërbimet e zyrtarëve të UNMIK-ut, të cilët janë bashkëvendas me viktimat/dëshmitaret, dhe të bëjnë përkthimin. Kjo zgjidhje një njërën anë rrezikon përkthimin jo preciz nga përkthyesi joprofesional, dhe në tjetrën anë, mund të ngritë dyshimin në paanshmërinë dhe pavarësinë e përkthyesit, i cili ka mundur të jetë i kyqur në hetimet e njëjta.

Nga një perspektivë tjetër por lidhur me përkthimin, SMSL është e brengosur me procesin e regjistrimit të inicuar nga NHTP, për regjistrimin e femrave nga vendet e huaja e të cilat punojnë në Gjilan. Nga këto femra kërkohet të nënshkruajnë një dokument specifik, që t'i shmangen ndjekjes për hyrje dhe qëndrim ilegal në Kosovë. Edhe pse dokumenti është i shkruar në gjuhën angleze, shqipe dhe serbe, përderisa shumica e këtyre femrave nuk e flasin asnjërën nga këto gjuhë, prapë pritet nga ato që të nënshkruajnë dokumentin pa ndonjë përkthim adekuat. Pasi që pasojë e mospërbushjes së kërkesave nga ky dokument, është ndjekja dhe deportimi sipas akuzës së tipit të imigracionit, kjo praktikë ka potencial që të shkel të drejtën e individit që të jetë i informuar për obligimet ligjore që parashihen në dokument, në gjuhën të cilën ai/ajo e kupton.

Çështjet substanciale

Efektiviteti i hetimeve

SMSL ka observuar një trend gjatë muajve të fundit, lidhur me qasjen e organeve të rendit, të cilët po bëjnë hetimet dhe po i ndriçojnë rastet e trafikimit. Policia e UNMIK-ut, shpeshherë në bashkëpunim me KFOR-in dhe Karabinierët, ndërmorën kontrollime masive në tërë Kosovën, në lokalet e dyshuara që mbajnë dhe përdorin femrat e trafikuar. Këto operacione janë karakterizuar si operacione të suksesshme, që kanë patur një ndikim të rëndësishëm në qarqet kriminale të kyqyra në trafikim, për publikun dhe mediat. Shumica e këtyre operacioneve rezultuan, në të vërtetë, në dhjetra arrestime, por megjithatë jo edhe të trafikuesëve të dyshimtë. Por në vend të kësaj, femrat nga vendet e jashtme të cilat kanë qenë viktimat të trafikimit, janë arrestuar dhe akuzuar për kundërvajtje të ndryshme, lidhur me imigracion. Një numër i madh i rasteve të tilla, janë raportuar në regjionin e Gjilanit, regjionin e Prishtinës dhe një numër më i vogël në regjionin e Prizrenit. Aq më tepër, shumica e këtyre femrave janë ndjekur dhe dënuar për kalim ilegal të kufirit apo për posedim të dokumenteve të rrejshme, pasi që ato ose nuk kan patur pasaporte, ose pasaportet e tyre nuk kanë patur vula hyrëse për teritorin e Kosovës. Shumë prej tyre vuajtën dënimin prej 10 deri 20 ditë burg dhe morën urdhërat për deportimit.

Në regjionin e Gjilanit, operacionet e këtij lloji janë kryer bashkarisht me policinë e UNMIK-ut (NHTP) dhe Shërbimin Policor të Kosovës. Koordinatorin e UNMIK-ut për SHPK-në, arsyetoi operacionin si “nevojë morale” i diktuar nga presioni i rritur publik. SHPK dhe NHTP, siq është raportuar, janë alarmuar për rritjen rapide të numrit të femrave të huaja që punonin në lokalet e ndryshme, nëpër regjione të dyshimta, që janë kyqur në prostitucion. Si masë për ta kontrolluar këtë fenomen, NHTP inicioi sistemin e regjistrimit për femrat e huaja, siq u diskutua më lartë, që punuan kundër femrave që

përkonin me profilin e paraparë nga policia, psh. femrat e huaja që punonin nëpër bare dhe në lokalet e natës. Nga këto femra është kërkuar që të nënshkruajnë një dokument të përpiluar nga njësia e policisë regjionale, e cila do t'i autorizonte ato që të qëndrojnë në Kosovë për një muaj apo për derisa të zgjasë “kontrata e tyre e punës”. Nëse këto femra vendosin të qëndrojnë më gjatë, atëherë ato do të ballafaqohen me veprime ligjore të inicuar nga policia.

SMSL është e shqetësuar për këtë qasje, pasi që paraqet një përpjekje joefektive për të zbuluar trafikimin, dhe metodë të gabuar për organet e rendit publik. Duke i patur në shënjestër femrat, e jo organizatorët dhe makrot që kanë fitim prej tyre, është më lehtë dhe më pak rrezik, por mund t'i tjetërsojnë viktimat dhe të krijojnë frikë edhe më të madhe, nga organet e rendit. Përkundrazi, policia ka deklaruar se procesi i regjistrimit u mundëson atyre qasje më të madhe tek viktimat potenciale, dhe gjithashtu u ofron viktimave mundësinë që të raportojnë ndonjë sjellje kriminale, që është bërë kundër tyre. Në realitet, sistemi i nxjerrë nga policia mund të frustrojë çfarëdo përpjekje për të fituar besimin e viktimës. Aq më tepër, ndjekja penale e viktimave për kundërvajtjet siq janë kalimi ilegal i kufirit apo posedimi i dokumenteve të rrejshme, shikohet nga policia si metodë për ta “thyer femrën”, dhe t'i shtyjë ato që të dëshmojnë kundër trafikuesve.

Praktikat e tilla jo vetëm që janë joproduktive në kuptim të kontrollimit të fenomenit të trafikimit, por ato shkelin edhe të drejtën e viktimës, siq është e paraparë në Rregulloren 2001/4. Seksioni 8 i rregullores, siguron se personi nuk do t'i nënshtrohet përgjegjësisë penale për prostitucion, hyrje ilegale punë apo prezencë në Kosovë, nëse ka dëshmi që përkrahin besimin e arsyeshëm se personi është viktimë e trafikimit. Aq më tepër seksioni 10.2¹⁰⁴ dhe 10.3¹⁰⁵ imponojnë një **obligim** për zyrtarët e rendit publik, që të këshillojnë dhe promovojnë të drejtat e viktimave të trafikimit siq është e paraparë në seksionin 10.1¹⁰⁶, pa marrë parasysh dyshimet apo edhe akuzat për prostitucion apo hyrje ilegale në Kosovë.

Konflikti i mundshëm i interesave

SMSL është i shqetësuar që disa hetime të trafikimit në nivelin policor involvojnë konfliktin e mundshëm të interesave, mes hetuesve ku personeli i policisë është i involvuar në trafikim apo kanë përdorur shërbimet e viktimave të trafikimit. Shumë nga viktimat e intervistuar nga SMSL, deklaruan se oficerët ndërkombëtarë të policisë ishin “klientët” e rregullt të tyre.

Përtej aspektit moral dhe penal (Rregullorja 2001/4 dënon përdorësit e viktimave të trafikimit, sipas seksionit 4), kjo çështje ngritë konflikt potencial të intereseve. Të njëjtit

¹⁰⁴ Shërbimet dhe lehtësirat për të ndihmuar viktimat e trafikimit, do të jenë në dispozicion për viktimat e tilla në përputhshmëri me seksionin 10.1, pa marrë parasysh ndjekjen për prostitucion apo hyrje ilegale, prezencë apo punë në Kosovë, që mund të pritet kundër tyre.

¹⁰⁵ Oficerët zbatues të ligjit do të këshillojnë personat të cilët janë të dyshimtë për viktimat e trafikimit në rastin e parë të mundshëm për të drejtën e tyre për të kërkuar shërbimet dhe lehtësirat e parapara në këtë seksion dhe do të kontaktojnë personin përkatës për të rregulluar ndihmën e kërkuar.

¹⁰⁶ Seksioni 10.1 ofron që viktimave e dyshuara të trafikimit do ti ofrohet përkthimi falas në gjuhën të cilën ata e zgjedhin, këshillim falas juridik, banim i përkohshëm i sigurtë, ndihmë për mirëqenie psikologjike, mjekësore dhe sociale.

zyrtarë që përdorin këto “shërbime” mund të jenë të kyqyr në një pikë në trafikim, apo në hetime lidhur me atë rast, dhe nën rrethana të tilla paanshmëria e tyre është e prekur seriozisht. Aq më tepër, një pozitë e tillë konfliktuozë përbrenda autoriteteve zbatuese të ligjit ngrit dyshimin e prezencës së përgjithëshme ndërkombëtare në Kosovë, qoftë ajo administrata, gjyqësia apo organet tjera të kyqura në ngritjen e shoqërisë së re.

SMSL dokumentoi rastin e zyrtarit të Policisë së UNMIK-ut në Mitrovicë, i cili ishte raportuar nga një viktimë e mitur, për abuzim seksual. Për rastin ishte caktuar prokurori ndërkombëtar që nga fillimi i hetimeve policore, por rasti asnjëherë nuk ka arritur para gjykatësit hetues, pasi që prokurori konsideroi se nuk kishte baza të mjaftueshme për kërkesën për fillimin e hetimeve. Shkaku kryesor për hüdhen poshtë të rastit ishin mospërputhjet në deklaratën e viktimës si dhe fakti se eventualisht ajo kishte shprehur dëshirën, së bashku me babain e saj, që të mos vazhdohet me hetime. Shqetësimet e SMSL shtrihen në tri anë. E para, rastet e abuzimit seksual hyjnë në ato që ndjekën sipas detyrës zyrtare, andaj vullneti i viktimës nuk ka kurrfarë ndikimi ligjor mbi ndjekjen e rastit. E dyta, ndjekja vuri në pah që nga fillimi i hetimeve të rastit, çështjen e imunitetit nga paraburgimi dhe ndjekja të cilën zyrtari e gëzonte sipas Rregullores së UNMIK-ut 2000/47. Hjekja e imunitetit nuk ishte lejuar dhe rasti është hüdher poshtë. E treta, hetimet e para të zhvilluara nga policia zbuluan disa aspekte, të cilat, megjithatë nuk ishin përcjellur thellësisht ndonëse ishin relevante për vazhdimin e rastit. Si viktimë ashtu edhe i dyshuari përmendën një person i cili ndihmoi në gjetjen e shtëpisë, sollë viktimën, “e bindi” atë të takohet intimisht me të dyshuarin, dhe dukej nga deklaratat e të dyshuarit se ky person nuk e kishte bërë këtë për herë të parë. Viktimë gjithashtu raportoi se ishte marrë nga shtëpia e saj me dhunë dhe ishte sjellur në at shtëpi. Sidoqoftë, ai person asnjëherë nuk ishte konsideruar si trafikues i mundshëm dhe madje asnjëherë nuk ishte marrë në pyetje nga policia. Zyrtari i policisë gjithashtu nuk ishte akuzuar me prokurimin e shërbimeve të të miturës mundshëm të trafikuar, siq parashihet me SEKSIONI n 4 të Rregullores 2001/04.

Në një rast të përcjellur nga SMSL në Prizren, një viktimë turke e Kosovës i raportoi policisë së UNMIK-ut në Rahovec, se ishte dhunuar dhe obliguar në prostitucion nga një burrë shqiptar i Kosovës, i quajtur N.C. Viktimë gjithashtu deklaroi se disa nga mushterinjët e saj ishin zyrtarë të policisë së UNMIK-ut të stacionuar në Rahovec dhe ajo qartë përmendi se jo vetëm që mund t’i identifikoj ata, por edhe tu tregoj hetuesve se ku gjindeshin banesat e tyre. Ky rast, së bashku me dy raste të tjera që kyqnin të njëjtin të dyshuar, ishin kualifikuar sipas Ligjit Penal të Jugosllavisë e jo sipas Rregullores 2001/04 dhe, pra, hynte nën kompetencën e Gjykatës Komunale në Rahovec, e jo në atë të Qarkut. Si pjesë e procedurës, policia e Rahovecit ishte ngarkuar për të kryer hetimet. Pasi që zyrtarët e policisë nga kjo komunë, siq raportohet, ishin të kyqur në aktivitetet penale, e tërë procedura krijoi një konflikt të dukshëm të interesit; por prap hetimet u zhvilluan me policinë në krye. Raportet e fundit policore mbi rastin indikuan se policia determinoi përmes hetimeve të tyre se viktimës i mungonte kredibiliteti dhe, si rezultat, ankesat e saj ishin suspenduar. Përderisa asaj mund t’i mungonte kredibiliteti, nuk është roli i policisë, e posaçërisht kur ata janë të implikuar në rastin penal, të bëjnë një determinim të tillë, i cili pengon përparimin e tërë rastit.

Nga informatat publike të dhëna në dispozicion nga policia e UNMIK-ut, SMSL është i njoftuar se disa zyrtarë policor ndërkombëtarë, u ballafaquan me masa dicitlinore për kyqjen në prostitucion dhe aktivitete të përafërta me të. Masa më e rëndë dicitlinore e

mundshme kundër zyrtarëve të tillë është riatdhesimi i tyre; hetimet penale ende nuk janë inicuar kundër tyre.

III. ZYRA E PROKURORIT PUBLIK

Çështjet substanciale

Shumë hetime apo gjykime përkitazi me trafikimin janë ndalur, pa dënim të të dyshuarit apo të pandehurit, për shkak të vendimit të prokurorit për hudhje poshtë të akuzave. Kurdo që SMSL është në dijeni se hjekja dorë nga ndjekja e rastit mvaret nga diskrecionin i prokurorit publik, siq parashihet në ligjin e aplikueshëm,¹⁰⁷ diskrecioni i tillë është i pakontrolluar dhe i pasfiduar, në situatën e tanishme në Kosovë, ndonëse mekanizmat për rishqyrtim janë të paraparë me ligj. Sipas ligjit vendor, puna e prokurorit publik mund të jetë subjekt i shqyrtimit të brendshëm, nga prokurori më i lartë publik, brenda strukturës së gjykatës së caktuar, përderisa prokurori Suprem ka autorizim për të mbikqyrë dhe bërë rekomandime mbi praktikën e zyrave të prokurorisë në tërë regjionin me fushëveprim të arritjes dhe tjemelimit të praktikës së njëjtë. Prokurori Publik i Kosovës sapo ka filluar një mbikqyrje dhe dokumentim të kufizuar të aktiviteteve të prokurorëve. SMSL është i shqetësuar që sistemi i tanishëm i diskrecionit është i hapur për abuzimin substancial. Kjo çështje mund të jetë e rëndësishme së veçantë në sistemet gjyqësore tranzitore siq është ai në Kosovë, ku pavarësia dhe paanshmëria e gjykatave mund të jetë nën ato çka pritet prej saj.

Monitorimi i SMSL indikon se prokurorët kanë hjekur dorë nga shumë raste të akuzave të raportuara të trafikimit, ose gjatë hetimeve ose gjatë gjykimit. Përkundër rregullores së re, rastet e trafikimit ishin shpeshherë të hetuara, të ndjekura dhe gjykuara nga gjykatat, si raste të profilit të ulët, me hetime të zhvilluara madje në Gjykatat Komunale. Kjo situatë ka bërë të mundur që shumë të dyshuar për trafikim të jenë të liruar apo shmangur përgjegjësisë penale përmes së procedurës së hjekjes dorë nga akuzat. Këto raste kaluan virtualisht të pavërejtura për publikun apo autoritetet që administrojnë sistemin gjyqësor, pasi që një vëmendje e vogël është kushtuar niveleve të ulëta të gjyqësisë.

Rregullorja e UNMIK-ut 2001/22 mbi masat kundër krimit të organizuar ofrojnë definicionin ligjor¹⁰⁸ të krimit të organizuar që përfshin trafikimin, pasi që sipas natyrës, trafikimi përfshinë një grup të njerëzve të definuar mirë dhe të strukturuar, i cili është formuar me qëllim të kryerjes së veprave penale (të dënueshme, sipas Rregullores 2001/4, me më tepër se 4 vite burgim). Andaj, në të ardhmen, rastet e trafikimit mund të shikohen si kërkuese të përgjegjes së fuqishme nga sistemi gjyqësor penal.

¹⁰⁷ Neni 51 i LPP RFJ thotë se prokurori publik mund të hjekë dorë nga ndjekja gjer në fund të seancës kryesore para gjykatës së shkallës së parë (...).

¹⁰⁸ Sekcioni 1 I Rregullores definon “krimin e organizuar” si kryerje të “krimit serioz” nga një grup i strukturuar me qëllim të fitimit, drejtëpërdrejtë apo në mënyrë indirekte, një beneficicion financiar apo material. Për më tepër, “krimi serioz” është definuar si sjellje që konstituon një vepër të dënueshme me maksimum të privimit të lirisë për më së paku katër vite.

Në një rast të ndjekur dhe gjykuar në Gjykatën e Qarkut në Prizren, një burrë shqipëtar i Kosovës ishte akuzuar për blerjen e një gruaje në Shqipëri dhe shitjen e saj të mëvonshme në një bar nate në Prizren. Përkundër dëshmimeve të viktimës, të një kolege e cila ishte dëshmitare e kidnapimit dhe të pronarit të barit i cili përkujtonte të pandehurin t'i kishte thënë mbi pasaportën e falsifikuar të cilën ia kishte dhënë viktimës dhe fjalosjen përkitazi me çmimin e viktimës, prokurori publik kërkoi hjekjen dorë nga akuza, gjatë gjykimit, për shkak të mungesës së provave kundër të akuzuarit. Kolegji e pranoi dorëhjekjen e tij nga akuza dhe si pasojë, rasti u mbyll.

Pas një kontrollimi të madh të organizuar nga KFOR-i dhe Policia e UNMIK-ut në Prizren në prill të vitit 2001, disa femra të huaja ishin gjetur në një bar nate. Kudo brenda barit ishin gjetur kondomet dhe njëri prej të dyshuarve ishte zënë në dhomën prapa barit me njërën nga viktimat; kjo e fundit ishte gjysmë e zhveshur. Pronari dhe disa bashkëpunëtorë të tij të raportuar ishin arrestuar dhe ishin dorëzuar prokurorit dhe gjykatësit hetues, që të dyve. Pas deklaratave “çfajësuese” të dhëna nga të dyshuarit (p.sh. “Ishte koincidence që unë –(i dyshuari)- isha duke rregulluar aparatën e akullit në dhomën e prapme dhe gruaja qëllon të jetë atje duke ndërruar rrobet e saj...”), prokurori publik propozoi të hedh poshtë akuzat për shkak të mungesës së provave. Disa nga viktimat në këtë rast, të cilat nuk ishin të siguruara me ndihmë dhe mbrojtje, në mënyrë radikale ndryshuan deklaratat e tyre në favor të të dyshuarve. Përderisa kjo mund të konsiderohet sjellje e dyshimtë që kërkon hetime të mëtutjeshme, asnjë nga zyrtarët gjyqësor nuk urdhëroi hetime të tjera të mëtejshme, përkitazi me rastin.

Si shembull të fundit, tre të dyshuar për vepra të raportuara të trafikimit ishin arrestuar dhe marrë në pyetje dy herë në Prishtinë në interval kohor prej tre muajsh. Çdo herë, prokurori publik kërkoi lirimin e tyre prej paraburgimit dhe suspendimin e hetimeve për shkak të mungesës së provave të mjaftueshme. Ishin disa femra të huaja, të cilat punonin në barin e të dyshuarit, e të cilat dëshmuuan para hetuesve të policisë se ato ishin trafikuar në Kosovë. Kur u sollën para gjykatësit hetues, ato ishin marrë në pyetje vetëm për disa minuta, pa sigurim të përkthimit adekuat, dhe ato deklaruan se aktualisht asnjëra prej tyre nuk ishte detyruar me forcë për prostitucion dhe se ato kan ardhur në Kosovë vullnetarisht. Menjëherë pas kësaj, pa hetime të thellësishme apo marrje detale në pyetje të femrave, prokurori publik erdhi në përfundim se nuk kishte prova të mjaftueshme për vazhdimin e hetimeve në këtë rast.

IV. GJYKATAT

Nga i tërë sistemi gjyqësor penal në Kosovë, SMSL në mënyrë parësore është fokusuar në sistemin e gjykatave, dhe ka indikuar në raportet paraprake, si shqetësimet ashtu edhe zhvillimet, përkitazi me aktivitetin e gjykatave. Pas dy vite përpjekjesh nga ana e UNMIK-ut për të ndërtuar dhe zhvilluar një sistem gjyqësor funksional, SMSL vlerëson se ky qëllim, të shumtën, është arritur. Sistemi i tanishëm është forcuar me mekanizmat e domosdoshme për të siguruar një menagjim të rrjedhës rasteve përderisa, në njërën anë, u garanton individëve procedurën e duhur dhe, në anën tjetër, mban anëtarët e gjyqësisë përgjegjës për punën e tyre.

SMSL ka vazhduar të observoj mangësitë procedurale në sistemin gjyqësor, të cilat mund të kenë ndikim negativ mbi të drejtat e palëve. Për më tepër, edhe më tepër vëmendje i ka

kushtuar aspekteve substanciale të aktivitetit të gjykatave, të cilat kanë pasoja serioze jo vetëm nga perspektiva e të drejtave të njeriut, por gjithashtu edhe për vet kredibilitetin e sistemit. Në Seksionin vijues, SMSL ndriqon shqetësimet e veta nga dy perspektivat e përmendura. Ndonëse duke iu referuar specifikisht rasteve të trafikimit, këto çështje përfaqësojnë praktikën dhe trendet, të cilat ishin monitoruar nga SMSL përgjatë sistemit të gjyqësisë penale.

Çështjet strukturale

Shpërndarja e Rregullores 2001/4

Një problem teknik, me ndikim të theksueshëm mbi gjykatat që kanë të bëjnë me rastet e trafikimit, ishte shpërndarja joadekuatë e Rregullores 2001/4. Pa tekstin aktual të ligjit në duart e tyre, shumë gjykatës e arsyetuan mungesën e veprimit të tyre për rastet e trafikimit apo qasjen e tyre të papërshtatshme këtyre rasteve, me faktin se atyre nuk iu është dorëzuar versioni i përkthyer rregullores. SMSL ka në dijeni rastet kur gjykatësit në Gjykatat e Qarkut apo në Gjykata Komunale kanë deklaruar se ata kurrë nuk kanë parë rregulloren e trafikimit dhe se nuk kanë dijeni për përmbajtjen dhe strukturën e saj. Nuk është e qartë se çfarë ka qenë distribuimi i Rregullores 2001/4, në fakt, pasi që vet OSBE i ka shpërndarë të njëjtat të disa gjykatës të disa gjykatave në tërë Kosovën, gjersa IJK organizoi një seminar trajnues për të njuftuar gjyqësinë me materjen e rregullores. Sidoqoftë, përgjegjësia zyrtare e distribuimit të rregulloreve të UNMIK-ut bie nën autoritetet administrative dhe ekzekutive dhe fakti se gjykatësit nga disa gjykata, pa marrë parasysh numrin, nuk e kanë marrë një pjesë të legjislacionit të rëndësishëm së veçantë nga të cilët pritet ta aplikojnë, paraqet një arsye brengosëse. Kjo pargullësi logjistike ka pasur një ndikim të theksueshëm, sidomos në rastet e kalimit ilegal të kufirit, të përdorur nga policia kundër femrave të huaja, të gjetura duke punuar nëpër bare dhe klube të natës.

Në rastet e katër femrave të huaja të paraburgosura në Gjilan, në qershor 2001, Gjykata për Kundërvajtje shqiptoi dënimet prej 15 deri 20 ditë burgim dhe urdhërat për deportim për periudhën prej dy vitesh, nën akuzat e kalimit ilegal të kufirit nga ish-RJM apo Serbia në Kosovë. Pas bisedimeve të bëra nga SMSL me gjykatësit nga Gjykata për Kundërvajtje në Gjilan, ata refuzuan argumentet e parashikuara në seksionin 8¹⁰⁹ të Rregullores 2001/4, me arsyetim se ata asnjëherë nuk kanë pranuar apo parë një rregullore të tillë.

Mangësitë administrative të sistemit, siq është mungesa e përkthimit të institucionalizuar dhe sistematik dhe pamjaftueshmëria e distribuimit të legjislacionit, nën përgjegjësinë e DAD dhe Zyres së Këshilltarit Juridik, është duke ndikuar shumë në administrimin e drejtësisë. Problemi është më tepër se “logjistik”, - është një dështim i organeve administrative/shtetërore për të siguruar gjykatësit me mjete të domosdoshme për sigurimin e të drejtave individuale dhe procedurë të duhur, si dhe përmbushjen e përgjegjësisë të tyre për të interpretuar ligjet dhe në mënyrë të duhur dhe korrekte të gjykojnë rastet në gjykatat e tyre.

¹⁰⁹ Teksti thotë se një person nuk është penalisht përgjegjës për prostitucion apo hyrje ilegale, punë apo prezencë në Kosovë nëse ai person siguron prova që mbështesin besimin e arsyeshëm se ajo është viktimë e trafikimit.

Mungesa e përkthimit/interpretimit adekuat

Siq është përmendur më parë në këtë raport, çështjet e përkthimit kishin ndikuar në punën e organeve të rendit dhe në masë të njëjtë por me pasoja më serioze, në punën e gjykatave gjithashtu.

Sa i përket rasteve të trafikimit, mënyra se si kryhet përkthimi gjatë procedurës gjyqësore është e rëndësishme kruciale pasi që shumica dërmuese e femrave të trafikuar janë të huaja të cilat të shumtën nuk e flasin asnjërin nga tri gjuhët zyrtare të përdorura në Kosovë (Angleze, Shqipe apo Serbe). Përkundër rekomandimeve të bëra nga SMSL, nuk është ndërmarrë asnjë veprim deri më tani në nivelin e DAD për të angazhuar përkthyes të pavarur dhe të kualifikuar, të aftë për kryerjen e përkthimit adekuat në dëgjimet gjyqësore. Derisa ligji i aplikueshëm¹¹⁰ indikon se kryetarët e gjykatave të qarkut duhet të mbajnë listën e përkthyesve të gjuhëve të huaja, SMSL vlerëson se në situatën e tanishme gjykatat nuk kanë kapacitet administrativ që pavarësisht të ndërmarrin veprime të tilla, sikurse është emërimi i përkthyesve mvarësisht nga nevojat e procedurës. Këto veprime mund të ndërmirren nga DAD apo nga gjykata me pajtimin specifik nga DAD. Nga aspekti i resurseve njerëzore, qështja nuk duhet të jetë aq e komplikuar pasi që sipas statistikave të IOM-it, 99% të femrave të trafikuar vijnë nga Moldavia, Rumania, Ukraina, Bullgaria, dhe Rusia. Si pasojë, përkthyesit nga Rusia dhe Rumania mund të mbulojnë gati të gjitha rastet e trafikimit në kuptim të përkthimit gjyqësor. Për më tepër, nuk do të ishte e domosdoshme për secilën gjykatë të kenë përkthyes për këto gjuhë.

Në vend të kësaj, DAD gjer më tani ka emëruar interpretët e gjuhës Serbe për këto raste, duke pritur që viktimat që flasin gjuhën Ruse të kuptojnë diçka nga procedura. Për viktimat të cilat nuk e flasin as Rusishten (të shumtën viktimat Rumune), gjykatat bazohen në viktimat Moldovase, të cilat zakonisht flasin gjuhën Rumune dhe Ruse, të përkthejnë për të tjerët atë çka kanë kuptuar nga përkthimi Serb.

Kjo praktikë shtron shqetësimin sepse dispozitat themelore të ligjit vendor të aplikueshëm, LPP RFJ, deklaron se të pandehurit kanë të drejtë të dijnë dhe kuptojnë akuzat kundër tyre,¹¹¹ se viktimat dhe të pandehurit kanë të drejtë në përkthim adekuat,¹¹² dhe se të gjithë personat të involvuar në procedurën penale kanë të drejtë në mbrojtje efektive.¹¹³ Për më tepër, dështimi i gjykatave dhe i shtetit që të siguroj se palët në procedurën penale të kuptojnë këto procedura, shkel të standardet mbi të drejtat elementare të njeriut të potencuara si në KEDNJ¹¹⁴ dhe KNDCP¹¹⁵. Komiteti mbi të

¹¹⁰ Neni 106 i Ligjit mbi Gjykatat e Rregullta dhe Neni 56/57 të Rregullave mbi Organizimin e Brendshëm të Gjykatave.

¹¹¹ Neni 4 thotë se gjatë dëgjimit të parë, i akuzuari duhet të informohet mbi akuzën kundër tij dhe bazat e asaj akuze.

¹¹² Neni 7(2) thotë se palët, dëshmitarët dhe personat e tjerë pjesëmarrës në procedurë kanë të drejtë të përdorin gjuhën e tyre gjatë rrjedhës së hetimeve apo procedurave tjera gjyqësore apo gjatë gjykimit.

¹¹³ Neni 11 thotë se i akuzuari ka të drejtë të prezentoj mbrojtjen e tij dhe se atij/asaj, i duhet dhënë kohë e mjaftueshme për ta përgatitur atë.

¹¹⁴ Neni 6(3) (e) i KEDNJ deklaron se çdonjëri i akuzuar për veprë penale ka të drejtë (...) të ketë ndihmën pa pagesë të interpretit nëse ai nuk mund ta kuptoj apo flas gjuhën e përdorur në gjykatë.

¹¹⁵ Neni 14 (3)(f) I KNDCP deklaron se (...) çdonjëri do të ketë të drejtë (...) të ketë ndihmën pa pagesë të interpretit nëse ai nuk mund ta kuptoj apo flas gjuhën e përdorur në gjykatë.

Drejtat e Njeriut shprehu në njërin nga Komentet e Përgjithshme¹¹⁶ se e drejta në përkthyes është një pjesë integrale e të drejtës për tu mbrojtur vet dhe e drejtë për kohë adekuate dhe lehtësira për të përgatitur mbrojtjen, duke i referuar rasteve të mosnjohjes së gjuhës së përdorur në gjykatë dhe vështirësive në kuptimin e saj. Duke i referuar jo vetëm ndihmës së interpretit por gjithashtu edhe kualitetit të interpretimit, Gjykata Evropiane ka theksuar në njërin prej vendimeve të saj¹¹⁷ se *në aspekt të nevojës për të drejtën e garantuar me alinenë 3(e) që të jetë praktike dhe efektive, obligimi i autoriteteve kompetente nuk është i kufizuar vetëm në emërimin e interpretit, por, nëse atyre u është tërhequr vërejtja në rrethana të veçanta, mund gjithashtu të zgjerohet në një shkallë të kontrollit të pasueshëm mbi adekuatshmërinë e interpretimit të ofruar.*

Skenari i përmendur më lart, seriozisht ka ndikuar mbi dëgjimet e mbajtura në Gjykatat për Kundërvajtje, në rastet e hyrjes ilegale apo qëndrimit në Kosovë. Pas kontrollimeve të zhvilluara në baret dhe klubet e ndryshme në Gjilan dhe Prishtinë, femrat e huaja ishin marrë dhe më pastaj shkurtimisht janë marrë në pyetje nga zyrtarët e NHTP. Të sjellura më vonë në Gjykatën për Kundërvajtje për dëgjime para gjykatësit hetues, femrat nuk ishin informuar se ku ishin dhe cilat ishin pasojat dhe qëllimi i dëgjimit. Për shkak të mungesës së përkthimit adekuat, femrat ishin dëgjuar nga gjykatësi hetues në grupe prej 3 deri 4 vetash në të njëjtën kohë në mënyrë që femrat që flisnin gjuhën Ruse mund të “kuptojnë” interpretimin Serb të ofruar nga gjykata dhe pastaj tu përkthejnë të tjerëve të cilët flisnin vetëm gjuhën Rumune. Në intervistat e ndara të zhvilluara nga SMSL me këto femra pas mbajtjes së dëgjimeve të tilla, disa nga ato than se ato madje nuk e kishin ditur se a ishin në gjykatë dhe se virtualisht nuk kishin kuptuar asgjë se çka ka ndodhur gjatë dëgjimit. Për më tepër, të gjitha këto femra muarrën vendimet gjyqësore në gjuhën Serbe, me të cilat ato dënoheshin për kalim ilegal të kufirit, dhe as për këto dokument nuk ishte siguruar përkthimi. Pas më tepër se një jave paraburgimi, disa nga këto femra ende kishin probleme për të kuptuar se pse ishin aty dhe se a do të deportoheshin apo jo, pasi të kenë vuajtur dënimin.

Në një rast trafikimi të hetuar në Prishtinë, disa viktimat të cilat donin të dëshmonin kundër trafikuesve të raportuar, ishin sjellur në gjykatë për tri ditë radhazi, pa u dëgjuar, për shkak të mungesës së përkthyesit Rus apo Rumun. U bënë disa ad-hoc zgjidhje jozyrtare, por gjykatësi nuk kërkoi zyrtarisht e as DAD nuk ofroi përkthyes të kualifikuar për këto dëgjime. Si zgjidhje e fundit, përkthimi ishte mundësuar nga bashkëshorti i viktimave që punonte në një organizatë ndërkombëtare në Kosovë.

Pa marrë parasysh kualitetin e përkthimit, përdorimi i përkthyesve të emëruar jo-zyrtarisht gjatë dëgjimeve gjyqësore, e bën tërë procedurën dhe veprimet e ndërmarra nga gjykata të zbehtë. Ligji i aplikueshëm në Kosovë përmban dispozita të numëruara¹¹⁸ që i referohen përdorimit të interpretëve të përhershëm gjyqësor dhe gjithashtu procedurave të angazhimit dhe vlerësimit të këtyre përkthyesve, që indikon që përkthimi zyrtar në gjykata duhet gjithmonë të ushtrohet nga një prej këtyre përkthyesve të përhershëm dhe të rekrutuar me rregull.

¹¹⁶ Komentet e Përgjithshme 13, Alinea 13, e adoptuar nga Komiteti për të Drejtat e Njeriut sipas Nenit 40, alinea 4 e KNDPCP.

¹¹⁷ Rasti *Kamasinski v. Austria* (19 Dhjetor 1989), GJEDNJ.

¹¹⁸ Neni 105 i Ligjit mbi Gjykatat e Rregullta; Neni 56-57 i Rregullave të Aktivitetit të Brendshëm të Gjykatave; Rregullorja mbi Provimin për Interpret të Përhershëm Gjyqësor.

Çështjet substanciale

Keqinterpretimi i Rregullores 2001/4 nga Gjykatat

Një parakusht për zgjidhjen efektive dhe adekuate të rasteve të trafikimit në nivelin e gjykatave është kuptimi korrekt i pjesës së gjyqësisë mbi fenomenin e trafikimit, dhe i legjislacionit të përforcuar për ta kontrolluar dhe reaguar në të. Në këtë drejtim, SMSL ka vërejtur se edhe kur gjykatësit ishin plotësisht të informuar mbi rregulloren dhe përmbajtjen e saj, ata kan indikuar një aftësi të varfër për ta interpretuar të njëjtën dhe moskuptim për qëllimin e saj.

Si shembull i parë, SMSL ka në dijeni rastin e trafikimit, të hetuar nga Gjykata Komunale në Kamenicë, në të cilën një serb i Kosovës ishte akuzuar sipas Rregullores 2001/4, pasi që siq raportohet kishte “rregulluar” për një viktimë serbe të Kosovës që të takohet me ushtarët e kampit të KFOR-it, jashtë Kamenicës. Ndonëse fillimisht gjykata filloi hetimet, sipas Seksionit 2 të Rregullores, e cila parasheh dënimin deri në njëzet vjet burgim, duke kaluar kompetencën në Gjykatën e Qarkut, më vonë krimi i raportuar ishte hetuar në pajtim me Seksionin 4, i cili parasheh dënimin gjer në pesë vite dhe si pasojë sjell kompetencën materiale të Gjykatës Komunale.

Interpretimi i dhënë nga gjykatësi hetues i Gjykatës Komunale në Kamenicë ishte se i dyshuari kishte prokuruar shërbimet e viktimës ndaj klientëve dhe Seksioni 4 i Rregullores 2001/4, i referohet rasteve të tilla të “prokurimit shërbimeve seksuale”. SMSL ka shprehur shqetësim në at kohë lidhur me interpretimin e tillë, pasi që nga leximi i Seksionit 4 të rregullores, ishte e dukshme se teksti aktualisht i referohej “klientëve” të shërbimeve seksuale e jo atyre që i mundësonin këto. Formulimi i tekstit ligjor është “çdo person i cili përdor apo prokuron shërbimet seksuale të një personi (...), pasi që fjala “prokuron” definon personat që prokurojnë shërbimet për vehten e jo për të tjerët. Keqinterpretimi ishte mbështetur edhe nga Prokurori Publik i Gjykatës së Qarkut në Gjilan. Sipas tij, i dyshuari nuk është dashur të akuzohet sipas Rregullores 2001/4 e veçanërisht jo sipas Seksionit 2 sepse “ai ishte vetëm ndërmjetësues” në mes të viktimës dhe klientëve. Ai i shpjegoi SMSL se sipas mendimit të tij, kjo situatë nuk bën pjesë në domenin e Rregullores 2001/4.

Shembull tjetër i keqinterpretimit të veprave të trafikimit është rasti i hetuar dhe gjykuar në Gjykatën e Qarkut në Prizren. I dyshuari në këtë rast ishte akuzuar për blerjen e një femre moldavase në një bar në Shqipëri, sjelljen e saj në Kosovë me pasaportë false shqipëtare, dhunimin e saj e pastaj shitjen në një tjetër bar në Prizren. Përkundër kualifikimit të dukshëm ligjor të fakteve të përmendura më lart sipas Rregullores 2001/4, prokurori i kualifikoi veprat si falsifikim të dokumenteve (Neni 203 i LPK) dhe dhunim (Neni 74 i LPK). Kualifikimi i tillë ligjor është mbajtur gjatë tërë gjykimit.

Në rastin e fundit të hetuar nga Gjykata e Qarkut në Mitrovicë, një polic i policisë ndërkombëtare të UNMIK-ut ishte arrestuar dhe akuzuar me dhunim dhe akte të panatyrshme seksuale. Gjykatësi ndërkombëtar hetues dhe prokuri ndërkombëtar e morën rastin. Faktet e marra nga raportet e policisë indikuan se viktima e mitur mund të kishte qenë viktime e trafikimit. Kishte gjithashtu indikacione se viktima kishte punuar si prostitutë përafërsisht dy vite dhe se i dyshuari kishte përdorur shërbimet e saj kohë pas kohe. Kishte poashtu indikacioni se i dyshuari kishte qenë në dijeni të faktit se e mitura ishte viktimë e trafikimit, pasi që ajo ishte rekrutuar dhe shfrytëzuar nga persona të caktuar për qëllime të eksploatimit seksual. I dyshuari e njihte trafikuesin dhe ai gjithnjë e

kontaktonte ate dhe e paguante kurdoherë që dëshironte të kidshte marrëdhënje seksuale me viktimën. SEKSIONI 4¹¹⁹ i Rregullores 2001/4 sanksionon personat që përdorin apo prokurojnë shërbimet e viktimave të trafikimit, por përkundër korrespondimit të dukshëm të veprimeve të raportuara të të dyshuarit me dispozitat e përmendura, prokurori ndërkombëtar nuk e mbështeti këtë kualifikim ligjor. Andaj, asnjë akuzë që rrjedh nga rregullorja nuk ishte ngritur. Në vend të kësaj, kërkesa për fillimin e hetimeve ishte bërë për veprat e raportuara të dhunimit dhe akteve të panatyrshme seksuale, të cilat, siq duket nuk mund ultimativisht të qëndrojnë me provat materiale. Andaj, i dyshuari ishte liruar pas 30 ditësh paraburgimi dhe ai menjëherë e lëshoi Kosovën.

Mungesa e mirëkuptimit të përgjithshëm të Rregullores 2001/4, ishte dokumentuar nga SMSL në Gjykatat për Kundërvajtje në tërë regjionin. Ndarazi nga parregullsitë e përmendura më parë në këtë raport, në rastet e femrave të huaja të gjykuara dhe dënuara për hyrje ilegale në Kosovë¹²⁰, SMSL vërejtë se të gjithë gjykatësit e involvuar kanë mohuar të drejtat e rezervuara për viktimat e trafikimit sipas Kaptinës III të Rregullores 2001/4.

Në disa nga këto raste të hyrjes ilegale, kryesit i shpjeguan gjykatësve se ato ishin përtej kufirit pa dijen e tyre apo pajtim, apo ato thjesht shpjeguan se ishin të trafikuar. Këto argumente duhet të ishin të mjaftueshme për të përjashtur përgjegjësinë penale këta kryes, pasi që Seksioni 8 i Rregullores ka bërë të qartë se personi nuk është penalisht përgjegjës për prostitucion apo hyje ilegale në Kosovë, nëse ai person ofron prova që mbështesin besimin e arsyeshëm se ai apo ajo janë viktimat e trafikimit. Megjithatë, arsyeshmëria e disa prej gjykatësve se ose nuk kishte rast korrespondues në Gjykatën e Qarkut që përcakton se femrat ishin viktimat e trafikimit, apo se rregullorja nuk ka vendosur një standard për provat që mund të përdoret për të vërtetuar statusin e viktimës. Ky argument përkitazi me mungesën e vendosjes së mëhershme në rastet e trafikimit që i përcakton viktimës statusin e kryesit të veprës së hyrjes ilegale nuk është në vijë me ligjin e aplikueshëm.¹²¹ Standardi i vendosur me Rregulloren 2001/4, i referohet besimit të arsyeshëm se personi ishte trafikuar. Përshtatshëmrisht, argumenti i bazuar mbi mungesën e një standardi provash për raste të tilla gjithashtu nuk mund të konsiderohet përdërisa prezenca e femrave të huaja të gjetura duke punuar në klubet e natës dhe, qartë kanë hyrë në Kosovë pa dokumentacion të duhur paraqet në vehte një bazë për dyshim e cila duhet t'i përcaktoj gjykatësit që më tej të hetoj dhe administroj provat për të vlerësuar se a ka patur ai/ajo besim të arsyeshëm se femra ishte e trafikuar.¹²²

Dënimet e shqiptuara kundër këtyre femrave në tërë këto raste, ishin të përcjellura me urdhërat për deportim. Këto urdhëra ilustrojnë natyrën kruciale të pasojave të keqinterpretimit apo mungesën e konsideratës për dispozitat e Rregullores 2001/4, pasi që

¹¹⁹ Çdo person që përdor apo prokuron shërbimet seksuale të një personi, duke ditur se ai person është viktimë e trafikimit me njerëz, kryen veprën penale dhe është përgjegjës (...). Alinea 2 e Sekcionit 4 përshkruan një denim më të rëndë për veprën nga alinea 1, nëse viktimat është e mitur.

¹²⁰ SMSL përcjelli 12 raste të tilla në GJKV në Gjilan, dhe 8 në GJKV në Prishtinë.

¹²¹ Neni 21.1 I LPP RFJ thotë se nëse aplikimi i ligjit penal mvaret nga vendosja e mëparshme mbi diosa çështje ligjore që shtrihen në kompetencë të gjykatës përkitazi me disa procedura tjera apo në kompetencë të ndonjë organi tjetër qeveritar, gjykata që gjykon rastin penal, mundet vet të vendosë në at drejtim, në pajtim me dispozitat që aplikohen për prezentimin e provave në procedurat penale. Vendosja penale mbi atë çështje ligjoreka efekt vetëm përkitazi me rastin penal të gjykuar nga ajo gjykatë.

¹²² Për më tepër, Neni 16 LPP RFJ deklaroi se e drejta e gjykatës për të vlerësuar ekzistimin apo mos-ekzistimin e fakteve nuk do të ndalohej apo kufizohet nga rregullat formale speciale të provave.

Seksioni 11 ndalon deportimin për viktimat e dyshuara të trafikimit. SMSL ka në dijeni, sidoqoftë, se urdhërat për deportim nuk mund të zbatohen nga policia në këtë fazë, çka do të thotë vetëm se femrat do të lirohen prap në Kosovë pasi që të vuajn dënimin.

SMSL është gjithashtu i shqetësuar se në disa raste të monitoruara nga SMSL, vendimet e gjykatësve të GJKV ishin bazuar në dispozitat ligjore të cilat nuk kishin aplikueshmërinë në rrethanat faktike të rastit.

Më 12 qershor, një grua moldavase ishte dënuar me 20 ditë burgim dhe deportim, nga Gjykata për Kundërvajtje në Gjilan, për kalimin ilegal të kufirit shtetëror në mes të Serbisë dhe Kosovës.¹²³ Referimi kësaj vepre nuk ka korrespondim gjegjësis me rrethanat aktuale në Kosovë, pasi që shenjimi në mes të teritorit Serb dhe Kosovës zyrtarisht nuk konsiderohet si kufi shtetëror por si kufi administrativ.

Më 26 qershor, Njësia Hetimore Regjionale e Policisë së UNMIK-ut në Gjilan, paraqiti ankesë kundër katër vendimeve të Gjykatës për Kundërvajtje, në të cilat akuzat për kalim ilegal, ishin hudhur poshtë. Policia në ankesat e tyre, pohoi se fakti që femrat në fjalë, nuk kishin vula në pasaportet e tyre, ishte provë e mjaftueshme për të treguar se ato kishin hyrë në Kosovë ilegalisht, nga Maqedonia. Sidoqoftë, SMSL është në dijeni se asnjë vulë nuk është nënë nga Policia kufitare e UNMIK-ut në kalimin kufitar në mes të Maqedonisë dhe Kosovës.

Gjykimi i rasteve të trafikimit nga gjykatat.

Krahas aspekteve të ndryshme strukturale dhe substanciale në aktivitetin e gjykatave, të përmendur më lart, të cilat kishin dhe ende pengojnë zhvillimin e rregullt të të rasteve të trafikimit, SMSL ka vërejtur një trend shqetësues në qasjen e disa gjykatësve, të cilët hetojnë apo gjykojnë raportimet serioze të trafikimit.

Qëllimi i SMSL është që të mos vrojtoj procesin e vendim-marrjes gjyqësore në kuptim të peshimit të provave dhe komentimit të votimit. Megjithatë ka situata ku të dyshuarit recidivist të trafikimit ishin trajtuar në mënyra që ilustrojnë mosrespektim ndaj seriozitetit të rasteve, nga ana e disa gjykatësve në Gjykatat e Qarkut.

SMSL është posaçërisht i shqetësuar me rastin e tre të dyshuarve shqiptarë të Kosovës, hetimet kundër të cilëve ishin zhvilluar në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë, për pohimet mbi përfshirjen e tyre në trafikimin në lidhje me një klub-nate. Gjatë një kontrollimi të zhvilluar në nëntor 2000, të dyshuarit ishin arrestuar dhe hetimet filluan sipas raportimit të ndërmjetësimin në ushtrimin e prostitucionit, sipas nenit 251 LP RFJ.¹²⁴ Hetimet i ishin caktuar gjykatësit hetues nga Gjykata e Qarkut në Prishtinë, i cili i dëgjoi të dyshuarit dhe vendosi t'i liroj të njëjtit dhe të pezulloj hetimet për shkak të mungesës së provave. Vetëm dy muaj më vonë, në shkurt 2001, NHPT kontrolloi të njëjtin bar përsëri dhe të tre të dyshuarit ishin arrestuar për arrestime të ngjashme për trafikim. Policia mori në pyetje disa nga viktimat e gjetura në bar dhe të gjitha ato konfirmuan se kishin qenë të trafikuar. Një gjykatës tjetër zhvilloi hetimet e dyta por ato përfunduan në të njëjtën

¹²³ Neni 71 aliea 1 e Ligjit mbi Kalimin Ilegal të Kufirit dhe Lëvizjes në Zonën Kufitare.

¹²⁴ (1) Çdonjëri që regruton, nxit, apo shtyen personat femror në prostitucion, apo çdonjëri që merr pjesë në çfarëdo mënyre për të drejtuar femrën tek tjetri për të ushtruar prostitucion, do të dënohet me burgim në kohëzgjatje më tepër se tre muaj por jo më tepër se pesë vite.

mënyrë sikurse të parat. Pas paraburgimit prej një muaji, dhe përkundër dhënjes së deklaratave të cilat ishin të papajtueshme me disa nga dokumentet në shkresat e lëndës, dhe me pjesët e deklaratave të tyre të mëparme, të dyshuarit ishin liruar përsëri për shkak të mungesës së provave të mjaftueshme. Gjykatësi dukej se nuk ishte i shqetësuar me mospajtueshmëritë radikale në mes të deklaratave të dhëna nga viktimat policisë dhe atyre të dhëna para tij. Përkundrazi nga informatat që SMSL pranoi nga zyrtari policor i cili përcjelli viktimat në gjykatë, marrja e tyre në pyetje zgjati vetëm për disa minuta dhe gjykatësi hetues nuk tregoi aspak iniciativë për të përcaktuar rrethanat e vërteta të këtij rasti.

Janë edhe shembuj tjerë të gjykatësve që tregojnë një qasje të rastësishme mbi rastet e trafikimit, ku ata injorojnë seriozitetin dhe pasojat e fenomenit dhe kriminalitetin në lidhje me të.

Në një rast tjetër të hetuar dhe gjykuar në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë, pesë të dyshuar serb të Kosovës ishin dënuar me dënime të ndryshme, prej dy deri tri vite e gjysmë burgim për ndërmjetësim në ushtrimin e prostitucionit dhe abuzim seksual dhe fizik të disa nga viktimat. Rasti është zgjidhur para kolegjit të gjykatësve dhe ndjekur nga prokurori publik ndërkombëtar. Përderisa nuk janë ngritur shqetësime të mëdha gjatë gjykimit, SMSL kuptoi se të pandehurit ishin liuar në pritje të vendimit mbi ankesën. Ligji i aplikueshëm¹²⁵ i lejon kolegjit mundësinë të shqyrtoj dhe vendosë se a duhet apo jo të lirohet i akuzuari, në pritje të ankesës, dhe bazë për një vlerësim të tillë duhet të jenë dispozitat e nenit 191 alinea (2), pikat 1, 3 apo 4 të LPP RFJ.¹²⁶ Ndonëse SMSL kupton dhe përkrah që paraburgimi para dënimit final duhet të jetë përjashtim e jo rregull, në këtë rast gjykata gjeti gjatë gjykimit se pesë të pandehurit kanë organizuar mirë një rrjetë-pune për trafikim dhe se kjo rrjetë ka degët e veta si në Kosovë ashtu edhe në Serbi. Rrjedhimisht, në bazë të dispozitave të nenit 191, SMSL beson se rreziku nga ikja për këta të pandehur të caktuar ishte dhe është i lartë. Në anën tjetër, dëshmitari kyq në këtë rast ishte njëra nga femrat e trafikuar (gjithashtu rëndë e abuzuar), dëshmimi i së cilës ishte prova më e fortë e ndjekjes. Me të pandehurit në arrati dhe me adresën e saj të bërë publike gjatë marrjes në pyetje në gjykatë, kjo viktimitë ishte vënë në pozitë të rrezikshme, dhe dukej se siguria e saj nuk ishte marrë në konsiderim kur kolegji vendosi t'i liroj të pandehurit.

Aktgjykimet me shkrim në këtë rast ende nuk u janë dorëzuar të pandehurve dhe policia nuk ka dijeni se ku gjenden disa nga pesë të pandehurit.

Rregullorja 2001/4 veqon në Seksionin e saj të 6-të se, gjatë hetimeve në rastin e trafikimit, gjykatësi hetues mund të urdhëroj konfiskimin e pasurisë të përdorur apo të fituar nga kryerja e veprës penale të trafikimit si dhe mbylljen e objekteve të dyshuar të jenë ta kyqura apo përbashkuara me veprat e tilla. Këto urdhëra mirren sipas propozimit të prokurorit publik.

¹²⁵ Sipas Neni 353 (2) LPP RFJ, në shpalljen e aktgjykimit që apelon për zbutje të dënimit me burgim (më pak se pesë vite), kolegji (...) do të ndërprejë paraburgimin nëse i akuzuari tashmë gjindet në paraburgim dhe arsyet për urdhërimin e paraburgimit nuk ekzistojnë, derisa alinea 2 do të aplikohet për urdhërimin e ndërprerjes së paraburgimit në mes-kohën kur aktgjykimi është shpallur dhe kur i njëti bëhet i plotëfuqishëm.

¹²⁶ Neni 191 alinea 2 (1,3) parasheh se paraburgimi do të urdhërohet nëse ekzistojnë baza për dyshim se i akuzuari mund të ikë (pika 1) apo, “nëse rrethanat e veqanta arsyetojnë frigën se krimi do të përsëritet apo se krimi i tentuar do të kryhet, apo krimi i kërcnuar do të kryhet” (pika 3).

Në një rast të fundit të trafikimit në Prizren, aktivitetet e raportuara të trafikimit ishin të lidhura ngusht me dy klube nate, të cilat më parë ishin kontrolluar nga policia në një numër rastesh për shkak të dyshimit të aktiviteteve penale të ngjashme. Për më tepër, dy hetimet paraprake të raportimeve të trafikimit ishin të lidhura me të dy klubet e njëjta. Por, gjykatësi hetues nuk urdhëroi mbylljen e këtyre klubeve, përkundër kërkesës formale të parashtruar nga prokurori publik ndërkombëtar i kyqur në rast. Si rezultat, klubet kanë vazhduar të funksionojnë, por nën udhëheqësinë tjetër.

Mënyra e rastësishme se si zgjidhen rastet e trafikimit nga gjykatat është reflektuar jo vetëm në punën substanciale të gjykatave, por gjithashtu edhe në detyrat e saj administrative. Gjykatat kanë mangësi administrative apo procedurale të cilat ndonjëherë kanë ndikim të theksueshëm në materjen e rastit.

Në një hetim të trafikimit, në kohët e fundit, të zhvilluar në Prizren, gjashtë shqiptarë të Kosovës ishin arrestuar për kyqjen e raportuar në aktivitetet penale, sipas dispozitave të Rregullores 2001/4. Tre të dyshuarit ishin arrestuar më 30 gusht 2001, dhe pas 24 orësh hetuesit policor i dorëzuan rastin Prokurorit Publik të Gjykatës së Qarkut për të përpiluar kërkesën për fillimin e hetimeve. Sidoqoftë, pasiqë shkresat e lëndës ishin dorëzuar të premtën pasdite, prokurori publik dështoi të paraqiste kërkesën pranë gjykatësit hetues, duke pohuar se kjo nuk kishte qenë e mundur pasiqë nëpunësit kishin shkuar. Për të njëjtën arsye, gjykatësi hetues nuk ka mundur të caktojë e as të mbajë dëgjimin të shtunen apo të dielen. Si pasojë, më 2 shtator 2001, në fund të limitit kohor prej 72 orësh të paraburgimit, që të tre të dyshuarit janë liruar nga paraburgimi.

SMSL konsideron shqetësuese situatën, kur të dyshuarit lirohen nga paraburgimi vetëm se nuk kishte pasur nëpunës gjykatë në dispozicion për të asistuar punën e prokurorit apo gjykatësit. Ky lloj arsyetimi gjithashtu ishte përdorur edhe në hetimet në Prishtinë kur gjykatësi i Gjykatës së Qarkut refuzoi të mbante dëgjimin gjatë vikendit sepse nuk kishte nëpunës gjykatë në dispozicion.

V. DHUNIMI DHE VEPRAT TJERA SEKSUALE

SMSL vazhdon të monitoroj rastet e dhunës seksuale dhe një kaptinë e tërë i është kushtuar kësaj teme në raportet paraprake të SMSL mbi sistemin e gjyqësisë penale. Fatkeqësisht, nuk ka patur ndonjë zhvillim substancial pozitiv që atëherë. Në vend të kësaj, çështjet e identifikuar në atë kohë si probleme kryesore në nivelin e policisë dhe gjykatave, ende dominojnë mbi qasjen e gjyqësisë veprave të dhunës seksuale dhe viktimave të saj.

Andaj, në këtë seksion nuk do të përsëriten shqetësimet e njëjta të bazuara në rastet e shembujve tjerë. Në këtë seksion, SMSL vë në pah se, problemet siq janë analizat e parregullta forenzike, mbledhja e varfër e provave gjatë fazave fillestare të hetimeve, sjellja që sygjeron një qëndrim të anshëm në një pjesë të anëtarëve të gjyqësisë kundrejt viktimave të dhunimit dhe mungesa e ndihmës për viktimat gjatë tërë procedurës penale, ende ekzistojnë. Përderisa në shumë lëmi të sistemit gjyqësor penal, janë dokumentuar zhvillime, shqetësimet përkritazi me këtë lëmi të dhunës seksuale ende nuk janë adresuar.

Analizat forenzike(mjeko-ligjore) në rastet e dhunës seksuale

SMSL vazhdon të ketë brengosje serioze përkitazi me zhvillimin e ekzaminimeve forenzike të viktimave të sulmit seksual dhe dhunës familjare, të cilat për momentin bëhen në Institutin për Mjekësinë Ligjore të Prishtinës. Mungesa e provave të duhura forenzike në rastet e dhunimit dhe veprave tjera të sulmit seksual, kushtëzon aftësinë e policisë dhe gjykatava për të hetuar dhe ndjekur rastet, duke ndikuar kështu drejtëpërdrejtë në mundësinë e viktimës për të fituar mbrojtje efektive ligjore.

Përveq kualitetit të dobët të raporteve mjeko-ligjore, SMSL është gjithashtu i shqetësuar me shembujt e ekzaminimeve forenzike të cilat, thjesht, nuk bëhen. Zakonisht, mjekët forenzik, janë të obliguar të punojnë prej orës 0800 deri 1700, prej të hënës deri të premten. Sidoqoftë, është bërë praktikë standarde për shumicën e mjekëve të Institutit Mjeko-Ligjor, të ndërprejnë punën në ora 1300. Si përgjigje shqetësimeve të theksuara nga OSBE, DAD dhe Policia e UNMIK-ut përkitazi me dështimin e Institutit për të ofruar me kohë ekzaminimet e viktimave të dhunimit dhe veprave të tjera të sulmeve seksuale, kishte vendosur në maj 2001, kujdestarinë e bazuar në “thirrje” jashtë orarit të rregullt të punës për të siguruar kontaktimin mjekët ligjor.

Megjithatë, sistemi i “thirrjes” nuk është efektiv gjë që ilustron me një numër rastesh me ç’rast mjekët ligjor kanë refuzuar t’i përgjigjen “thirrjeve” të policisë për të ekzaminuar viktimat. Si rezultat, hetimet dhe ndjekjet në rastet e dhunimeve ishin dëmtuar për shkak të paaftësisë së policisë për të fituar prova adekuate forenzike. Në të njëjtën kohë, gjendja psikologjike e viktimës, si dhe vullneti i viktimës për të bashkëpunuar me policinë në vazhdimin e ndjekjes, padyshim është influencuar nga indiferenca e treguar nga mjekët ligjor gjatë ekspozimit të saj fillestar në procedurën hetimore dhe gjyqësore. Më 9 korrik 2001, në një memorandum të adresuar në Gjykatën Supreme, të Qarkut dhe Komunale, DAD, Policinë e UNMIK-ut dhe OSBE-në, Instituti i Mjekësisë Ligjore deklaroi se ekzaminimi i viktimave të dhunimit duhet të bëhet “brenda 24 orësh”, dhe se “njëri nga ekspertët forenzik duhet gjithmonë të jetë në dispozicion për të bërë këtë lloj ekzaminimi”. Sidoqoftë, përkundër këtij veprimi eksplicit, mjekët ligjor vazhdojnë të refuzojnë për të bashkëpunuar në ekzaminimin e viktimave të dhunimit.

Në tri raste (25 mars, 5 prill dhe 6 korrik 2001) Skuadra Regjionale për Krime Serioze (SRKS), përcjelli ankueset e dhunimit në Institutin Mjeko-Ligjor për të kërkuar ekzaminimin forenzik. Në të gjitha këto instanca mjeku “i thirrjeve” (kujdestar) nuk ishte prezent apo i arritshëm, dhe madje kur ishte i arritshëm, ai refuzoi të bënte vlerësimin. Si pasojë, nuk u bë ekzaminimi forenzik.

Më 10 korrik 2001, në ora 0930, policia e UNMIK-ut përcjelli një ankuese për dhunim në Institutin Mjeko-Ligjor në Prishtinë. Mjekët ligjor ishin në mbledhje. Ata ishin informuar për prezencën e viktimës por nuk e ndërprejnë mbledhjen për ta shikuar. Viktima, andaj, ishte shtyrë të pres 90 minuta para se të ekzaminohet. Ekzaminimi, kur më në fund u bë, zgjati jo më shumë se 5 minuta. Mjeku ekzaminues, në përfundimin e ekzaminimit, siq raportohet, i deklaroi policisë se ajo nuk ishte e dhunuar dhe andaj nuk ka arsye për të shkruar raport. Pas një kontesti në mes të policisë dhe patologut forenzik, ky i fundit u pajtua të shkruante raport.

Më 22 gusht 2001, pasi që i ishte refuzuar trajtimi nga Departamenti i Gjinekologjisë në Spitalin e Prishtinës, një ankuese e dhunimit ishte sjellur në Institutin Forenzik nga Policia e UNMIK-ut. Mjeku ishte jo-kooperativ dhe pa bërë asnjë lloj ekzaminimi, urdhëroi që viktima të pranohet në Klinikën Neuro-Psikiatrike në Prishtinë. Zyrtarët e Policisë kërkuan të bisedojnë me mjekun e Njësisë Forenzike në detyrë, i cili pasi arriti, refuzoi të asistoj në çfarëdo mënyre. Viktima nuk ishte ekzaminuar si duhet gjer më 27 gusht, deri në cilën kohë, vlera e provës forenzike e fituar ishte bërë minimale.

OSBE momentalisht është e involvuar në projektin e ndërtimit të kapaciteteve të institutit forenzik. Ky projekt pretendon të promovoj zhvillimin e procedurave të ekzaminimit efektiv të sulmeve seksuale, të cilat janë në pajtim me standardet ndërkombëtare dhe normat. Mirëmbajtja e këtyre normave mvaret nga zhvillimi afatgjatë i integritetit personal dhe profesional të mjekëve ligjor që punojnë në institut. Sidoqoftë, ajo gjithashtu mvaret nga themelimi i një kontrole efektive interne dhe mekanizmeve disiplinare për të adresuar dështimin e vazhduar për sigurimin e shërbimit të duhur dhe efektiv forenzik.

Sjellja që sygjeron qëndrimin anues në gjyqësi dhe mungesa e ndihmës për viktimat

Përderisa qështja e analizave të parregullta forenzike dhe mbledhja e provave e ka gjithashtu edhe dimenzionin logjistik, ndërsa mangësitë mund të shtohen edhe nga infrastruktura e pasigurtë dhe burimet e hetuesve policor dhe ekipeve forenzike - qëndrimi anues i disa nga gjykatësit dhe prokurorët kundrejt viktimave të dhunës seksuale si dhe mungesa e ndihmës viktimave, janë qartë aspekte substanciale të mënyrës në të cilën sistemi i gjyqësisë administrohet tani në Kosovë.

Sjellja që sygjeron anshmërinë kundër viktimave të veprave seksuale në të gjitha nivelet e gjyqësisë ishte identifikuar edhe më parë, por përmirësime të theksueshme nuk janë identifikuar. Në vend të kësaj, SMSL ka observuar se viktimat e dhunës seksuale ende mund të ballafaqohen me ironinë, sarkazmin apo mungesë konsiderate nga pjesa e prokurorëve, mbrojtësve apo gjykatësve. Gjykimet e dhunimit të shumtën mbesin të shenjara me vërejtje ironike se si ishte ndjerë viktima gjatë marëdhënjes seksuale, në çfarë “pozite” ishte dhunuar ajo, sa shumë kishte bërë etj. Në disa raste, mendimet e paragjykuara mbi rastet e dhunimit ishin haptazi të shprehura gjatë dëgjimeve gjyqësore ose nga gjykatësit e kolegjit ose nga palët. Shpesh duket se dhunimet ende konsiderohen si raste të fabrikuara, të cilat viktimat i përdorin për të arritur gjer te martesë. Paragjykim tjetër shpesh i ilustruar përmes ndjekjes së këtyre rasteve është se për aq sa virgjiniteti i viktimës ishte prekur në kohën e abuzimit seksual, atëherë fajësia e të pandehurit është më e lehtë dhe ndonjëherë madje kjo edhe falet. Gati në të gjitha rastet e dhunimit të monitoruara nga SMSL, gjykatësit e kanë pyetur viktimën se a kishte qenë virgjine në kohën e dhunimit, se a kishte patur ajo dashnorë dhe nëse po, atëherë sa prej tyre.

Një nga shembujt më shqetësues, ishte reagimi i gjykatësit në Prishtinë, i cili pas kërkesës së viktimës së dhunimit se hjek dorë nga akuzat kundër të pandehurve, bërtiti në gjykatën e hapur: “E kam ditur që nga fillimi se ky nuk ishte dhunim!” Një reagim i tillë indikon se gjykatësi ka udhëhequr rastin me ide të paragjykuar se raportimet e viktimës nuk ishin të vërteta dhe se ishte vetëm çështje kohe se kur do ta pranonte ajo këtë.

Përpjekje më të mëdha duhet të bëhen për të ndryshuar këtë mentalitet, madje edhe nëse kjo do të thotë inicim i veprimeve disiplinore. Krijimi i NJIGJ brenda DAD mundet, gjithashtu, me vlerësimin dhe hetimin e sjelljes së gjykatësve dhe prokurorëve, tu ofroj këtyre të fundit shtytje për përmirësimin vullnetar të qëndrimeve të tyre përmes vetëdisciplinës. Nëse vetëdisciplina nuk funksionon, duhet të ndërmerren hetime të shpejta dhe veprime disiplinore. Sidoqoftë, kjo mbetet të shihet.

Koncepti i ndihmës viktimave ishte rekomanduar nga SMSL në raportet e mëparshme. Në këtë moment, implementimi i menjëhershëm i qasjes strukturale ndaj kësaj çështjeje është përgjigje e duhur dhe urgjentisht e nevojshme. Si një program fillestar për të ofruar një asistencë të tillë, OSBE ka identifikuar dhe trajnuar gjatë gjashtë muajve të kaluar, nga një mbrojtës ligjor në secilin regjion, nga të cilët është pritur të përfaqësojnë viktimat e trafikimit kurdoherë që është lajmëruar nevoja për të. Ky zhvillim i programit për mbrojtësit e viktimave dhe të drejtën e viktimës për të pasur mbrojtësin për të përfaqësuar interesat e tyre, duhet të pranohet dhe respektohet nga gjyqësia dhe sistemi gjyqësor penal në përgjithësi.

SMSL ka njohuri për një rast të dëgjimit hetimor kohëve të fundit, i cili u mbajt para gjykatësit ndërkombëtar në një rast senzitiv të abuzimit seksual të viktimës së mitur. Për shkak të moshës së viktimës dhe senzitivitetit të rastit, theks i veçantë është vënë në mbrojtjen e viktimës dhe gjithashtu në sigurimin e përkrahjes psikologjike dhe morale për të. Bazuar në konkluzionet e vlerësimit psikiatrik, duke theksuar nevojën për të mos ekspozuar viktimën personave të njohur, gjykatësi hetues vendosi të kufizoj qasjen e dëgjimit ndaj prokurorit, mbrojtësit të të dyshuarit dhe përkthyesit, andaj edhe prezencën e mbrojtësit të viktimës. Derisa vendimi mbi qësjen e kufizuar ishte marrë nga gjykatësi me qëllim të interesit më të mirë për të miturën, nuk ka baza ligjore për një mohim të tillë. Mbrojtësi i sygjeruar prezent ishte trajnuar nga OSBE në çështjet e viktimave të trafikimit, dhe gjithashtu i ishte dhënë autorizimi me shkrim nga viktimat për dëgjim. Për më tepër, prokurori ndërkombëtar prezent në dëgjim propozoi që mbrojtësi duhet të lejohet të marrë pjesë. Rrethanat e këtij rasti e bënë mohimin disi të kuptueshëm, posaçërisht duke marrë parasysh se nuk kishte kohë në disponim për mbrojtësin dhe viktimën, që të mësoheshin me njëri me tjetrin, sidoqoftë, SMSL është i brengosur se vendimi i gjykatësit hetues mund të krijoj një precedencë kontradiktore.

Ekspanzioni i projektit fillestar për mbrojtësit e viktimave për viktimat e trafikimit për të përfshirë edhe viktimat e dhunës seksuale përfaqëson hapin e ardhshëm të domosdoshëm për përforcimin e mbrojtjes dhe promovimin e të drejtave të viktimës në procedurat penale, dhe andaj, duhet të përkrahet implementimi i tij.

VI. REKOMANDIMET

- Duhet të adoptohen zgjidhje të menjëhershme nga DAD për të siguruar qasjen e lirë të përkthyesve të pavarur dhe të kualifikuar. Për rastet kur viktimat e dyshuara të trafikimit janë të përfshiera ose si dëshmitarë ose si kryes të raportuar (rastet e kalimit ilegal të kufirit, prezenca ilegale në Kosovë apo posedimi të dokumenteve false), OSBE rekomandon që të punësohet një njësi e përkthyesve Rus apo Rumun dhe të

përdoret kurdo dhe kudo që ka nevojë. Njësia e përkthyesve duhet të ketë bazën në DAD dhe pastaj të shpërndahen në gjykatat e ndryshme në tërë Kosovën, mvarësisht se ku paraqiten rastet e trafikimit. Asistimi i përkthyesve nuk duhet të kufizohet në secilën intervistë apo deklaratë të dhënë hetuesve të policisë, konfrontimin me dokumentet me shkrim, dhe të gjitha procedurat gjyqësore.

- SMSL rekomandon që UNMIK-u dhe KFOR-i të adoptoj një përgjegje më të fuqishme për involvimin e personelit të tyre në aktivitetet e trafikimit. Masat interne disiplinore nuk janë të mjaftueshme, përderisa Rregullorja 2001/4 specifikisht sanksionon përdoruesit e shërbimeve të viktimave të trafikimit. Përmes procesit transparent të kërkesës për hjekjen e imunitetit, personeli ndërkombëtar gjithashtu duhet t'i nënshtrohet ndjekjes penale kur të konsiderohet apo vërtetohet të jenë të përfshier në aktivitetet penale të trafikimit. Ashtu siq theksohet në Raportin Special të Ombudspersonit Nr. 2, muniteti nga paraburgimi dhe ndjekja nuk duhet të konsiderohet nga personeli ndërkombëtar që punon në Kosovë si një mburojë për aktivitetet e kundërligjshme të çfarëdo lloji.
- Trajnime përmbajtësore dhe fushata të rritjes së vetëdijësimit duhet drejtuar gjyqësisë, si për fenomenin e trafikimit nga perspektiva sociale dhe sociologjike, ashtu edhe mbi legjislacionin e trafikimit nga perspektiva ligjore. Trajnimet e mëparshme mbi çështjet më të përgjithësuara mbi rregulloren e anti-trafikimit u vërtetuan të jenë të pamjaftueshme. Andaj, një trajnim thellësisht i specializuar dhe tryezat e rrumbullakëta duhet të mundësohen nga IJK mbi dispozitat specifike të legjislacionit të cilat, në praktikën e gjykatave, duket të jenë më pak të kuptueshme. Si shembuj konkret në lidhje me çështjet e trafikimit, SMSL rekomandon trajnimin e menjëhershëm të gjykatësve dhe prokurorëve mbi çështjet siq janë: shpjegimi i definicionit ligjor të “trafikuesit”, “viktims”, dhe “përdoruesit të shërbimeve të viktimës”, me theks në kriteret të cilat duhet zbatuar me rastin e cilësimit të këtyre aktiviteteve; ndriqimi i statusit të viktimave të trafikimit sipas Rregullores 2001/4, me theksim në imunitetin nga ndjekja që këto viktima kanë në raport me veprat penale të kryera derisa ishin të trafikuar; domeni dhe pasojat e mosaplikimit të rregullave të konfiskimit të pasurisë dhe mbylljes së objekteve (Seksioni 6 i Rregullores 2001/4).
- SMSL rekomandon krijimin e një njësie të specializuar policore, të ngjashme me NHPT, e cila duhet të fokusohet mbi rastet e abuzimit seksual dhe të fëmijëve dhe dhunën familjare. Një njësi e tillë, me kapacitete të drejtuara vetëm në këto çështje, do të forcoj koordinimin dhe përgjegjen efektive, në lëmitë ku përgjegjësitë janë të fragmentuara. Njësia duhet të ketë kontakt të drejtëpërdrejtë dhe të vazhdueshëm me ekipet forenzike dhe institutin mjekësor forenzik për të siguruar mbledhjen e shpejtë dhe efektive të provave. Për më tepër, ajo duhet të themeloj raporte pune me agjensitë e kyqura në mbrojtjen e viktimave dhe përkrahjen e viktimave me qëllim të koordinimit të përpjekjeve për një mbrojtje të fuqishme të tyre.
- SMSL rekomandon emërimin e menjëhershëm nga PSSP, të Koordinatorit për Ndihmën e Viktimave, përgjegjës për ndërlidhje me të gjitha autoritetet relevante në përpjekjet e sjelljes së një strategjie të harmonizuar si përgjegje ndaj nevojës së theksuar për asistimin dhe mbrojtjen e viktimave të trafikimit.
- SMSL fuqishëm përkrah njohjen legjislative të konceptit të mbrojtjes së viktimës, që nënkupton se viktimat e veprave të dhunës seksuale duhet të kenë përkrahje të menjëhershme dhe të vazhdueshme ligjore, gjatë tërë procedurës penale.

SEKSIONI 6: GJYKATAT KOMUNALE DHE GJYKATAT PËR KUNDËRVAJTJE

I. HYRJE

Për shkak të mungesës së resurseve dhe domosdoshmërisë për të caktuar prioritetet, aktivitetet e Gjykatave Komunale (GJK) dhe Gjykatave për Kundërvajtje (GJKV) ishin monitoruar nga SMSL, vetëm në bazën ad hoc dhe kryesisht në rastet përkitazi me të miturit, viktimat e dyshuara të trafikimit apo dhunës familjare. Si pasojë, SMSL deri më tani nuk ka raportuar gjërësisht dhe sistematikisht mbi aktivitetet e këtyre gjykatave, e aq ma pak ka qenë e njoftuar mbi funksionimin e Gjykatave për Kundërvajtje. Ndonëse shqetësimet e ngjashme të shkeljeve të mundshme të standardeve për të drejtat e njeriut burojnë nga aktivitetet e këtyre gjykatave më të ulta sikurse dhe nga Gjykatat e Qarkut, shumë pak vëmendje ndërkombëtare është përqëndruar në to. Përderisa, në nivelin e gjykatave të qarkut, ekzistojnë zyrtarë ligjor ndërkombëtar të emëruar përbrenda DAD për të lehtësuar punën e gjykatësve ndërkombëtar në nivelin administrativ, të cilët në mënyrë inhereente kanë një njohuri të thellë për secilin rast, nuk ka ndonjë funksion të tillë gjegjësisht për gjykatat komunale apo ato për kundërvajtje. Ndonëse SMSL nuk imponon që gjykatësit apo prokurorët ndërkombëtarë duhet të inkuadrohen në zgjidhjen e rasteve të paraqitura në këtë instancë, DAD duhet të fokusoj më tepër vëmendjen në problemet me të cilat ballafaqohen këto gjykata, si ato logjistike ashtu edhe substanciale.

II. GJYKATAT KOMUNALE

Kompetenca e Gjykatave Komunale

Tani për tani, janë 24 gjykata komunale të themeluara në Kosovë, por të gjitha nuk janë funksionale. Gjykatat komunale janë të vendosura në pesë regjione, sipas ndarjes teritoriale dhe administrative. Gjykatat komunale në Kosovë kanë të bëjnë me numër të madh të rasteve të kriminalitetit të ulët, andaj ato kanë rolin kyq në administrimin e drejtësisë në rastet penale, pra në mënyrë indirekte në preventimin e krimit.

Sipas Ligjit mbi Gjykatat e Rregullta, gjykatat komunale janë kompetente për të gjykuar të gjitha rastet penale ku gjykatësi i vetëm është kompetent për të gjykuar, si dhe për veprat penale ku dënimi është gjobitja apo burgimi deri në pesë vjet.¹²⁷ Në fazën fillestare të procedurës penale, gjykatat komunale mund të ndërmarrin veprim të menjëhershëm përkitazi me veprat penale të kryera mbrenda jurisdikcionit teritorial të gjykatës, nëse ekziston rreziku që gjykatësi hetues i gjykatës kompetente të qarkut nuk do të jetë në gjendje të veprojë në kohë të duhur.¹²⁸ Në lëmin e të drejtës civile, gjykatat komunale kanë

¹²⁷ Neni 26 (1) Ligji mbi Gjykatat e Rregullta.

¹²⁸ Neni 26 (4) Ligji mbi Gjykatat e Rregullta.

një jurisdikcion të gjërë, pasiqë mbulojnë të gjitha llojet e rasteve civile me përjashtim të rasteve të shkurorëzimit, të cilat gjykohen në gjykatat e qarkut.¹²⁹

Shtrirja e rasteve

Siq u përmend më lart, gjykatat komunale mbulojnë një spektër të gjërë të rasteve, përfshirë edhe llojet e rasteve që gjithashtu gjykohen në nivelin e gjykatave të qarkut. Për shembull, rastet e dhunës familjare, rastet e të miturve, rastet e sulmit, rastet e armëmbajtjes pa leje. Tabela vijuese tregon llojllojshmërinë e rasteve të gjykuara nga gjykatat komunale gjatë periudhës raportuese janar-qershor 2001.¹³⁰

Lloji i rastit	Numri i përgjithshëm i rasteve në procedurë	Rastet e përfunduara	Rastet në pritje	Rastet e transferuara
Hetimet	3614	1152	2457	5
Ankesat në het.	205	202	1	2
Rastet penale	13764	2996	10285	483
Rastet civile	16217	2290	13875	52
Rastet e të miturve	1141	290	837	12
Regjistrat tokësore	48	48	0	0
Ekzekutimet	5313	810	4472	1
Trashëgimore	2519	973	1545	1
Procedura jo-kontestimore	2678	806	1872	
Rastet tjera ¹³¹	41068	40546	522	
Urdhërpagesat	144	41	100	3
Gjithësejt	86708	50154	35966	561

Sasia e punës (normës) e gjykatësve në Gjykata Komunale

Gjatë periudhës janar-mars 2001, gjykatat komunale kanë proceduar 39.014 raste. Nga këto 19.553 raste apo 54.3% ishin përfunduar. Nga rastet e papërfunduara 0.2% apo 90 raste ishin transferuar tek organet tjera kompetente.

Numri i lëndëve për gjykatës (janar-mars 2001)

Statistikat vijuese tregojnë mesataren e normës për gjykatës në secilin regjion. Siq shihet nga tabela e poshtme, ekzistojnë mospërputhje në mes të numrit të lëndëve të punuara

¹²⁹ Neni 26 (6,7,10,11) të Ligjit mbi Gjykatat e Rregullta.

¹³⁰ Informatat janë të bazuara në informacionet statistikore në disponim të DAD.

¹³¹ Këto raste përfshijnë vërtetimin e kontratave, vërtetimin e nënshkrimeve dhe dorëshkrimeve, intambulimet dhe ekzekutimin e sanksioneve penale të dhëna nga gjykata.

nga gjykatësit në regjionet e ndryshme. Njëri shpjegim është se numri i gjykatësve gjithashtu ndryshon dukshëm prej gjykate në gjykatë, dhe ky numër nuk është gjithmonë në pajtim me normën e secilës gjykatë. Andaj, ka situata kur gjykatat vetëm me disa gjykatës, kanë të bëjnë me një ngarkesë pune të madhe, përderisa gjykatat me një numër të madh gjykatësish kanë ngarkesë pune më të vogël. SMSL rekomandon që emërimi i gjykatësve në Gjykatat Komunale të revidohet në pajtim me mesataren e normës së dokumentuar në secilën gjykatë në dy vitet e fundit.

Kaçanik – 270 lëndë
 Prizren – 78 lëndë
 Pejë – 68 lëndë
 Suharekë – 66 lëndë
 Gjilan – 66 lëndë
 Malishevë – 62 lëndë
 Klinë – 58 lëndë
 Prishtinë – 55 lëndë
 Ferizaj – 55 lëndë
 Kamenicë – 53 lëndë

Nën mesatare

Deçan – 14 lëndë
 Podujevë – 21 lëndë
 Skenderaj – 21 lëndë
 Dragash – 24 lëndë
 Glllogovc – 26 lëndë
 Rahovec – 31 lëndë
 Vushtrri – 32 lëndë
 Mitrovicë – 37 lëndë
 Lipjan – 42 lëndë
 Gjakovë – 43 lëndë

Statistikat mbi lëndët e përfunduara penale (janar – gusht 2001)

Tabela vijuese tregon lëndët penale të cilat ishin përfunduar nga gjykatat komunale në të gjitha regjionet. Statistikat janë të bazuara në informatat të pranuar nga DAD. Gjykatat komunale në komunat veriore të Mitrovicës, Leposaviqi dhe Zubin Potoku, nuk funksionojnë sipas sitemit gjyqësor të UNMIK-ut. Sidoqoftë, për to dihet se funksionojnë si pjesë e sitemit paralel gjyqësor nën qeverisjen Serbe.

Gjykatat Komunale	Gjithësejt lëndë në proces	Lëndët e përfunduara gjatë periudhës raportuese	Lëndët e papërfunduara	Rastet e transferuara
Gjilan	917	185	732	
Kamenicë	393	160	232	2
Viti	308	71	237	

Prizren	3786	622	3174	7
Dragash	77	26	51	
Malishevë	380	126	254	
Rahovec	542	111	431	
Suharekë	787	186	601	
Pejë	440	210	218	12
Deçan	151	73	75	3
Gjakovë	470	167	303	
Istog	154	70	83	1
Klinë	212	83	125	4
Prishtina	2618	287	1903	428
Ferizaj	1420	394	1026	
Glllogovc	135	75	53	7
Kaçanik	786	26	760	
Lipjan	216	124	91	1
Podujevë	182	88	94	
Mitrovicë	473	180	293	
Skenderaj	216	127	72	17
Vushtrri	120	40	79	1
Leposaviq	-	-	-	
Zubin Potok	-	-	-	

Administrimi i gjyqësisë dhe parregullësitë procedurale

SMSL ka zgjëruar monitorimin e saj që nga Korriku 2001 për të siguruar SMSL me një sfond të domosdoshëm për identifikimin e praktikave të caktuara përbrenda këtyre gjykatave. Këto praktika janë marrë në konsiderim vetëm kur SMSL ka gjetur ose shkelje të ligjit ndërkombëtar për të drejtat e njeriut, ose mangësi administrative me efekt direkt në të drejtat e individit për një procedurë të duhur. Në përgjithësi, mund të theksohet se shqetësimet e identifikuar në Gjykatat Komunale janë shumë të ngjashme me ato të numëruara gjatë monitorimit të rasteve në Gjykatat e Qarkut.

Shpërndarja jo-komplete e rregulloreve të reja të UNMIK-ut

Sikurse në nivelin e gjykatave të qarkut, SMSL ka vërejtur se gjykatësit e gjykatave komunale shpeshherë raportojnë se atyre nuk u mundësohet me kohë qasja në legjislacionin e ri, të cilin duhet ta aplikojnë. Më tej, SMSL ka përshtypjen se distribuimi në nivelin komunal len madje më tepër hapësirë për përmirësim se sa ai në nivelin e gjykatave të qarkut. Ende është e paqartë se cila njësi përbrenda DAD është e obliguar të bëjë distribuimin e rregulloreve të reja në gjykata dhe, ndonëse SMSL është përpjekur të identifikoj këtë njësi, secili hulumtim i bërë njësiteve të ndryshme ka patur të njëjtin rezultat. Asnjëri nga personat e kontaktuar nuk ishte në gjendje të sqaroj së pari se a ekziston një shqyrtim statistikor se cilat rregullore janë përkthyer dhe shpërndarë në cilat

gjykata, dhe së dyti, cila njësi është drejtëpërdrejtë përgjegjëse për këto çështje. Gjatë këtij hulumtimi, SMSL i ishte referuar njësiteve të ndryshme përbrenda DAD, përfshirë edhe Njësitin e Shërbimit të Prokurorisë dhe Administrimit të Gjykatave.

Përkthimet joadekuate

Përkthimet joadekuate në rastet që përfshiejnë jo-shqiptarët mbeten një problem i madh përgjatë tërë sistemit gjyqësor penal. Që nga themelimi i UNMIK-ut, nevoja për përkthyes gjyqësor profesional është rritur në mënyrë rapide. SMSL ka vazhduar të monitoroj gjykimet në të gjitha nivelet ku nuk është ofruar përkthimi adekuat për të pandehurit. Gjithashtu është potencuar se dosjet e lëndëve nuk u janë vënë në dispozicion në gjuhën të cilën i pandehuri e kupton, duke shkelur kështu të drejtën themelore të mbrojtjes.

Në rastin e dy të pandehurve rus, të akuzuar për sulm kundër personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrës në Gjykatën Komunale në Prishtinë, përkthimi ishte kryer nga një ish profesor i gjuhës ruse, i cili nuk ishte emëruar zyrtarisht si përkthyes. Kur profesori nuk mirrte pjesë në një pjesë të seancës, përkthimi vazhdohej nga përkthyesi serb i gjykatës, të cilin të pandehurit e kuptonin vetëm pjesërisht. Madje edhe kur përkthimi bëhej në gjuhën ruse, vetëm disa pjesë të procedurës ishin përkthyer dhe ndonjëherë pyetjet e bëra të pandehurve nuk ishin përkthyer si duhet.

Të drejtat e mbrojtjes

Sikurse në rastet nga Gjykatat e Qarkut, mbrojtësit ligjor nuk emërohen deri para fillimit të marrjes në pyetje dhe kështu kryesisht nuk u është dhënë kohë për konsultime me klientin e tij apo saj, apo për shikimin e shkresave të lëndës para se të filloj marrja në pyetje. Mbrojtësi shpesh nuk merr pjesë aktivisht në procedurë. Lexo seksionin 4.

SMSL vazhdon të vërej se nga të bashkë-akuzuarit kërkohet që të largohen nga gjykatorja gjatë dhënjes së deklaratës nga i bashkë-akuzuari tjetër. Kjo praktikë mbizotëron si në nivelin e gjykatave të qarkut ashtu edhe në atë komunal, duke shkelur kështu standardet ndërkombëtare që i sigurojnë të dyshuarit të drejtën që të gjykohen në prezencën e vet.¹³² Në asnjë nga rastet e monitoruara nga SMSL, kryetari i kolegjit nuk ka sumarizuar deklaratat e të bashkë- akuzuarve, duke cënuar kështu ligjin vendor.¹³³

Roli i gjykatësve porot

Si rregull, gjykimet në Gjykatat Komunale mbahen para kolegjit në përbërje nga një gjykatës profesional dhe dy gjykatësve porot. Sikurse në gjykimet e Gjykatave të Qarkut, vazhdimisht është vërejtur se gjykatësit porot janë tërësisht pasiv gjatë procedurës penale. Ata dështojnë të marrin në pyetje dëshmitarët; nuk ka konsultime në mes të gjykatësit profesional dhe gjykatësve porot para se të mirren vendimet. Disa herë gjykimet janë mbajtur pa prezencën e gjykatësit porot.¹³⁴

Në rastin në Gjykatën Komunale në Prishtinë kundër tre të miturve, të akuzuar me vjedhje të rëndë, gjykimi kishte përfunduar me mungesën e njërit gjykatës porot,

¹³² Neni 6(3)(c) KEDNJ, Neni 14(3)(d) KNDCP.

¹³³ Neni 319 LPP RFJ.

¹³⁴ Neni 291 LPP RFJ.

përkundër faktit se prezenca e kolegjit është një parakusht absolut për mbajtjen e gjykimit kryesor. Gjithashtu mund të theksohet se as prokurori, e as mbrojtësi ligjor për tre të miturit nuk e kontestoi mbajtjen e gjykimit në mungesë të gjykatësit porot.

Në Gjykatën Komunale në Prizren, një gjykim i të miturit u zhvillua në mungesë të njërit prej gjykatësve porot. Në këtë rast, kryetari i kolegjit gjithashtu injoroi detyrën e tij për të votuar me pjesën e mbetur të kolegjit mbi leximin e deklaratave të dëshmitarëve të cilët nuk ishin prezent në gjykim, edhe kjo në shkelje të ligjit vendor.¹³⁵

Bashkëpunimi i pamjaftueshëm me organet e rendit publik.

Gjatë hetimeve policore, organet e rendit duhet të ndërmarrin të gjithë hapat e domosdoshëm për të gjetur kryesin.¹³⁶ Sa i përket procedurës së identifikimit, SMSL ka vërejtur se autoritetet e rendit në disa raste dështojnë që në mënyrë të drejtë të identifikojnë identitetin e të pandehurit apo dëshmitarëve. Ishin disa raste në gjykatat komunale ku të pandehurit paraqiteshin në gjykatë pa pasur asnjë ide se përse ata ishin ftuar. Sipas gjykatësve dhe prokurorëve vendor, gjithashtu ndodhte që personat e gjetur në vendin e krimit të japin të dhëna të rrejshme policisë, ndonjëherë madje edhe të dhënat personale të ndonjë personi tjetër. Me kapacitetet e tyre specifike, policia duhet të bëjë identifikimin e personave të përfshier në veprimet penale që nga fillimi i hetimeve, pasi që, në kohën kur lënda të arrij në gjykatë, do të jetë tepër vonë. Për më tepër, gjykatat vendore nuk kanë kapacitete logjistike për të ushtruar operacione të këtilla, andaj bashkëpunimi me policinë është parësor.

Në GJK Prishtinë, një i mitur i akuzuar për vjedhje pylli u paraqit në gjykatë pasi që ishte ftuar për tu marrë në pyetje para gjykatësit hetues. I mituri pretendonte se nuk ishte fajtor dhe deklaroi se nuk kishte ide se kush i kishte dhënë informatat personale në emër të tij. Dëshmitari, i cili përfaqësonte pronarin, vërtetoi se i mituri nuk ishte parë në vendin e veprës. Hetimet pasueshëm ishin pezulluar. Pa marrë parasysh at fakt, të dhënat personale të të miturit dukshëm ishin regjistruar në procesverbalin e hetimeve, që mund të ketë pasoja negative për të, në të ardhmen.

Gjatë rastit tjetër në GJK në Prishtinë, dy persona ishin arrestuar dhe paraburgosur, si të dyshuar për sulm. Të dy të dyshuarit kishin dhënë informata të rrejshme përkitazi me identitetin e tyre gjatë marrjes në pyetje dhe gjykatësi hetues deklaroi se ajo nuk ishte në gjendje të përcaktoj identitetin e të dyshuarve.

Rastet e të miturve në Gjykatat Komunale

Gjykatat Komunale parësisht kanë të bëjnë me rastet e delikuencës së të miturve. Këto procedura janë të shumtën të përshkuara nga të njëjtat mospërputhje sikurse ato të identifikuar në raportet e mëparshme të SMSL, kur është bërë analizimi i sistemit të gjyqësisë penale në shkallën e Gjykatave të Qarkut.

Për momentin, vetëm shtatë Gjykata Komunale në Kosovë kanë të bëjnë me lëndët e të miturve. Që nga emërimet e fundit të UNMIK-ut, të gjykatësve dhe prokurorëve në Kosovë, nuk është ndërmarrë asnjë masë e mëtejme për të rritur numrin e gjykatësve për

¹³⁵ Neni 333 (1&2).

¹³⁶ Neni 151 (1) LPP RFJ.

të mitur. Mungesa e gjykatësve të dedikuar rasteve të të miturve dukshëm ndikon në normën e punës të gjykatësve për të mitur dhe shumë prej tyre deklarojnë se ata janë të stërngarkuar me lëndë dhe nuk mund të zhvillojnë lëndët me të mitur me ekspeditivitetin e domosdoshëm. Në Prizren, gjykatësi për të mitur kishte të bënte me 302 raste gjatë periudhës së kaluar gjashtëmujore. Tjetër shqetësim serioz buron nga fakti se i njëjti gjykatës i cili zhvillon hetimet më vonë merr pjesë në kolegjin gjykues, të shumtën e rasteve si kryetar kolegji. Ky aspekt i fundit shtron çështjen nga perspektiva e paanshmërisë së gjykatësit përkitazi me rastin. Nga pikëpamja e ligjit ndërkombëtar mbi të drejtat e njeriut, Gjykata Evropiane gjeti mungesë të paanshmërisë në rastin kur gjykatësi hetues ka urdhëruar paraburgimin e të akuzuarit para gjykimit si dhe ka marrë të njëjtin në pyetje në një numër rastesh, e më vonë është emëruar si gjykatës në gjykim.¹³⁷

SMSL kupton se rritja e numrit të gjykatësve sjell në pah tjera çështje, siq është rritja e buxhetit për sigurimin e të ardhurave dhe logjistikës së domosdoshme për ushtrimin e detyrës së gjykatësit (nëpunës plotësues, zyra për punë të gjykatësit dhe nëpunësve të tij, pajimet e domosdoshme në aktivitetet ditore, etj). Sidoqoftë, mungesa e buxhetit të mjaftueshëm mund të tejkalohet përmes shpërndarjes fleksibile të normës së punës në mes të gjakatave.

Statistikat vijuese tregojnë lëndët e regjistruara dhe të përfunduara të lëndëve të të miturve gjatë periudhës raportuese nga janari gjer në qershor 2001.

Gjykata Komunale	Gjithësejt rastet në procedurë	Rastet e përfunduara	Rastet e papërfunduara	Rastet e transferuara
Gjilan	147	42	103	2
Prizren	302	48	254	
Peja	70	42	28	
Prishtinë	263	53	202	8
Ferizaj	114	29	85	
Mitrovicë	68	30	38	
Gjakovë	66	24	42	

Pjesëmarrja e qendrave për punë sociale

Qendrat për Punë Sociale (QPS) nën Departamentin për Shëndetësi dhe Mirëqenje Sociale (DSHMS) duhet të luajn rolin kyq në të gjitha rastet e dhunës familjare dhe të miturve. Pa pjesëmarrjen aktive të këtij autoriteti, policia dhe gjykata nuk janë në gjendje të procedojnë në mënyrë të duhur rastet penale dhe rastet e dhunës ndër-familjare. Bashkëpunimi i tyre është gjithashtu crucial në vendimin se a duhet shpallur masat edukuese¹³⁸ apo masat ndëshkuese¹³⁹ kundër të miturit që ishte dënuar për kryerjen e veprës penale.

¹³⁷ Shiko rasti Cubber, 26 Tetor 1984, KEDNJ.

¹³⁸ d.m.th. mbikqyrja e shtuar nga ana e prindëve, familjes tjetër mvëshur me të drejta dhe detyrime, organit të kujdestarisë, dhe gjithashtu qortimi gjyqësor.

¹³⁹ d.m.th dërgimi i të miturit në institucion edukativ, edukativo-korrektues, apo burg.

Ligji vendor parashikoh një rol aktiv të QPS gjatë procedurës me të miturit. QPS ka të drejtë të informohet për rrjedhën e procedurës, të bëj rekomandime dhe të theksoj faktet dhe provat e rëndësishme për vendim të drejtë.¹⁴⁰ Gjatë procedurës përgatitore kundër të miturit, nga QPS mundet, nëse është e domosdoshme, të kërkohet që të përpiloj raportin përkitazi me rrethanat relevante për vlerësimin e zhvillimit mental të të miturit dhe ambientin në të cilin ai/ajo jeton, dhe i cili mund të ketë ndikim në personalitetin e tij/saj.¹⁴¹ Për gjykim do të ftohen si QPS ashtu edhe kujdestari.¹⁴²

Siq është theksuar në Raportin e fundit mbi Sistemin e Gjyqësisë Penale, zyrat e QPS të administruara nga KB kanë mungesë personeli, diturie profesionale, resursesh dhe ndonjëherë madje edhe vullnet për të përmbushur obligimet e ligjore përkitazi me të miturit. Në rastet kur është inkuadruar QPS, nga ana e tyre është demonstruar mungesë e njohurisë profesionale, që indikon nevojën substanciale për trajnim apo madje edhe për një reformë të theksuar.

Pjesëmarrja e QPS ndryshon në komunat e ndryshme, por në përgjithësi mund të theksohet se QPS shpeshherë dështon të në dhënjën e raporteve të kërkuara nga kolegjet për të miturit, raporte të cilat janë të rëndësishme së madhe për vendimin e shpalljes së masës edukuese apo asaj ndëshkimore. P.sh. nga njëmbëdhjetë rastet e përfunduara për të miturit në Gjykatën Komunale në Pejë në Prill, QPS përpiloi raportet vetëm për pesë raste. Për më tepër, është praktikë e përbashkët që ndonëse të ftuar në mënyrë të rregullt për gjykim, QPS dështon të paraqitet në seancat kundër të miturve.

Pjesëmarrja e kujdestarëve ligjor në rastet penale kundër të miturve

Si ligjet ndërkombëtare ashtu edhe ato vendore kërkojnë pjesëmarrjen e prindëve apo kujdestarëve ligjor në procedurat penale që kyqin të miturit.¹⁴³ SMSL sidoqoftë ka ardhur në përfundim se inkuadrimi dhe pjesëmarrja e prindëve në procedurat kundër të miturve, të shumtën mungon. Monitorimi i gjykatave zbuloi se prindët apo kujdestarët ligjor shpesh nuk asistojnë të miturin, ose për shkak se nuk ishin të ftuar ose për shkak se kanë zgjedhur që të mos paraqiten në procedurë. Në frymë të obligimit për të marrë parasysh interesin më të mirë për të miturit në procedurë penale, SMSL inkurajon një komunikim më të mirë në mes të gjykatësve për të mitur dhe prindëve të të miturit apo kujdestarit ligjor. Prindët janë natyrisht në pozitë më të mirë për të ofruar informata përkitazi me rrethanat në të cilat jeton i mituri, dhe në përgjithësi, kyqja e prindëve në tërë procedurën penale duhet të konsiderohet si kruciale për zhvillimin e mëtejshëm të të miturit. Kontakti në mes të gjykatësit për të mitur dhe prindëve të të miturit duhet gjithashtu të vazhdojë pas përfundimit të rastit pasi që prindi mund të ofroj gjykatësin për të mitur me informata përkitazi me ndikimin e masave të cilat janë shpallur kundër të miturit, apo eventualisht të rekomandoj masa të tjera.¹⁴⁴

¹⁴⁰ Neni 459 LPP RFJ.

¹⁴¹ Neni 471 (1-4) LPP RFJ.

¹⁴² Neni 481 (2) LPP RFJ.

¹⁴³ Shiko Nenet 9 & 18 KDF dhe , d.m.th Nenet 471 (2) & 481 (2) LPP RFJ.

¹⁴⁴ Neni 492 LPP RFJ.

Dhuna në familje

Standardet ndërkombëtare mbi të drejtat e viktimës së krimit kërkojnë nga autoritetet shtetërore që të sigurojnë që asistimi i përshtatshëm t'i jetë në dispozicion të viktimës përgjatë tërë procedurës ligjore. Asistimi duhet të përfshijë përkrahjen materiale, mjekësore, psikologjike dhe sociale, si dhe informimin e viktimave mbi disponueshmërinë e shërbimeve shëndetësore dhe sociale, e gjithashtu edhe sigurimi i gasjes ndaj tyre.¹⁴⁵

Në pajtim me standardet ndërkombëtare të përmendura më lart, UNMIK-u dhe organet e përkohshme në Kosovë ksnë obligimin pozitiv për të siguruar mbrojtje të mjaftueshme të adekuate për viktimat e dhunës familjare. Obligimet ndaj viktimës së dhunës familjare ngriten më tej sipas standardeve ndërkombëtare që kan qëllim mbrojtjen e grave dhe fëmijëve si dhe sipas parimeve të përgjithshme të mbrojtjes së barabartë.¹⁴⁶

Rastet e dhunës familjare formojnë një kategori të gjërë të veprave penale të kryera nga njëri anëtar i familjes ndaj tjetrit. Andaj rastet e dhunës familjare gjykohen në të gjitha nivelet e gjykatave, mvarësisht nga serioziteti i veprës.¹⁴⁷

SMSL ka vërejtur se rastet e dhunës familjare shumë shpesh nuk janë udhëhequr në mënyrë profesionale dhe adekuate. Dënimet janë të ulëta dhe jo-adekuate, dhe në disa raste kryesi kalon i padënuar. Viktimat shpesh vëhen në pozita ku ato duhet të kthehen në shtëpi ku mund të bëhen subjekt të abuzimit të mëtejshëm nga i njëjti kryes. Dhe sikurse në rastet me të miturit, Qendra për Punë Sociale është shpesh jo-efektive në rastet e dhunës familjare dhe dështojnë në ofrimin e asistencës në gjykatë. Shembujt vijues paraqesin disa nga parregullësitë procedurale në rastet e dhunës familjare.

Në Gjykatën Komunale në Prishtinë, i pandehuri është shpallur fajtor për sjellje të dhunshme sipas nenit 190/1 të LPK, që parasheh dënimin me burgim prej gjashtë muajsh deri në pesë vite. I pandehuri e kishte rrahur gruan e tij me një pjesë druri. Ai ishte dënuar me gjashtë muaj burgim me kusht, d.m.th. me efekt më të ulët se dënimi më i ulët i mundshëm. Sipas ekspertit mjekësor i pandehuri kishte qenë agresiv, impulsiv dhe i dehur në momentin kur e ka sulmuar gruan e tij.

Në një rast tjetër në Gjykatën Komunale në Prishtinë, i pandehuri i cili kishte rrahur brutalisht gruan e tij, ishte dënuar me dënimin me kusht. Fillimisht i pandehuri ishte akuzuar për sjellje të dhunshme, por gjatë seancës kryesore prokurori e ndryshoi aktakuzën dhe e ri-kualifikoi veprën si lëndim i lehtë trupor duke theksuar se i pandehuri kishte përdorur vetëm “armën e ftohtë” (d.m.th. jo armë zjarri). Sipas viktimës, ajo rregullisht ishte maltretuar dhe rrahur nga bashkëshorti i saj për disa vite. Kjo histori e sjelljes së dhunshme është dashur të peshoj më tepër në arritjen e vendimit final, pasi që

¹⁴⁵ Deklarata mbi Parimet Themelore të Gjyqësisë për Viktimat dhe Abuzimi i Pushtetit.

¹⁴⁶ Konventa mbi Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit të Grave (KEGJFDG), Deklarata mbi Eliminimin e Dhunës Kundër Grave, Konventa mbi të Drejtat e Fëmijut.

¹⁴⁷ Gjykatat për Kundërvajtje janë kompetente për kundërvajtjet për të cilat personi mund të dënohet gjer në gjashtë muaj burgim, Gjykatat Komunale: 1-5 vite burgim dhe Gjykatat e Qarkut: më tepër se 5 vite burgim.

dënimi me kusht i shpallur nga gjykata, e sjell të pandehurin prapa dhe sjell për viktimën rrezikun për të qenë sërish e abuzuar.

Në një rast në Gjykatën Komunale në Prizren, lidhur me dhunën familjare, gruaja e të pandehurit raportoi se bashkëshorti i saj në mënyrë përsëritëse e ka keqtrajtuar, dhe gjithashtu ka rrahur tre fëmijët e tyre (të moshës tre, gjashtë dhe tetë vjeçare) me rryp duke u lënë shenja nëpër tërë trupin. Në një rast ajo ishte rrahur aq keq sa që ka humbur vetëdijen. Bashkëshorti është akuzuar për “lëndime të lehta trupore” dhe rezultati i gjykimit ishte se gjykata vetëm e qortoi bashkëshortin. Sipas Nenit 59 LP RFJ, qortimi gjyqësor mund të administrohet për veprat penale që dënohen me maksimum një vit burgim nëse ato *kishin qenë kryer nën ato rrethana të cilat i bëjnë ato posaçërisht minore*.

Rastet e drogës dhe kompetenca materiale e Gjykatave Komunale

Numri i rasteve të lidhura me drogë në Kosovë, sikurse dhe veprat tjera tipike të krimit të organizuar kanë përjetuar rritje pas konfliktit të v. 1999. Ekzistojnë rrjeta të tëra të kriminelëve që kanë të bëjnë me drogë dhe këto rrjeta po bëhen shumë atraktive për shumë njerëz të rinj të cilët hyjnë në këto aktivitete joligjore, ose si shpërndarës ose si përdorues. Në këtë raport, sidoqoftë, do të bëhet diskutimi vetëm përkitazi me kompetencën materiale të gjykatave të ndryshme për të gjykuar veprat në lidhje me drogën. Siq theksohet në hyrjen e këtij Seksioni, gjykatat komunale janë në përgjithësi kompetente për të gjykuar të gjitha rastet penale që bartin dënimin gjer në pesë vite burgim.¹⁴⁸ Si përjashtim nga kjo rregull kryesore gjykatat komunale janë gjithashtu kompetente për të gjykuar rastet përkitazi me vjedhjet e rënda me dënimin maksimal gjer në dhjetë vite burgim.¹⁴⁹ Neni 245 LP RFJ mbi *prodhimin e paautorizuar dhe shitjen e narkotikëve* thotë:

(1) Kush prodhon në mënyrë të paautorizuar, përpunon, shet ose ofron për shitje apo për qëllime shitjeje blen, mban apo transporton, ose ndërmjetëson në shitjen ose blerjen, apo në ndonjë mënyrë tjetër pa autorizim vë në qarkullim substanca apo preparate që janë shpallur si narkotikë ose substanca psikotropike, do të dënohet me gjashtë muaj *deri në pesë vjet burg*.

(2) Në qoftë se vepra penale nga paragrafi 1 i këtij neni është kryer nga *disa persona* që janë bashkuar për t'i kryer këto vepra apo kryesi i kësaj vepre ka organizuar rrjetin e stërshitësve ose të ndërmjetësuesve, ose në qoftë se vepra penale është kryer me narkotikë apo me substanca psikotropike *veçanërisht të rrezikshme*, kryesi do të dënohet me një *deri në dhjetë vjet burg*.

Pra, sipas dispozitës së mësipërme, kompetenca për veprat lidhur me drogën, është e ndarë në mes të gjykatës komunale dhe asaj të qarkut mvarësisht prej rrethanave të rastit individual. Sidoqoftë, në bazë të statistikave të fituara nga DAD dhe sipas monitorimit të SMSL, mund të përfundohet se të gjitha rastet në lidhje me drogën zgjidhen nga gjykatat e qarkut pa marrë parasysh rrethanat nën të cilat është kryer vepra. SMSL ka tentuar ta

¹⁴⁸ Neni 26(2), Ligji mbi Gjykatat e Rregullta.

¹⁴⁹ Ibid. përkitazi me vjedhjen e rëndë, shiko nenin 135 LPK.

sqaroj këtë, dhe deri tani ka kontaktuar disa akterë të gjyqësisë. Një argument i dhënë nga një gjykatës i Gjykatës së Qarkut ishte se të gjitha drogat, pa marrë parasysh kuantitetin apo karakteristikat, duhet të shikohen si narkotik *veçanërisht të rrezikshëm* apo si substanca psiko-tropike, andaj kualifikohen si raste nën kompetencën e gjykatave të qarkut. SMSL nuk ka njohuri mbi praktikën gjyqësore apo mendim ligjor i cili do ta sqaronte këtë çështje. Andaj, është rekomanduar që Gjykata Supreme, në pajtim me mandatin e saj sipas ligjit vendor, të sqaroj çështjen e kompetencës në rastet lidhur me drogën.¹⁵⁰

Më 12 shkurt 2001, një burrë shqiptar i Kosovës ishte arrestuar si i dyshuar për tentim të shitjes së afro 7 gram *marihuane*. I dyshuari pranoi se kishte patur në posedim masën e përmendur. I dyshuari ishte mbajtur në paraburgim për gati dy muaj para se të ishte liruar për tu mbrojtur në liri, më 9 prill 2001. Lënda është në Gjykatën e Qarkut në Mitrovicë.

Rrethanat në rastin e sipërm, d.m.th. se masa shumë e vogël e marihuanës nuk mund të konsiderohet si *substancë narkotike veçanërisht e rrezikshme*, qartë indikojnë se ky rast më shumë duhet të jetë nën kompetencën e gjykatës komunale se sa të asaj të qarkut.

Shqetësim tjetër në lidhje me veprat e drogës, janë aktgjykimet të bazuara në nenin 245 LP RFJ çka duket të jenë rastet thjeshtë të *posedimit* të narkotikëve për përdorim personal, e cila gjë nuk është sanksionuar sipas ligjit të aplikueshëm. Monitorimi i SMSL indikon se akuzat për prodhimin e paautorizuar /shitjen e narkotikëve janë ngritur pa-diskriminim për të gjitha rastet në lidhje me narkotikët, qoftë për prodhim dhe shitje, apo qoftë vetëm për posedim. Shqetësimet e SMSL bazohen në nenin 7 (1) KEDNJ, sipas të cilës asnjëri nuk do të konsiderohet fajtor për ndonjë vepër penale në bazë të çfarëdo veprimi apo lëshimi që nuk konstituon vepër penale sipas ligjit vendor apo ndërkombëtar në kohën kur është kryer.

Më 28 prill 2001 dy serb të Kosovës ishin arrestuar pasiqë 579 gram dhe 728 gram kanabis, ishin zbuluar në shtëpitë e tyre. Përveq deklaratës së policisë që vërteton konfiskimin, nuk duket të ketë prova të prodhimit apo shitjes. Për më tepër raportimet e shitjes janë bërë nga pala e tretë, identiteti i të cilit nuk është zbuluar nga policia dhe i cili nuk është ftuar të dëshmoj para gjykatës. Më 2 gusht, d.m.th pas më tepër se tre muajsh paraburgimi, ata ishin dënuar me dy vite dhe pesë muaj respektivisht me tre vite dhe gjashtë muaj burgim.

Nga 205 individë të numëruar në listën e aktakuzave më 25/07/01, në Gjykatën e Qarkut në Gjiilan, 48 apo 23% ngarkoheshin me akuza droge.¹⁵¹

¹⁵⁰ Neni 145 I Ligjit mbi Gjykatat e Rregullta thotë se: “ Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e saj të përgjithshme ...përcakton qëndrimet parimore dhe mendimet ligjore për aplikimin unik të ligjeve krahinore nga gjykatat në teritorin e krahinës...”

¹⁵¹ Statistikat e përmendura i referohen periudhës prej Janarit 2000 gjer në Gusht 2001.

III. GJYKATAT PËR KUNDËRVAJTJE

Vërejtjet hyrëse

Janë 22 GJKV në Kosovë përbrenda strukturës dhe autoritetit të UNMIK-ut dhe 3 veprojnë paralelisht nga serbët që nuk e njohin autoritetin e UNMIK-ut. Kompetenca e GJKV përfshin lëmin e qetësisë dhe rendit publik, sigurinë e komunikacionit, sigurinë publike, ekonominë dhe financat, lëminë e marrëdhënjeve të punës, edukimit, shkencës, kulturës dhe informacionit, lëminë e shëndetësisë dhe mbrojtjen sociale, sigurimin shëndetësor, ambientin dhe administratën.¹⁵² Me një spektër të tillë të gjërë kompetencash, Gjykatat për Kundërvajtje janë pa dyshim një pjesë shumë e rëndësishme e gjyqësisë në Kosovë.

Një shqyrtim i shkurtër i procedurës kundërvajtëse

Sipas definicionit ligjor, kundërvajtjet paraqesin shkeljet e rendit publik me pasoja më pak serioze mbi vlerat esenciale shoqërore, siq është e përcaktuar me ligj.¹⁵³

Kompetenca territoriale e gjykatave për kundërvajtje është e përcaktuar nga vendi ku është kryer vepra, e kur kjo nuk mund të përcaktohet atëherë kompetenca përcaktohet nga vendbanimi i kryesit.¹⁵⁴

Kompetenca materiale për gjykimin e rasteve në shkallën e parë qëndron në gjykatën komunale për kundërvajtje. Instanca e dytë dhe e fundit e gjykatave për kundërvajtje Gjykata e Lartë për Kundërvajtje e ka selinë në Prishtinë dhe mbulon tërë territorin e Kosovës.

Palët në procedurën për kundërvajtje janë i pandehuri dhe pala e dëmtuar. Të drejtat e të pandehurit, siq janë përcaktuar me ligj, janë: parashtrimi i provave, parashtrimi i parashtrësave dhe i mjeteve juridike, mbrojtja e vet personale apo angazhimi i ndihmës profesionale ligjore, qasja dhe kopjimi i shkresave të lëndëve.¹⁵⁵ Pala e dëmtuar është personi të drejtat personale apo pronësore të të cilit janë cënuar apo kërcnuar nga kryerja e kundërvajtjes. Të drejtat e palës së dëmtuar në procedurën e kundërvajtjes janë si vijon: parashtrimi i kërkesës për fillimin e procedurës kundërvajtëse, parashtrimi i provave, dhënja e propozimeve dhe kërkesave pronësoro-juridike për kompenzimin e dëmit të shkaktuar nga kundërvajtja, angazhimi i mbrojtësit ligjor për përfaqësimin e saj/tij në procedurë, qasja dhe kopjimi i shkresave të lëndës, parashtrimi i ankesave kundër vendimit.¹⁵⁶

Procedura e kundërvajtjes mund të inicohet sipas kërkesës ose të organeve të autorizuara shtetërore apo administrative lokale, ose të palës së dëmtuar.

¹⁵² Gjykatat për Kundërvajtje në Zubin Potok dhe Leposaviq nuk janë në sistemin e UNMIK-ut.

¹⁵³ Udhëzimet mbi Provimin e Judikaturës, 1987, Prof. Dr. Borislav Bllagojeviq dhe Oliver Antiq.

¹⁵⁴ Neni 74 i Ligjit mbi Kundërvajtjet (LKV).

¹⁵⁵ Neni 87 LKV.

¹⁵⁶ Neni 95 I LKV.

Prezenca e kryesit në procedurë mund të sigurohet me thirrje, sjellje nën përcjellje policore, dorëzani, dhe *paraburgim*. Sidoqoftë, në procedurën kundërvajtëse nuk ekziston paraburgimi si i tillë; ligji përdor nocionin e “mbajtjes”¹⁵⁷, që nënkupton se i dyshuari nuk mund të “paraburgoset” por “të mbahet”¹⁵⁸, në rastet kur ekziston dyshimi i ikjes, apo kur identiteti i kryesit nuk mund të përcaktohet. Gjykatësi komunal për kundërvajtje do të lëshoj urdhër për mbajtjen e të dyshuarit, e cila mbajtje nuk duhet të kaloj 24 orë.¹⁵⁹ Brenda kësaj periudhe kohore, i dyshuari duhet të merret në pyetje dhe duhet të mirret vendimi.¹⁶⁰ Gjykatësi gjithashtu mundet të urdhëroj mbajtjen e personit nëse ai person është gjetur në kryerjen e veprës nën ndikimin e alkoolit dhe nëse ekziston rreziku se ai/ajo mund të kryej vepra tjera. Masë e ngjashme mund të ndërmerret nga organet e rendit dhe i dyshuari nuk mund, në raste të tilla, të mbahet më tepër se 12 orë.¹⁶¹

Sikurse në hetimet penale, gjykatësi për kundërvajtje mund të marrë në pyetje apo të dëgjoj kryesin e raportuar, palën e dëmtuar, dhe dëshmitarët e të dy palëve. Ai apo ajo mund të urdhëroj në dëgjimin e ekspertëve, bastisjen e lokaleve dhe personave, apo konfiskimi e përkohshëm të sendeve në lidhje me kundërvajtjen.

Gjykimet në Gjykatën për Kundërvajtje janë publike, përveq në rastet ku intereset e moralit arsyetojnë përjashtimin e publikut, përderisa procedura me kryesit e mitur gjithmonë mbahet pa prezencën e publikut.¹⁶²

Si përjashtim nga rregulla e përgjithshme e procedurës, vendimi mbi kundërvajtjen mund të merret pa thirrjen dhe marrjen në pyetje të kryesit nëse kërkesa për iniciimin e procedurës është përpiluar nga organet e rendit apo autoritetet inspektuese, dhe është e bazuar në observimin e drejtpërdrejtë të zyrtarëve apo inspektorëve.¹⁶³ Rregulla të njëjta aplikohen për kundërvajtjet e sanksionuara nga ligji vetëm me gjobitje.

Dënimet e parapara në ligjin mbi kundërvajtjet janë ose *dënime me të holla* ose *burgimi*. Nëse gjykatësi konsideron ashtu, *qortimi* mund tu ipet personave të shpallur fajtor për kryerjen e kundërvajtjes me pasoja minore. Minimumi i përgjithshëm për burgim është një ditë, e maksimumi i përgjithshëm është 30 ditë, apo 60 ditë për kundërvajtjet serioze me të cilat vëhet në rrezik shëndeti apo jeta e njerëzve.¹⁶⁴ Burgimi i kundërvajtësve të mitur nuk duhet të kaloj 15 ditë. Masat mbrojtëse gjithashtu mund të urdhërohen, siq është konfiskimi i sendeve apo fondeve në lidhje me kundërvajtjen, ndalesa e vozitjes së automjetit, deportimi i shtetasve të huaj, trajtimi i obligueshëm i alkoolistëve dhe narkomanëve.¹⁶⁵

¹⁵⁷ Neni 153 LKV; shiko gjithashtu Udhëzimet mbi Provimin e Judikaturës, 1987 (*ante note 2*).

¹⁵⁸ Ndonëse të dy nocionet kanë të bëjnë me privimin nga liria, dallimi i bërë nga Ligji mbi Kundërvajtjet duket të rrjedhë nga gjatësia e shkurtër e kësaj të fundit, procedurës tjetër të imponimit dhe pasojave tjera për personin e paraburgosur.

¹⁵⁹ Neni 155 LKV.

¹⁶⁰ Neni 195 LKV, thotë se procedura për rastin është kompletuar me dhënjen e vendimit me të cilin procedura është suspenduar apo i akuzuari është shpallur fajtor.

¹⁶¹ Neni 156 LKV.

¹⁶² Neni 33 LKV.

¹⁶³ Neni 201 LKV.

¹⁶⁴ Neni 2 LKV.

¹⁶⁵ Neni 16 I LKV.

Efekti i rregulloreve të fundit të UNMIK-ut mbi Kompetencën e GJKV.

Disa rregullore të UNMIK-ut, të hyra në fuqi së voni, kan sjellur ndryshime në kompetencën lëndore të GJKV, të shumtën e rasteve duke transferuar kompetencën e lëmive mirë të definuara të delikucencës apo kriminalitetit nga GJKV te gjykatat komunale apo madje te ato të qarkut.

Tri rregullore duhet të përmenden veçanërisht: Rregullorja e UNMIK-ut 2001/04 mbi Ndalimin e Trafikimit të Personave në Kosovë, Rregullorja e UNMIK-ut 2001/10 mbi Ndalimin e Kalimit të Paautorizuar të Kufirit dhe Rregullorja e UNMIK-ut 2001/07 mbi Autorizimet mbi Posedimin e Armëve në Kosovë. Aktivitetet specifike të kualifikuara më heret si kundërvajtje, ishin rridefinuar si vepra më serioze penale.

Informatat statistikore mbi Gjykatat për Kundërvajtje

Tabela më poshtë prezenton aktivitetin e gjithëmbarshtëm të GJKV në kuptim të efikasitetit dhe normës.

Gjykata Komunale për Kundërvajtje	Rastet e përgjithshme në proces	Rastet e zgjidhura	Rastet e pazgjidhura	Data e të dhënave të fundit
Gjilan	6140	2728	3412	31/08/01
Kamenicë	1642	1212	430	31/08/01
Viti	2306	1504	802	30/08/01
Prizren	4307	2467	1600	30/08/01
Dragash	865	786	79	31/08/01
Malishevë	2232	658	1574	31/08/01
Rahovec	2236	1275	961	11/09/01
Suharekë	1847	1074	803	31/08/01
Pejë	3797	2643	1154	31/08/01
Istog	588	497	91	31/08/01
Deqan	898	743	155	7/09/01
Gjakovë	1133	722	411	7/09/01
Klinë	1975	1502	473	31/08/01
Prishtinë	6945	6120	510	31/08/01
Glllogvc	1121	662	459	31/08/01
Lipjan	709	665	44	30/08/01
Podujevë	267	215	52	30/07/01
Kaqanik	1429	1118	311	30/08/01
Ferizaj	2710	2153	557	6/09/01
Mitrovicë	2376			31/08/01
Skenderaj	719	650	34	31/08/01
Vushtrri	802	605	197	15/08/01
Leposaviq	-	-		
Zubin Potok	-	-		

Rastet në Gjykatat e Kundërvajtjes

Rishqyrtimi vijues ka për qëllim ofrimin e një kuptimi të gjithëmbarshtëm të lëmive ligjore të mbuluara nga GJKV dhe gjithashtu të identifikoj çështjet shqetësuese që ndikojnë në aktivitetin e këtyre gjykatave në secilën lëmi veqmas.

Lëmia e sigurisë në rrugë

Nga 23,042 rastet e kundërvajtjeve të pranuar nga GJKV, në mes të janarit dhe qershorit 2001, 14,362 raste përfshijnë kundërvajtjet nga komunikacioni (87%). Shqetësim i veçantë në këto raste është masa e konfiskimit të veturave të vozitura nga kryesit, e cila siq duket aplikohet në tërë Kosovën.

Praktika e përgjithshme në rastet e kundërvajtjeve të komunikacionit është se policia lëshon tiketat e komunikacionit dhe si “masë mbrojtëse” konfiskon automjetin dhe e bart atë në një vend të caktuar parkimi nga i cili pronari mund ta rikthej, vetëm kur ai apo ajo paguan gjobën. Kundërvajtësi është i obliguar të paguaj gjithashtu edhe bartjen dhe gjobën për vend-parking. Përderisa kjo praktikë mund të jetë shumë profitabile për kompanitë bartëse, e njëjta nuk është në pajtim me Ligjin mbi Bazat për Sigurinë e Trafikut në Rrugë, që është e aplikueshme në Kosovë. Marrja apo konfiskimi i automjetit në një kundërvajtje komunikacioni nuk është autorizuar sipas këtij ligji.

Në vend të kësaj, autoritetet policore bazohen në Instrukcionet Administrative Civile 1999/1 të lëshuara nga Zëvendësi i PSSP, i cili parasheh mundësinë e konfiskimit të automjeteve të kyqura në kundërvajtjet e trafikut siq është tejkalmi i rrezikshëm apo vozitja e rrezikshme. I njëjti Instrucion Administrativ parasheh në Seksionin 9, se nëse automjetet nuk rikthehen brenda 30 ditësh, ato do të jenë subjekte konfiskimi. Rrjedhimisht, nëse kryesi nuk ka mundësi financiare në kohën specifike të gjobitjes apo gjobitjes së parkingut, ai apo ajo mund të humb automjetin. SMSL beson se një praktikë e tillë është e papranueshme nga fakti se imponon barrë shtuese mbi kryesin. Sankcionet e vetme të parashikuara nga ligji janë gjobitja, burgimi apo, nëse është e aplikueshme, qortimi. Marrja e automjetit apo pagimi i gjobës për parking nuk janë në mesin e tyre. Për më tepër, aplikueshmëria e Instrukcionit Administrativ të përmendur është e dyshimtë. Së pari, Instrukcioni dështon të indikoj se a është i aplikueshëm vetëm për periudhën e kufizuar të kohës, e arsyetuar me rrethanat përjashtimore më 1999. Ai gjithashtu dështon të theksoj se a e zëvendëson ndonjë nga ligjet e aplikueshme të komunikacionit që aplikohen në Kosovë, siq është Ligji mbi Bazat e Sigurisë së Komunikacionit në Rrugë. Edhe nëse e bën këtë, parimet themelore të ligjit të njohura dhe të theksuara në cilido legjislacion vendor sigurojnë për hierarki strikte të ligjeve, në pajtim me të cilat një ligj mund të modifikohet, ndryshohet apo devijoj nga ligji i “rangut” të ngjashëm apo më të lartë. Me fjalë tjera, një instrucion administrativ i miratuar nga organi ekzekutiv apo administrativ, nuk mund të zëvendësoj, d.m.th ndryshoj, modifikoj apo devijoj nga dispozitat e ligjit, të miratuar nga autoriteti legjislativ (parlamenti apo tjetër).

Lëmia e sigurisë publike

Në rastet kur arma është poseduar pa leje valide, kompetenca lëndore i ka takuar GJKV (lëmia e qetësisë, sigurisë dhe rendit publik). Format e rënda të posedimit (të kualifikuara nga lloji i armëve dhe sasia), ishin gjykuar nga gjykatat komunale (sasia e vogël e armëve dhe municionit, neni 199, al. 1 LPK), përderisa gjykatat e qarkut kishin kompetencë në rastet ku posedimi ishte në mënyrë strikte i ndaluar (neni 199, al. 3 LPK), apo nëse ishte sasi e madhe e armëve. Me plotëfuqishmërinë e Rregullores së UNMIK-ut 2001/07 mbi Autorizimin mbi Posedimin e Armëve në Kosovë, rastet e posedimit të kundërligjshëm të armëve janë gjykuar vetëm nga gjykatat komunale apo të qarkut. E njëjta aplikohet për kalimet ilegale të kufirit, raste të cilat më parë ishin gjykuar nga GJKV, sipas Ligjit mbi Kalimin e Kufirit Shtetëror dhe Lëvizjen në Zonën Kufitare (1979).¹⁶⁶ Për kriminalitetin e ri të definuar, në relacion me kalimin apo lëvizjen brenda rajoneve të kufinjëve, kompetenca i është kaluar gjykatave më të larta.

Në rastet e dokumentuara nga SMSL, duket se GJKV të ndryshme përgjatë regjionit kanë të bëjnë me rastet e hyrjes ilegale apo prezencës në Kosovë në mënyra të ndryshme. Shembujt e zgjidhjes asimetrike të rasteve të hyrjes ilegale janë ofruar në Seksionin e mëparshëm të këtij raporti, në fokusim të kriminalitetit në relacion me trafikim, andaj ato nuk do të numërohen sërish.¹⁶⁷ Sidoqoftë, ishte një rast tjetër në GJKV në Prizren, ku dy shtetas të RFJ (mashkull dhe femër), që kishin statusin e refugjatëve në Gjermani, ishin dënuar me gjobë prej 150 DEM secili, dhe me urdhër për deportim, për shkak të kryerjes së veprës së kalimit të kundërligjshëm të kufirit, nga Shqipëria në Kosovë. Vendimi ishte sjellur në shkelje si të dispozitave të ligjit vendor, respektivisht nenit 23 të Ligjit mbi Kundërvajtjet i cili sanksionon vetëm jo-shtetasit, ashtu edhe të standardeve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, respektivisht të Protokolit 4, Nenit 3 të KEDNJ, që ndalon deportimin e shtetasve.

Lëmia e qetësisë dhe rendit publik

Para hyrjes në fuqi të Rregullores 2001/4, rastet që kyqnin ndërmjetësimin në ushtrimin e prostitucionit dhe rastet e prostitucionit ishin nën kompetencën e Gjykatave Komunale për Kundërvajtje,¹⁶⁸ Komunale dhe të Qarkut.¹⁶⁹ Sidoqoftë, SMSL nuk ka identifikuar ndonjë rast të ndërmjetësimin në ushtrimin e prostitucionit të gjykuara nga GJKV, në çka mund të ketë pasur situata të ndërhyrjes në kompetenca në mes të GJKV dhe Gjykatave të Qarkut.

Rastet e dhunës familjare¹⁷⁰ shpesh përfshijnë veprat që bëjnë pjesë në lëminë e rendit dhe qetësisë publike. SMSL është i shqetësuar me çështjen e mos-trajtimin të veprave të kryera në sferën familjare si vepra të ndaluara nga ana e GJKV në tërë Kosovën. Arsyetimi pas këtij interpretimi ishte se në Ligjin mbi Qetësinë dhe Rendin Publik

¹⁶⁶ Neni 71.

¹⁶⁷ Shiko Seksionin mbi Trafikimin dhe Krimet Seksuale.

¹⁶⁸ Ligji mbi Rendin dhe Qetësinë Publike, neni 18, pika 6 dhe 8.

¹⁶⁹ Neni 251, al.1 dhe 2 të LPP RFJ.

¹⁷⁰ Ndonëse jo të rregulluara specifikuat si dhunë familjare, por të parashikuara përmes veprave tjera siq është lëndimi i lehtë trupor, sjellja violente dhe prishja e rendit dhe qetësisë. Neni 18 alinea 5 dhe neni 21 alinea 1.

sankcionon veprat e kryera në vendet publike, dhe rezidenat private nuk mund të konsiderohen “vende publike”.

Në një rast të gjykuar në GJKV në Prishtinë, kryesi nuk ishte shpallur fajtor për rrahje me shuplakë të gruas së tij në dhomën e fjetjes së shtëpisë së tyre, “pasiqë nuk ka ndodhur prishja e rendit publik”. Një rast i ngjashëm ishte gjykuar në GJKV në Vushtrri, me rezultat dhe arsyetim të njëjtë. Në anën tjetër, GJKV në Gjilan e shpalli fajtor dhe e dënoi bashkëshortin për rrahjen e gruas së tij dhe qështja se a ishte publik apo jo vendi i kryerjes së veprës nuk ishte përmendur fare. Rrjedhimisht, siq është deklaruar më vonë, SMSL ka vërejtur një mospërputhje në praktikën e GJKV të ndryshme, në rastet identike të marrin vendime të kundërta në mvarësi nga ajo se ku mbahet gjykimi.

Shqetësim vijues përkitazi me trajtimin e viktimave të dhunës ishte adresuar më heret në këtë seksion në lidhje me rastet nga Gjykatat Komunale. Megjithatë këto shqetësime janë të nivelit të njëjtë edhe kur është fjala për GJKV në gjykimet e tyre të rasteve të dhunës familjare.

Shqetësimet që burojnë nga observimi i aktiviteteve të GJKV

Të drejtat në mbrojtje

Në rastet e kundërvajtjeve të observuara nga SMSL, ishin vetëm disa raste të pakta ku kryesit kishin mbrojtësin ligjor. Kjo çështje është e brengosjes së veqantë pasiqë është një numër i kundërvajtjeve të cilat mbajnë dënimin e burgimit, dhe asistimi i mbrojtësit ligjor në rastet kur shqiptohet privimi nga liria, paraqet nja garancë të domosdoshme për plotësimin e standardeve për një gjykim të drejtë. Neni 87 i Ligjit mbi Kundërvajtjet definon të drejtën për të pasur mbrojtës ligjor si opcion, por jo obligativ. Për më tepër, në procedurën kundërvajtëse nuk ekziston koncepti i mbrojtjes ex-officio. Siq është observuar nga SMSL, ekspediviteti i procedurës kundërvajtëse (në disa raste kryesit as nuk e kuptojnë se gjinden përballë gjykatësit dhe se po zhvillohet gjykimi),¹⁷¹ dhe mos informimi i kryesit nga ana e gjykatësit mbi të drejtat themelore gjatë procedurës gjyqësore, qon gjer tek shkelja e të drejtës së kryesit për gjykim të drejtë siq parashihet me ligjin ndërkombëtar për të drejtat e njeriut.¹⁷² E drejta në mbrojtësin ligjor dhe në kohë adekuate dhe lehtësira për të përgatitur mbrojtjen, i referohen çdo lloj procedure para autoritetit gjyqësor, përfshirë marrjen në pyetje dhe hetimet të zhvilluara nga organet e rendit. Përderisa është e vërtetë se procedura kundërvajtëse nuk është procedurë penale sipas definicionit, SMSL vëren se i vetmi ndryshim në mes tyre buron nga masa e rrezikimit të të njëjtave vlera të mbrojtura shoqërore. Andaj, SMSL beson se nuk ka arsyetim se pse kundërvajtësit të kenë garancione më të vogla procedurale se që kan kryesit e veprave penale.

¹⁷¹ Mvarësisht nga ndërtesa e gjykatës, disa gjykata mbajtën seancat në dhoma që dukeshin si zyre. Gjykatësit nuk veshin ndonjë veshje të veqantë që i dallon. Andaj, kjo bën të mundur që personi të mos e dij se ai është në mes të gjykimit.

¹⁷² Neni 6 i KEDNJ, Neni 14 i KNDCP.

Përktimet joefektive

Të njëjtat shqetësime të shprehura nga SMSL në seksionet tjera të këtij raporti vlejné edhe për aktivitetin e GJKV dhe hapa të ngjashëm sikurse dhe për gjykatat më të larta duhet të ndërmerren për adresimin e kësaj çështje.

Trajtimi i kundërvajtësve të mitur

Trajtimi i kundërvajtësve të mitur nga GJKV është gjithashtu brengosës për SMSL. Siq është diskutuar më heret në Seksionin e Gjykatave Komunale, SMSL është i shqetësuar me dështimin e përfaqësuesve të QPS për tu paraqitur në gjykatë gjatë gjykimit të kundërvajtësve të mitur. Në vend të kësaj, ata vazhdimisht dërgojné mendime të standardizuara me shkrim, të shumtën e rasteve që nuk përputhen me rrethanat personale të të miturit. Situata është më serioze në rastet ku të miturit dënohen me burg, si zëvendësim për mos-pagesën e gjobës. Sipas raportit punues mbi Gjykatat për Kundërvajtje për semestrin e parë të këtij viti, ishin 206 të mitur të dënuar apo 2,1% nga numri total i personave të dënuar.

Raportet punuese në mes të organeve të rendit dhe GJKV

Organet zbatuese të ligjit dhe GJKV janë të ndërvarura, pasi që autoritetet policore të shumtën iniciojnë rastet e kundërvajtjeve të gjykuara pranë GJKV. Sidoqoftë, SMSL ka dokumentuar ankesat nga të dy anët përkitazi me komunikimet e pamjaftueshme dhe informatat që i ndajnë në mes veti. Hetuesit policor shpeshherë parashtrojnë rastet pranë GJKV që hyjnë në kompetencën e Gjykatave Komunale apo të Qarkut, duke krijuar kështu konfuzion dhe përplasje kompetencash në mes gjykatash. Skenar tjetër i vazhdueshëm është se zyrtarët policor nuk i përpilojnë kërkesat për fillimin e procedurës për kundërvajtje në formatin e kërkuar sipas ligjit, dhe si rezultat shumë raste janë lënë anash nga GJKV, për shkak të këtyre parregullësive. Shumë kërkesa që vijnë nga policia dështojné të ofrojnë identitetin dhe vendbanimin e kryesit duke e bërë zgjidhjen e rastit të pamundur nga ana e gjykatave. Në vend të kësaj, me mjetet e saj specifike të mbledhjes së informatave, organet e rendit duhet të jenë ato që ofrojnë sfondin e domosdoshëm për gjykata përkitazi me identifikimin apo gjetjen e kryesve, e jo e kundërta.

Efektiviteti i GJKV

Bazuar në Raportin mbi Efektivitetin e Gjykatave për Kundërvajtje, SMSL vëren shpërndarjen e pabarabartë të punës në GJKV në regjione të ndryshme, në gjykata të ndryshme.¹⁷³ Përderisa punë-ngarkesa në GJKV në Prishtinë ishte 229 lëndë për gjykatës, në semestrin e parë të këtij viti (15 gjykatës), në GJKV në Malishevë ishin 807 lëndë për gjykatës (vetëm një gjykatës i emëruar), dhe në GJKV në Deqan 24 lëndë për gjykatës (4 gjykatës të emëruar). Siq shihet, emërimi i gjykatësve në gjykata të caktuara, nuk korrespondon me normën e këtyre gjykatave të posaqme. GJKV në Malishevë është një shembull në këtë kuptim, pasi që vetëm një gjykatës është emëruar deri më tani, ndonëse për befasi GJKV në Malishevë duket të jetë gjykata më efektive, me 319 lëndë të zgjidhura nga gjykatësi, në semestrin e parë të këtij viti.

Shqetësim tjetër tashmë i raportuar nga SMSL në raportet paraprake, është emërimi i gjykatësve të cilëve iu mungon kualifikimi i domosdoshëm për pozitën që mbajnë. Nga të

¹⁷³ Në disponim të SMSL nga DAD.

gjithë gjykatësit e GJKV gjer më 31 mars 2001, 24 nga ta, respektivisht 21,4% nuk i kanë kualifikimet e duhura për ushtrimin e detyrës së gjykatësit (provimin profesional për gjykatës të kundërvajtjes), gjë që automatikisht vë në pyetje validitetin e vendimeve të marra nga këta gjykatës.

Shqetësimet e shprehura nga GJKV

Sipas intervistave të zhvilluara me disa nga Kryetarët e GJKV, brenga kryesore nga ana e tyre janë të ardhurat të vogla prej 300-400 DM¹⁷⁴, si dhe çështjet e sigurisë që rrjedhin nga kërcnimet e drejtuara ndaj gjykatësve.¹⁷⁵ Masa të pamjaftueshme sigurie në GJKV i ekspozojnë ata kërcnimeve, madje edhe në rastet e komunikacionit.¹⁷⁶

Dështimi nga palët që t'i përgjigjen thirrjeve është çështje tjetër brengosëse. Sipas mendimit të gjykatësve, kjo rrjedh nga fakti se zyrtarët policor të cilët i dorëzojnë thirrjet, nuk i dinë adresat e palëve apo dëshmitarëve. Siq u përmend më lart, zyrtarët policor dështojnë të mbledhin informatat e domosdoshme mbi palët, andaj thirrjen e rregullt e bëjnë pothuajse të pamundur.

Tjetër ankesë ishte mungesa e hapësirës punuese. GJKV në Gjilan është e vendosur në ndërtesën e Gjykatës së Qarkut, me 6 gjykatës dhe 25 punëtore dhe të gjithë këta ndajnë 5 zyra. Gjykimet mbahen sipas mënyrës së "rendit", dhe atë derisa njëri gjykatës mban gjykimin në një zyrë, të tjerët presin në koridor për rendin e tyre. Ankesa të ngjashme ishin dokumentuar edhe në GJKV në Glogoc, e cila është e vendosur në shtëpi private dhe në të cilën kushtet e punës janë të vështira.

REKOMANDIMET

- SMSL rekomandon emërimin e zyrtarëve administrativ ligjor përbrenda DAD, të cilët, veqmas nga administratorët duhet të mbajnë në rishqyrtim aktivitetin e gjykatave komunale dhe gjykatave për kundërvajtje, me një theks në adresimin e shqetësimeve që rrjedhin nga shkeljet e mundshme të ligjit ndërkombëtar mbi të drejtat e njeriut dhe ligjit vendor, dhe gjithashtu adresimin e sfidave të ndryshme dhe nevojave të këtyre gjykatave. Zyrtarët e tillë duhet të emërohen për secilën komunë, me përgjegjësinë që të mbulojnë si gjykatat komunale ashtu edhe ato për kundërvajtje nga komuna e caktuar.
- Duhet të themelohet një zyre ndërlidhëse përbrenda Policisë së UNMIK-ut, për të forcuar bashkëpunimin me gjykatat vendëse në kuptim të dorëzimit të thirrjeve, ekzekutimit të urdhërave të gjykatës dhe ofrimit të informatave relevante për gjykata. Zyra duhet të ketë zyrtarë policor për të përkrahur gjykatat kur identifikimi i kryesve të caktuar apo dëshmitarëve është i nevojshëm me mjetet që janë vetëm në disponim të organeve të rendit apo kur akcionet specifike policore janë urdhëruar nga gjykata dhe ato nevojitet të ndërmirren menjëherë.

¹⁷⁴ Intervistat e zhvilluara me Kryetarët e GJKV në Pejë, GJKV në Gjilan dhe Kryesin e Detyrës së Kryetarit të GJKV në Prishtinë.

¹⁷⁵ GJKV Pejë, GJKV Gjakovë.

¹⁷⁶ Në GJKV në Pejë, Kryetari ishte kërcnuar nga dy mashkuj, njëri prej të cilëve ishte akuzuar në relacion me një rast komunikacioni, dhe të cilët kishin hyrë në zyren e tij e i kishin thënë se ai duhet të paguante gjobën prej 300 DM. Para këtij rasti Kryetari ishte kërcnuar nga një polic i SHPK.

- Gjykatat Komunale dhe ato për Kundërvajtje duhet të kenë qasje në njësitin e njëjtë të përkthyesve përbrenda DAD.
- Emërimi i gjykatësve në Gjykatën Komunale dhe Kundërvajtëse, posaçërisht në këtë të fundit, duhet të jetë i bazuar në numrin e lëndëve të paraqitur para secilës gjykatë, në mënyrë që të mos ndodh disproporcionaliteti në mes të normave të gjykatësve nëpër gjykata të ndryshme në tërë Kosovën.
- DAD duhet të caktoj një gjykatës plotësues shërbyes, kur është nevoja, për të vepruar si gjykatës i dytë për të miturit, i cili mund të merr një pjesë të punës në situatat kur gjykatësi me orar të plotë pune nuk mund të arrijë numrin e rasteve që i janë caktuar asaj/atij.
- Policia e UNMIK-ut duhet të revidoj praktikën e tyre të konfiskimit të automjeteve kur vozitësit kryejn vepra komunikacioni, pasi që kjo praktikë imponon sanksione plotësuese që nuk janë parashikuar me ligj.